

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 6

ÇËSHTJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 6, dimër 2007

Bordi botues:***Kryetar***

Gj. Lt. (rez.) Pëllumb Qazimi

Anëtarë

Prof. dr. Dhori Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Agri Verrija – Këshilltar i Kryeministrit

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Evropiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Ky numër u përgatit nga

Erjon Alikaj

Elira Hroni

*Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel dhe të
SH. R. S. F. Aulona Pol*

PËRMBAJTJA

David S. Yost	
Rritja e bashkëpunimit të NATO-s me organizatat ndërkombëtare	7
Intervistë mbi çështje të sigurimit të energjisë	15
Intervistë me RAJENDRA PACHAURI, fitues i çmimit Nobel për Paqen në vitin 2007	19
Rexhep Meidani	
Globalizimi, terrorizmi dhe siguria	31
Marina Caparini & Philipp Fluri	
Aktorët e Shoqërisë Civile në Çështjet e Mbrojtjes dhe të Sigurisë	53
Shoqëria Civile në Shtetet Post-Komuniste	63
James. V. Arbuckle	
Nuk është punë për një ushtar?	79
Marilyn Peterson	
Policim i drejtuar nga inteligjenca: Arkitektura e re e inteligjencës	85
Rregullimi i sigurisë private në Evropë: Statusi dhe perspektiva	98
Kudret Selimaj	
Delegimi i kompetencave në veprimtarinë drejtuese	127
Brief Summary in English	145

David S. Yost

RRITJA E BASHKËPUNIMIT TË NATO-S ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

David S. Yost studion mënyrën se si NATO-ja mund të ndërthurë më tej forcën e saj me atë të organizatave ndërkombëtare.

Në samitin e Rigës në nëntor 2006, Aleatët e NATO-s nënshkruan një përqasje më të plotë civile-ushtarake të sigurisë. Kjo përqasje shënon një stad tjetër në rrugën e ndryshimit qysh nga fundi i Luftës së Ftohtë. Një pjesë e rëndësishme e saj është përmirësimi i bashkëpunimit të Aleancës me organizata të tjera ndërkombëtare. Ndryshimi i NATO-s në përgjegjësitë dhe detyrat që prej fillimit të viteve 1990 ka çuar në një bashkëpunim më të ngushtë me Kombet e Bashkuara (KB), me Bashkimin Evropian (BE), me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe me shumë organizata të tjera ndërkombëtare.

Ndërsa shumë gjëra janë arritur, faktorë të ndryshëm - duke përfshirë rivalitete kombëtare e nder-institucionale - vështirësuan zhvillimin e marrëdhënieve më të mira. Për më tepër, disa shtete kanë ruajtur një imazh të NATO-s gjatë luftës së ftohtë kryesisht si një organizatë ushtarake e orientuar drejt luftës. Motoja “Ne bëjmë paqe, NATO-ja bën luftë” gjithashtu vazhdon të ekzistojë mes disa punonjësve të organizatave të tjera ndërkombëtare. Fakti që NATO-ja është bërë shkatërruesi më i madh në botë i armëve të kalibrit të vogël dhe atyre të lehta është pak i njohur jashtë Aleancës.

NATO-ja është ndoshta në mes të rrugës së kalimit nga gjendja e Luftës së Ftohtë te përshtatja me kërkesat aktuale të sigurisë. Asaj i është dashur të merret me krizat urgjente e po ashtu edhe me detyrat e stabilizimit afatgjatë dhe rindërtimit.

Ajo nuk mund t'i përballojë e vetme në mënyrë efektive këto sfida. NATO-ja dhe disa organizata të mëdha

ndërkombëtare të sigurisë duhet të gjejnë rrugë për të punuar së bashku në mënyrë më produktive nëse synojnë të arrijnë objektivat e tyre të përbashkët.

NATO-ja në tranzicion

Që me fillimin e ndarjes së ish-Jugosllavisë në vitin 1991, Aleatëve të NATO-s iu desh të merreshin me lloje të ndryshme konfliktesh që nga shqetësimi i tyre për Luftën e Ftohtë me parandalimin e shpërthimit të një luftime konvencionale ndërmjet aleancave që mund të përshkallëzohej deri në një luftë nukleare. Qysh në fillim të viteve 1990, Aleatëve iu desh të përqendroheshin në parandalimin dhe frenimin e konflikteve etnike dhe politike brenda dhe midis shteteve. Qëllimet e përbashkëta u zgjeruan përtej ndalimit të dhunës së menjëhershme duke shkuar drejt krijimit të kushteve të nevojshme për zgjidhje të qëndrueshme të konflikteve. Që prej sulmeve terroriste kundër Shteteve të Bashkuara në shtator 2001, Aleatët janë ndërgjegjësuar për mënyrën se si shtetet në rrënim si p. sh. Afganistani nën sundimin Taleban - mund të bëhen strehë për lëvizjet terroriste dhe grupet e organizuara kriminale, për parandalimin e krijimit të strehëve të reja, Aleatët duhet të arrijnë më shumë sesa fitore në kuptimin tradicional të shkatërrimit të forcave të armikut në luftë.

Detyrat për ndërtimin e shtetit dhe demokratizimin nuk mund të përmbushen vetëm me mjete ushtarake. Siguria e qëndrueshme kërkon stabilizim, rindërtim, zhvillim ekonomik e social dhe mirëqeverisje. Ndërhyrja konstruktive kërkon kontributin e organizatave të shumta ndërkombëtare dhe organizatave jo-qeveritare.

Në fakt, Aleanca ka zhvilluar një përqsasje gjithëpërfshirëse në përballimin e sfidave të sigurisë që prej fillimit të viteve 1990. Aleatët më përpara kanë përdorur shprehje si “ Rritja e Bashkëpunimit Civilo-ushtarak”, “Planifikimi dhe Aksioni i përbashkët” dhe “Përqsasje tek Operacionet të bazuar tek efektet”. Përqsaja e gjithanshme është e ngjashme me këto koncepte në nevojën për aktivitete të koordinuara nga tipa të shumta organizatash në bashkëpunim me autoritetet lokale për promovimin e sigurisë dhe zhvillimit.

Aleatët e NATO-s konfirmuan në Samitin e Rigës çfarë ata kanë mësuar nga praktika që nga fillimi i viteve '90: organizatat e tjera kanë mundësi dhe mandate që NATO-s i mungojnë në arritjen e objektivave të përbashkëta me partnerët e saj ndërkombëtarë. Tre organizatat me të cilat NATO ka punuar më ngushtë janë Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe OSBE-ja.

Diversiteti si burim fuqie

Fakti që organizatat ndërkombëtare kanë fuqi e mandate të ndryshme shpesh ka ndihmuar në funksionimin e një ndarjeje racionale të punës. Avantazhi më i dukshëm i matshëm i NATO-s ka lidhje me aftësitë e saj ushtarake duke përfshirë ekspertizën e saj në planifikimin, organizimin dhe kryerjen e operacioneve me përfshirjen e forcave të armatosura të Aleatëve dhe partnerëve të sigurisë.

Në disa raste Aleatët kanë ndërhyrë vendosmërisht në ndarjen e palëve ndërluftuese dhe në ndalimin e mizorive – p. sh. operacionet më 1995 në Bosnje - Hercegovinë dhe më 1999 në konfliktin e Kosovës.

Aleatët gjithashtu kanë luajtur një rol drejtues në garantimin e sigurisë për aktivitetet e organizatave të tjera. Edhe pse nuk është arsyeja e vetme e ekzistencës së tyre, kjo mund të shihet në operacionet e mëposhtme të NATO-s:

- Forcat Zbatuese (IFOR) dhe Forcat Stabilizuese (SFOR) në Bosnje dhe Hercegovinë nga viti 1995 deri në 2004
- Forcat e Kosovës (KFOR) që në 1999 dhe
- Forcat Ndërkombëtare Ndihmëse të Sigurisë (ISAF) në Afganistan qysh prej vitit 2003

Aleanca ka disa aftësi civile jo-ushtarake, veçanërisht në planifikimin e emergjencave civile, në aspekte të mbrojtjes në reformat e sektorit të sigurisë dhe në programe të bashkëpunimit e partneritetit. Sidoqoftë, NATO-ja është pa dyshim e paafte të marrë përsipër gamën e plotë të detyrave për ndërtimin e shtetit dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale.

Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka një rol unik në sigurimin e një kuadri të legjitimitetit për përdorimin

e forcës në situata të ndryshme nga pasiguria e vetëmbrojtjes që mbulohet nga Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe nga Neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut. Të gjithë Aleatët e NATO-s preferojnë fuqimisht të marrin përsipër operacione jashtë atyre të Nenit 5 me një mandat të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Për më tepër, Aleatët e konsiderojnë shumë të dëshirueshme drejtimin e Kombeve të Bashkuara në përpjekjet koordinuese e multilaterale të stabilizimit e rindërtimit si p. sh. Misioni i Administrimit në Kosovë, ai i Ndihmës në Afganistan. Disa zyra e agjenci të Kombeve të Bashkuara si Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse (DPKO), zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), PNUD-i dhe Zyra e Koordinimit të Çështjeve Humanitare kanë një aftësi të pakrahasueshme me organizatat e tjera. OKB-ja ka një mundësi të paarrtshme për tërheqjen e burimeve në shkallë botërore.

Bashkimi Evropian ka vlera civile që janë jashtë qëllimit të aktivitetit të NATO-s, por që janë thelbësore për kapacitetet ndërtuese të shtetit, duke përfshirë policinë, drejtësinë dhe rregullat e programeve të ligjit.

Bashkimi Evropian ka burime financiare dhe mjete zhvillimi që mund të ndihmojnë rimëkëmbjen e ekonomisë në shoqëritë e shkatërruara nga lufta. Në disa situata, Bashkimi Evropian mund të diskutojë bashkëpunimin - perspektiven e anëtarësimit në BE – që mund të jenë me efektive sesa mundësitë e NATO-s për të ofruar anëtarësim e partneritet.

Në bazë të marrëveshjeve “Berlin-Plus” midis NATO-s e Bashkimit Evropian të miratuara në mars 2003, NATO ka dy herë më shumë asete dhe mundësi për të mbështetur operacionet e drejtuara nga Bashkimi Evropian; si Operacioni “Konkordia” në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë, nga marsi deri në dhjetor 2003, dhe Operacionin “Althea” në Bosnje dhe Hercegovinë qysh prej dhjetorit 2004. NATO dhe Unioni Evropian kanë koordinuar përpjekjet e tyre në mbështetje të Bashkimit Afrikan në Darfur, të UMNËK-ut në Kosovë, UNAMA-s në Afganistan etj.

Axhenda e OSBE-së ka qenë në pjesën më të madhe e ndarë (dhe plotësuese) nga ajo e Aleancës. OSBE-ja përqendrohet në promovimin e:

- pajtimit
- demokratizimit
- rregullit të ligjit
- respektimit të të drejtave të njeriut
- parandalimit të konflikteve
- rehabilitimit pas-konflikteve dhe ndërtimin e paqes

Në fushën politike-ushtarake, OSBE ka siguruar një kuadër për kontrollin e armëve dhe është fokusuar në ngritjen e mirëbesimit dhe sigurisë, masat e transparencës dhe ndërtimin e normave. Aktiviteti i fundit shtrihet nga zbatimi i kodeve të sjelljes ushtarake dhe politike deri te promovimi i respektit për direktivat mbi praktikën më të mira në proceset e rehabilitimit post-konflikt. Aleanca ka ofruar siguri për operacionet e OSBE-së në territore ku kanë qenë forcat e NATO-s dhe këto aktivitete i kanë shërbyer objektivave politike të NATO-s në situatat post-konflikt.

NATO duhet të punojë në mënyrë efektive me organizatat e tjera për krijimin e besimit të nevojshëm për operacione të suksesshme në të ardhmen. Çfarë ka funksionuar nga ajo që disa e quajnë “era ad-hoc” në koordinimin e përpjekjeve të organizatave ndërkombëtare pas viteve '90, pavarësisht efikasitetit jo optimal? Disa vëzhgues për këtë arsye i referohen si “një fazë e vështirë e adoleshencës” në marrëdhëniet e Aleancës me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Si mund të përmirësohet bashkëpunimi

Ekspertët kanë bërë shumë sugjerime për një efektivitet më të madh në kryerjen e operacioneve. Këto përfshijnë konferencat planifikuese para-operacionale, diskutime të praktikave të mësuara si dhe forcimin e politikave informuese të publikut.

P. sh. organizimi i seminareve mund të jetë një hap praktik, në mënyrë që përfaqësuesit e organizatave kryesore ndërkombëtare të sigurisë të mund të diskutojnë jo zyrtarisht

për pengesat kryesore të një bashkëpunimi me efektiv dhe për zgjidhjet e mundshme.

Institucionet si Kolegji i Mbrojtjes së NATO-s në Romë dhe shkolla e NATO-s në Oberammergau gjithashtu mund të sigurojnë një arsimim më të përparuar dhe mundësi trajnimi për anëtarët e organizatave të tjera ndërkombëtare si dhe për OJQ kryesore. Shkëmbimet e stafit mund të promovojnë mirëkuptim dhe njohje reciproke dhe mund të ndërtojnë një ndjenjë më të fortë për arritjen e objektivave të përbashkëta. Aleanca gjithashtu mund të zgjerojë aktivitetet e saj të ekspertizës duke përfshirë përfaqësues të organizatave të tjera ndërkombëtare si vëzhgues dhe pjesëmarrës.

Disa vëzhgues kanë propozuar krijimin e një arkivi qendror online të koduar të dhënash jo sekrete, në mënyrë që të shmangen dublikimet në aktivitetet e sigurisë dhe të administrimit për armët me kalibër të vogël, armët e lehta, municionet dhe karburanti i raketave. Ky program mund të përfshijë gjithashtu manaxhimin e kufijve, planifikimin, ushtrimet dhe aktivitete të tjera. Këto rregullime mund të plotësojnë përpjekjet publike diplomatike dhe të bëjnë të mundur që përfaqësuesit e organizatave të tjera ndërkombëtare të sigurisë të zgjerojnë njohuritë e tyre rreth aftësive të NATO-s dhe proceseve vendimmarrëse.

Konceptet më ambicioze përfshijnë:

- Organizimin e takimeve midis NATO - Bashkimit Evropian - Kombet e Bashkuara ose NATO – KB – BE - OSBE për të diskutuar rreth operacioneve aktuale.
- Një staf i shumanshëm i të gjitha organizatave kryesore ndërkombëtare të sigurisë.
- Krijimi i një “grup kontakti” i organizatave ndërkombëtare për çdo operacion specifik mbi modelin e Koordinimit të Përbashkët dhe Bordit të Monitorimit, krijuar për zbatimin e Marrëveshjes së Afganistanit.
- Një asamble e përhershme e organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve sipas modelit të Komitetit Inter-Agjenci, i cili bashkon organizatat e Kombeve të Bashkuara dhe të tjera të përfshira në ndihmën humanitare.

Një asamble do të lejojë NATO-n dhe partnerët e saj të thellojnë ekspertizën e tyre mbi operacionet nga monitorimi i krizave dhe masave parandaluese të ndërhyrja e mundshme, nëse është e nevojshme dhe stabilizimi e rikonstruksioni. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta në një institucion të vetëm gjithashtu mund të ndihmojë organizatat në planifikimin e një kuadri të përbashkët analitik dhe të bien dakord për një ndarje të punës në operacionet e ardhshme.

Këto propozime më të guximshme sugjerojnë çfarë mund të sjellë një përqaasje e gjithanshme, nëse do të zbatohet në mënyrë të plotë. Sidoqoftë, disa shtete, brenda dhe jashtë NATO-s, si dhe politikëbërësit në disa organizata, mund të refuzojnë të zbatojnë madje dhe konceptet më pak ambicioze.

Detyrat për ndërtimin e shtetit dhe demokratizimin nuk mund të përmbushen me metoda vetëm ushtarake... NATO-ja është pa dyshim e paaftë të marrë përsipër shkallën e plotë të detyrave për ndërtimin e shtetit dhe për zhvillimin ekonomik dhe social.

Disa Aleatë kanë rezerva të marrjes nga Aleanca të roleve të reja politike. Ata e shikojnë formalizimin e thellimin e marrëdhënieve të Aleancës me Kombet e Bashkuara, OSBE dhe organizata të tjera si të papajtueshme me fokusin e saj tradicional mbi operacionet ushtarake e të mbrojtjes kolektive.

Një pengesë tjetër është që organizatat ndërkombëtare të sigurisë, pavarësisht fuqive dhe mandateve të tyre të ndryshme, janë në njëfarë mënyre në konkurrencë për burime dhe misione. Disa janë të kujdesshëm ndaj rregullimeve që mund të dobësojnë autonominë, autoritetin dhe statutin e tyre. Një rivalitet i vazhdueshëm gjithashtu buron pjesërisht nga ambiciet e disa shteteve për disa organizata.

Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare kanë interesa përveçse në maksimizimin e përdorimit efektiv të burimeve dhe në arritjen e efekteve optimale nëpërmjet bashkëpunimit. Bashkëpunimi praktik në bazë, ndërmjet përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare në terren, ka rezultuar me produktive sesa lidhjet mes politikanëve të lartë të qeverive.

Ndërsa duket i mundshëm një model i vazhduar improvizimi – marrëveshjet dhe kompromiset ad-hoc – ndërtimi i një arkitekture bashkëkohore i organizatave ndërkombëtare të sigurisë dhe OJQ-ve është ende një objektivi që ia vlen të ndiqet.

David S. Yost është profesor në Shkollën pasuniversitare të marinës së Shteteve të Bashkuara në Monterey, Kaliforni. Ai punoi si zyrtar i lartë kërkimesh në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Rome nga 2004-2007. Pikëpamjet e shprehura janë personale dhe nuk paraqesin ato të Departamentit të Marinës apo të ndonjë agjencie qeveritare amerikane. Ky artikull bazohet në studimet e tij, organizatat ndërkombëtare dhe NATO-ja. (ky artikull mund të gjendet në: http://www.ndc.nato.int/download/publications/fp_03.pdf.)

INTERVISTË MBI ÇËSHTJE TË SIGURIMIT TË ENERGJISË

Në një intervistë me redaktorin e Revistës së NATO-s (NATO Review), Përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara Tom Lantos, Kryetari i Komitetit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Dhomës së Përfaqësuesve tregon sesi ai sheh rolin në ndryshim të NATO-s dhe çfarë NATO dhe anëtarët e saj mund të arrijnë për çështje të një rëndësie gjithmonë e më të madhe, atë të sigurimit të energjisë.

NATO Review: *Si fillim, ju lutemi na tregoni përshtypjet tuaja të përgjithshme rreth gjendjes aktuale të NATO-s dhe më gjerësisht rreth marrëdhënieve transatlantike. Si një person i lindur në Evropë dhe që keni jetuar gjatë Luftës II Botërore, si e shpjegoni rëndësinë e bashkëpunimit midis Evropës dhe SHBA-së?*

TOM LANTOS: Gjatë Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara dhe Evropa ishin të bashkuara dhe në një mendje për rrezikun që paraqiste Bashkimi Sovjetik. Marrëdhënia midis tyre ishte e konsoliduar si pasojë e mendimit të njëjtë që komunizmi paraqiste një kërcënim ekzistues në shumë aspekte të lirisë njerëzore. Por, tashmë në mungesë të kësaj forcë unifikuese, aleanca transatlantike është dobësuar dhe i nevojitet të rigjallërohet. NATO dhe shtetet anëtare përballen me një zgjidhje të vështirë ashpër: aleancës do t'i duhej të bëhej një partner ushtarak i besueshëm i Shteteve të Bashkuara i aftë për të ndaluar terrorizmin dhe regjime diktatoriale që kërcënojnë jetën e qytetarëve në të dyja anët e Atlantikut. Ose aleanca duhet kthehet në një grup qeverish që janë të angazhuar vetëm në aspektin retorik për mbrojtjen e përbashkët, ndërsa individualisht këto shtete mund ose jo të marrin përsipër sfidat e sigurisë të botës pas 11 Shtatorit. Kjo marrëdhënie mund të rigjallërohet në Afganistan, sepse një fitore e NATO-s atje

mund të jetë një mbështetje për aleancën dhe një provë për rëndësinë e vazhdueshme të NATO-s në botën pas Luftës së Ftohtë. Shteteve të Bashkuara u duhet gjithashtu të vazhdojnë bashkëpunimin me Bashkimin Evropian në zonat ku liria është e kufizuar, duke përfshirë rëndësinë e zgjidhjes së statusit final të Kosovës dhe sfidave në rritje të shkaktuara nga Rusia për energjinë.

NR: *Sipas mendimit tuaj, cili duhet të jetë roli që duhet të luajë NATO në çështje të lidhura me sigurimin e energjisë?*

LANTOS: Secili nga shtetet anëtare të NATO-s ka një pozicion për krijimin e një kuadri të përshtatshëm për sigurimin e energjisë. Sigurimi i energjisë mund të luajë një rol të rëndësishëm në një këndvështrim më të gjerë të sigurisë dhe në çështjet gjeopolitike për Evropën dhe Amerikën e Veriut dhe rrjedhimisht duhet të jetë një prioritet për NATO-n.

NR: *Sa e besueshme është për ju Rusia si një partnere e energjisë?*

LANTOS: Rusia ka filluar të mbajë një pozicion gjithmonë e më shumë agresiv në lidhje me politikën e energjisë, nxitur nga boom-i i saj ekonomik në energji. Unë ndaj shqetësimin e shumë evropianëve kur Rusia i shfrytëzon burimet e saj energjetike për t'u imponuar fqinjëve të vet zgjedhjet e saj politike, më konkretisht duke ndërprerë furnizimin me gaz natyral ndaj shteteve të ish-Republikës Sovjetike në kohën kur kërkesa për gaz natyral arrin maksimumin. Çështja nuk qëndron nëse Afganistani do të dështojë, por nëse Shtetet e Bashkuara do të parandalojnë dështimin e tij e vetme apo së bashku me të gjithë aleatët e NATO-s. Unë isha kritik i hapur ndaj përpjekjeve të motivuara politikisht të Presidentit Putin për shpërbërjen e Yukos-it dhe për përqendrimin e kontrollit në Kremlin, duke kontribuar ndaj tendencës në rritje për shtetëzimin e burimeve energjetike në vendet e pasura me energji.

Dhe unë besoj që Rusia përfundimisht do të ndërgjegjësohet që ky besim afatshkurtër që vjen nga çmimet e larta të energjisë nuk do të jetë në interesin e saj politik dhe të sigurisë afatgjatë dhe në vend të saj do të duhet të pranojë

që e ardhmja e saj do të varet nga marrëdhëniet bashkëpunuese dhe të respektueshme me Shtetet e Bashkuara dhe me Evropën.

NR: *Është menaxhimi i energjisë një çështje sigurie? N.q.s. po, duhet NATO të përfshihet në menaxhimin e energjisë të aleatëve nëpërmjet ndarjes së informacionit?*

LANTOS: Menaxhimi i energjisë është pa dyshim një çështje sigurie, duke kufizuar konsumimin tonë të energjisë, gjithashtu zvogëlohet vartësia jonë për burimet e vendeve të tjera, veçanërisht vendet jo të qëndrueshme që na ndihmojnë ne për përballimin e nevojave tona energjetike. Menaxhimi mund të luajë një rol në ofrimin e sigurisë për energjinë për shumë anëtarë të NATO-s. Megjithatë, është e paqartë nëse NATO është organizata më e përshtatshme në marrjen përsipër të këtyre çështjeve.

NR: *Sa të rëndësishme janë financimet dhe përdorimi i teknologjive alternative si solari, era, hidrogjeni dhe energjia fotovoltike?*

LANTOS: Financimet dhe përdorimi i teknologjive alternative si ato që përmendët janë të rëndësishme në sigurimin e energjisë tonë kombëtare. Ligji për energjinë HR 3221, i cili u miratua së fundmi nga Dhoma e Përfaqësuesve, të cilën unë e bashkësponsorizova, kishte një emërtim të lidhur me çështje ndërkombëtare dhe përfshinte edhe këto masa.

NR: *Besoni ju që NATO duhet të luajë një rol më të madh në Lindjen e Mesme, duke pasur parasysh rëndësinë e rajonit në çështje të lidhura me sigurimin e energjisë?*

LANTOS: Puna e vështirë e NATO-s në Afganistan që në vitin 2001 bëri të qartë se amerikanët dhe evropianët janë të përgatitur të administrojnë operacione të vështira luftime jashtë Evropës. Në të vërtetë, misioni në Afganistan është sfida më e rëndësishme me të cilën aktualisht po përballlet NATO-ja, ashtu si dhe një mundësi për një aksion efektiv dhe kuptimplotë. Çështja nuk qëndron nëse Afganistani, i cili është misioni më ambicioz i NATO-s qysh krijimit të tij në 1949, do të dështojë, por nëse Shtetet e Bashkuara do të ndalojnë

dështimin e tij pothuajse vetëm, ose në bashkëpunim të plotë me të gjithë aleatët e NATO-s. Unë besoj që Rusia shpejt do të kuptojë që mirëpozicionimi në terma afatshkurtër që vjen nga çmimi i lartë i energjisë nuk do të jetë në interesin e saj politik dhe të mbrojtjes në një plan afatgjatë. Ndërsa qytetarë nga shumë vende anëtarë të NATO-s janë duke luftuar dhe duke dhënë jetën në Afganistan, shumë vende janë duke shtuar kërkesat për operacionet ku marrin pjesë trupat e tyre ose nuk pranojnë të marrin pjesë aktivisht në vendet ku stabiliteti dhe suksesi implikon si Evropën ashtu dhe Shtetet e Bashkuara.

Pavarësisht se trupat holandeze, britanike, daneze dhe kanadeze kanë marrë pjesë aktivisht në misione të rrezikshme, ky mision kërkon më shumë mbështetje nga trupat evropiane, gjermane dhe franceze.

NR: Çfarë roli, n.q.s. mundet, sipas jush, duhet të luajë NATO për t'ju kundërvënë Iranit në lidhje me programin nuklear?

LANTOS: Është shumë e rëndësishme për NATO-n dhe shtetet e tij anëtare të përcaktojnë se çfarë roli është e aftë, ose e gatshme aleanca për të ndërmarrë në konflikte ushtarake jashtë kufirit relativisht të qetë të Evropës. Ata duhet të kuptojnë zgjerimin e kuptimit të termit “i pushtuar”, që do të thotë se grupet terroriste mund të pushtojnë një shtet pa një ushtri të mirëfilltë. Ata, gjithashtu, duhet të pranojnë shtrirjen gjeografike gjithmonë e në rritje të vendeve të rrezikshme për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë ose transmetimin e teknologjive moderne të prodhimit të armëve nukleare në vende të tjera.

Intervistë me RAJENDRA PACHAURI,
FITUES I ÇMIMIT NOBEL PËR PAQEN
NË VITIN 2007

Revista NATO: Pyetja ime e parë është rreth Çmimit Nobel për Paqen. Së pari, urime për PNNK-në dhe për ju.

RAJENDRA PACHAURI (Kreu i Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimaterike – PNNK): Faleminderit.

RN: Mund të më thoni se çfarë do të thotë për ju personalisht dhe çfarë mesazhi përçon?

PACHAURI: Sigurisht që për mua është një burim krenarie. Çdokush do të ndihej shumë mirë, por sigurisht që çmimi është destinuar për të gjithë komunitetin dhe qeveritë e PNNK-së, të cilët marrin vendime për PNNK-në. Pra, është një ndjenjë e papërsëritshme kënaqësie të shohësh shpërblimin e një përpjekjeje të tillë të një shkalle të gjerë.

Mendoj se ai dërgon dhe një mesazh shumë të rëndësishëm që ndryshimi i klimës ka marrëdhënie shumë të rëndësishme me elementë të ndryshëm të paqes dhe që ne duhet të fillojmë të fokusohemi në këtë çështje. Mendoj që lidhja midis asaj çfarë ndryshimi i klimës mund të bëjë në lidhje me pasojat mbi paqen e stabilitetin dhe sigurisë në botë është diçka që duhet të theksohet tani në bazë të mesazhit që ju merrni nga ky çmim.

RN: A mendoni se efektet e mundshme të ndryshimit të ardhshëm të klimës, si një garë në rritje për burime toke, ujë nënkuptojnë një ripërkufizim të nevojave të sigurisë?

PACHAURI: Mendoj se po, sepse siguria nuk është vetëm dërgimi i trupave në një vend a një tjetër. Mendoj se fillimisht duhet të jemi intelektualë me rigorozë në njohjen e drejtuesve

të sigurisë apo të kërcënimeve ndaj saj dhe që sigurisht është një përpjekje e vazhdueshme që duhet të ngrihet në një shkallë më të gjerë.

Së dyti, mendoj se ne duhet gjithashtu të kuptojmë se kur flasim për ndryshimin e klimës, ka një numër të madh të heshtjeve të zhvillimit që duhet të mbahen parasysht. Është çështja e paanësisë. Prandaj këtu ka njëfarë dimensionit etik. Kjo është e gjitha. Është problemi i konsumit, i shterimit të burimeve natyrale. Me siguri që do të ndeshim një konkurrencë shumë më të fortë për burimet e mbetura, si p.sh. hidrokarburet.

Fakti që Rusia ngriti flamurin në Polin e Veriut është thjesht simbolika e fillimit të një konkurrence shumë të madhe. Dhe sigurisht mund të jetë një kërcënim për sigurinë në një formë a një tjetër. Dhe kjo, në njëfarë mënyre, do të shtrembërojë politikën në mbarë globin. Do të zbuloni se ata agjentë e organizata që mundën të ndihmojnë shtetet dhe shoqëritë të gjejnë burime do të favorizohen, mbështeten edhe nëse ato mund të jenë regjime represive, edhe nëse ato dhunojnë parimet më themelore ku bazohen demokracia dhe të gjitha liritë që ne vlerësojmë.

Pra, mendoj se ka një numër heshtjesh që duhet të theksohen me kujdes dhe të kuptohen nëse flasim për sigurinë.

RN: Sfidat ambientale janë qartësisht globale, por ato do të kenë ndikim shumë më të keq në zonat më të varfra. A mendoni se në kushtet e ndarjes së botës nga kufijtë, këta kufij do të bëhen pak a shumë të rëndësishëm me ndryshimin e klimës?

PACHAURI: Është një pyetje shumë komplekse. Nga një anë, ata bëhen më pak të rëndësishëm sepse në fund të fundit natyra apo ndryshimet klimaterike dhe kushtet e kohës apo të erës nuk respektojnë kufijtë territoriale. Por nga ana tjetër, përpara këtyre kërcënimeve që mund të ngrihen ndoshta si rezultat i zhvendosjes së popullsisë apo fatkeqësive natyrore, do të ndeshni përpjekje shumë më të mëdha për ruajtjen e kufijve thjesht sepse shumë shoqëri do t'i shihnin popujt përtej kufirit si një kërcënim i mundshëm. Dhe prandaj është një situatë e pazakontë kjo që po hasim.

Nga një anë, faktorët që çojnë në një kërcënim ndaj sigurisë dhe stabilitetit nuk i respektojnë aspak kufijtë. Nga ana tjetër, mendoj se përgjigja për këtë mund të nënkuptojë përcaktimin në mënyrë shumë më rigoroze të këtyre kufijve dhe ndoshta mbrojtja e tyre me përpjekje shumë më proaktive.

RN: *Dhe në lidhje me përcaktimin e kufijve – ju përmendet tashmë ngritjen e flamurit nga Rusia në polin e veriut – a mendoni se përcaktimi i kufirit si dhe ruajtja e tij, do të bëhet një çështje madhore?*

PACHAURI: Mendoj se ligjet dhe marrëveshjet tona i përcaktojnë qartë kufijtë dhe realisht nuk duhet të ketë shumë vend për dyshime mbi këtë problem. Por *interpretimi* i këtyre marrëveshjeve sigurisht që do të jetë temë e kontradiktave mes atyre që do të duan t'i përdorin këto përcaktime në favor të tyre. Kështu, unë mendoj se fakti që kërcënimet ndaj sigurisë dhe paqes, si rezultat i ndryshimit të klimës, po i tejkalojnë kufijtë, do të kërkojë, apo më së pakti do të nxisë, qeveri e shoqëri të ndryshme që t'i përcaktojnë këta kufij në një mënyrë që t'u japë atyre përparësi ndaj të tjerëve.

Ka shumë mundësi që të shihni lindjen e më shumë debateve dhe, do të thosha, për pasojë një rrezik të qartë për sigurinë në ato zona ku kufijtë mund të mos kuptohen siç duhet nga njerëzit edhe pse marrëveshjet janë shumë të qarta.

RN: *Ju përmendët qeveritë këtu. A mund t'ju pyes për marrëdhëniet e tyre me aktorët joshitetërorë. Në lidhje me politikëbërjen përkundrejt popullsisë, në disa vende të zhvilluara është pikërisht popullsia ajo që tregohet më radikale në lidhje me problemin e ndryshimit të klimës sesa qeveritë. Pra, si e shihni balancën ndërmjet qeverive dhe aktorëve joshitetërorë në të ardhmen?*

PACHAURI: Përgjithësisht mendoj, sikurse mund të pritet, se qeveritë merren vetëm me çështje që ato i konsiderojnë të rëndësishme për zgjedhjet e ardhshme. Prandaj horizontet e tyre të kohës në përcaktimin e problemeve dhe prioriteteve janë diktuar qartësisht nga kjo konsideratë.

Por do të zbuloni se me më shumë ndërjegjësim mbi atë që do të ndodhë në të ardhmen, popullsitë në vende, shoqëri

e komunitete të ndryshme po shqetësohen seriozisht për disa nga këto çështje.

Nëse ata fillojnë të fusin tani ndikimet afatgjata të politikave e veprimeve të tyre të sotme në agjendën politike për debat, në diskutimin dhe zgjedhjen e qeverisë, atëherë sigurisht edhe politikanet do të ndikohen. Prandaj ajo çka ju duhet sot është një klasë liderësh që mund të lexojnë atë çka shfaqet para tyre, që mund ta përshpejtojnë këtë lëvizje dhe atëherë të marrin një pozicion lideri që nuk është vetëm një çështje e komfortit politik. Kjo pasi ata gjithashtu duhet të jenë thellësisht të bindur se është një e mirë për njerëzimin dhe një e mirë për shoqëritë për të cilat ata janë përgjegjës.

Për të qenë i ndershëm, në këtë moment nuk shikoj shumë liderë në horizont, të cilët të kenë atë lloj vizioni, shqetësimi e kujdesi për të ardhmen.

RN: Sfidat do të kërkojnë një shkallë gjithnjë e më të lartë bashkëpunimi e besimi. Ku e shihni rolin organizatave kryesore ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara apo NATO-ja në ngritjen e këtij bashkëpunimi e besimi?

PACHAURI: Vërtet mendoj se ata do të bëhen gjithnjë e më të rëndësishëm, thjesht sepse këto janë probleme që një vend apo grup vendesh nuk do të jenë të aftë t'i zgjidhin. Nevojitet vërtet një ndikim totalisht i ndryshëm global. Nevojiten iniciativa globale, të cilat të mund të përcaktojnë këto probleme dhe të gjejnë zgjidhje shumanëshe për to.

Kështu them se një organizatë si Kombet e Bashkuara duhet të ripërcaktojë rolin e saj e ndoshta madje dhe të ristrukturojë organizatën e saj. Sekretari i ri i Përgjithshëm i saj Ban Ki-Moon e ka konsideruar ndryshimin e klimës si ndoshta pjesën më të rëndësishme të agjendës së tij. Ai ishte me ne në Valencia, Spanjë, ku ne publikuam Raportin e Katërt të Vlerësimit, Raportin e Sintezës së PNNK-së.

Dhe unë i jam shumë mirënjohës që ai po mban këtë qëndrim dhe e admiroj njeriun që ka perceptimin dhe ndjenjën e të kuptuarit se ky mund të jetë realisht problemi përcaktues i shekullit të 21-të.

RN: *Si e balanconi tendencën në rritje të botës për zhvillim dhe stabilitetin në rritje që ky zhvillim i sjell shoqërive kundrejt efekteve mbi klimën e këtij zhvillimi dhe dukshëm destabilizimit që ndryshimi i klimës mund të sjellë? Dërgim tjetër trupash?*

PACHAURI: Shikoni, unë realisht mendoj se duhet të ripërkufizojmë fjalën zhvillim. Fatkeqësisht, që prej fillimit të Revolucionit Industrial ne drejtohemi e frymëzohemi në njëfarë mënyre nga sukcesi i teknologjisë, i metodave moderne të prodhimit që na lejojnë të prodhojmë e konsumojmë gjithnjë e më shumë më çmime më të lira. Thjesht jemi dehur me këtë ndjenjë sipas së cilës zhvillimi konsiston në konsumimin gjithnjë e më shumë, në rritjen e Produktit të Përgjithshëm (GDP) me gjithë të metat në këtë masë. Mendoj se kjo duhet ripërcaktuar.

Fakti është që duke vijuar këtë të ashtuquajturin zhvillim, kemi imponuar një kosto shumë të madhe të natyrës sociale, dëme e shterim të burimeve tona natyrore dhe shumë sëmundje të tjera që nuk janë marrë kurrë hapur në konsideratë.

Vetëm tani, më duhet të them, njerëzit po binden për realitetin e ndryshimit të klimës, për dëmin ndaj burimeve tona natyrore dhe për shterimin e shumë burimeve në këtë tokë arsyet për të cilat ndoshta duhet t'i shohim te bazat e zhvillimit.

Mendoj se vendet në zhvillim duhet të bëjnë më shumë punë intelektuale, sesa të ndjekin verbërisht atë çfarë ka bërë bota e zhvilluar. Dhe kjo, sigurisht, nuk mund të bëhet vetvetiu. Gjithashtu, bota e zhvilluar duhet të mendojë se si të reduktojë konsumin e tepërt të burimeve natyrore, të ekosistemeve në këtë tokë.

Kështu ajo çka duhet është një kuptim tërësisht i ri i asaj që duhet përkufizuar si mirëqenie njerëzore e përfitim i racës njerëzore dhe kjo do të kërkojë një ndryshim substancial. Nuk po them që duhet të kthehemi të jetojmë në shpella, por mendoj se kemi fuqitë teknologjike e ekonomike për të sjellë një ndryshim pa ndërprerje madhore të progresit apo atij që e quajmë progres.

RN: *Pra, ju mendoni se siguria në fundin e shekullit të 21-të do të lidhet më pak me shëndetin personal e më shumë me cilësinë e qëndrueshme të jetës?*

PACHAURI: Absolutisht dhe kjo gjithashtu do të thotë që shumë nga disnivelet e ndryshimet që ne kemi aktualisht në shoqëri e ndërmjet shoqërisht, do të duhet të zvogëlohen dhe mendoj se duhet të kuptojmë që ky është një objektivi tepër i rëndësishëm i zhvillimit. Zhvillimi që lejon vetëm një pjesë të vogël të shoqërisë të përparojë dhe lë jashtë gjithë këtij sistemi një numër të madh njerëzish, qartësisht nuk është zhvillim.

Ishte Kenneth Boulding, një ekonomist që unë e admirojmë shumë, i cili para më shumë se një çerek shekulli tha se është e pamundur që para 200 vjetësh raporti mes shoqërive më të pasura e atyre më të varfra ishte 1 me 5, ndërsa sot më shumë se 1 me 50.

Pra, tendenca e kësaj bote për të ecur verbërisht e pa i kushtuar vëmendje këtyre problemeve, sipas meje, është vetëvrasëse. Duhet ta ndalim këtë.

RN: *Sipas jush, sa e madhe është mundësia që ndryshimi i klimës të çojë në një konflikt të madh të armatosur? Dhe çfarë do të çonte në këtë konflikt? Për shembull uji, nafta, etj.?*

PACHAURI: Po, mendoj se një arsye për një konflikt të tillë do të ishte konkurrenca për burimet e pamjaftueshme. Uji është pa dyshim një prej tyre. Mund të ishin burimet e hidrokarbureve. Mund të ishin problemet apo le të themi një rënie e prodhimeve bujqësore që çon në privim të të ushqyerit e të ushqimit. Dhe një numër i madh katastrofash e fatkeqësish natyrore, të cilat do të rëndohen me ndryshimin e klimës.

Tani, e gjithë kjo nënkupton që ka një rrezik të lëvizjes së një numri gjithnjë e më të madh njerëzish nga vendbanimet e tyre për në zona të tjera. Dhe kur filloni të shikoni këtë lloj tendence, atëherë ju keni parë qartësisht elementin për konflikt. Dhe do të imagjinoja se kjo mund të shtrihet në një shkallë të gjerë.

Për shembull, në Raportin e Sintezës së PNNK-së ne çmuam se në vitin 2020, vetëm në Afrikë do të ketë nga 75

deri në 250 milionë njerëz që do të vuajnë nga mungesa në rritje e ujit. Dhe çfarë do të bëjnë ata? Do të lëvizin. Do të ketë konflikt. Madje edhe mes komuniteteve për burimet e kufizuara të ujit. Dhe kjo mund të shumëfishohet në një shkallë të gjerë në pjesë të ndryshme të botës.

RN: Disa kërkime të bëra nga Universiteti i Oregonit treguan që asnjë shtet nuk ka bërë luftë vetëm për ujë që prej vitit 2500 para Krishtit dhe që marrëveshjet e bashkëpunimit janë mënyrat më të zakonshme për të zgjidhur konfliktet për ujin dhe ata gjithashtu marrin shembull Izraelin, Palestinën e Jordaninë ku kërkohen qoftë sasia e pakët e ujit, qoftë kompromisi. A besoni ende se njerëzimi mund të gjejë bashkëpunim mbi këto lloj heshjtesh?

PACHAURI: Pa dyshim, sepse mendoj se nëse u paraprihet të gjitha këtyre problemeve, nëse përcaktohen qartë e nëse ne vëmë në jetë zgjidhjet, kjo do të japë shpresë për të ardhmen. Asgjë nga kjo nuk është e pazgjidhshme. Këto probleme mund të zgjidhen lehtësisht nga përpjekjet njerëzore.

Por mund të them se marrëveshjet dhe mirëkuptimi në të kaluarën kanë funksionuar, pasi ne ndoshta nuk kemi arritur në një pikë kulminante. Dua të them, kemi mundur të menaxhojmë burimet e kufizuara e në shterim në një mënyrë që përgjithësisht i jep mjaftueshëm të gjithëve. Por nuk jam shumë i sigurt nëse ne do të mundemi të mbajmë këtë situatë kështu dhe në të ardhmen.

RN: Në ngjarjet dhe katastrofat e mëdha mjedisore që kanë ndodhur, NATO-ja ka luajtur një rol si në Uraganin Katrina dhe në tërmetin në Pakistan. A mendoni se ky rol do të kërkohet gjithnjë e më shumë në këto lloj ngjarjesh që janë në rritje?

PACHAURI: Mendoj se ka mundësi që diçka e tillë të ndodhë, por do të më pëlqente të besoja se me këtë informacion që kemi sot njerëzit do të mundeshin të zbatonin strategji përgjigjeje që do të ndihmonin në shmangien e krizave të kësaj natyre.

Por kjo ndodh pikërisht aty ku unë besoj se lidershipi do të jetë kritik. Duhet pak liderë gjigantë e shtatlartë, por që mund të shohin të ardhmen, që të jenë të përgatitur të tregojnë

bindjen e tyre në formë aksionesh e veprimesh dhe në mungesë të kësaj dhe në rast se njerëzit do të jenë thjesht oportunistë me qëndrimet e liderëve, atëherë kam frikë se do të injorohet realiteti dhe bazat e këtyre kërcënimeve me të cilat ka shumë të ngjarë të përballemi.

Kemi pasur njerëz të tillë në të kaluarën. Abraham Linkoln ishte një prej tyre dhe ka shumë të tjerë. Unë thjesht nuk shoh shumë prej tyre në horizont sot. Dhe shpresoj se ndërgjegjësimi mbi këto çështje do të nxjerrë llojin e duhur të lidhshimit, sepse kjo do të jetë absolutisht kritike.

PACHAURI: Po, duhet të mendoj kështu dhe imagjinoj që NATO-ja në interesat dhe në ndjekjen e objektivave të saj të gjithanshme duhet të fillojë t'i paraprijë disa ngjarjeve dhe mundësive të tilla. Çka do të thotë që do të duhet të bëjë më shumë kërkime, më shumë analizë intelektuale mbi mënyrën se si gjërat po formësohen në pjesë të ndryshme të botës.

NATO-ja, në fund të fundit, lindi kur filloi Lufta e Ftohtë dhe ky shkak ka rënë tashmë dhe mendoj se para faktit se është një organizatë me fuqi shumë të mëdha, me kontribute të një numri të madh shtetesh shumë të fuqishëm, ajo duhet të ripërcaktojë rolin e saj. Dhe do të imagjinoja që duhet të pritet drejt një studimi shumë më të gjerë mbi atë çka mund të ndodhë në të ardhmen, sesa të gjendet e papërgatitur.

Dhe nëse paraqitet rasti, NATO-ja sigurisht mund të luajë një rol tepër të rëndësishëm në parandalimin apo menaxhimin e disa prej këtyre problemeve.

RN: *Dhe në lidhje me parandalimin, çfarë rekomandoni?*

PACHAURI: Me duket dhe e kam ndier këtë për njëfarë kohe, se një organizatë si NATO-ja ka nevojë të punojë shumë më ngushtë me shoqërinë civile, me organizatat që merren me këto probleme, që kanë njëfarë mbështetjeje në nivelin bazë. Dhe kjo nuk do ta ndihmonte NATO-n vetëm në reagimin ndaj situatave në zhvillim, por gjithashtu në mobilizimin e disa prej këtyre organizatave si aleate në raste të konflikteve apo krizave të mundshme.

Kështu mendoj se duhet të shtrihet. Duhet të dalë nga moda e operacionit ushtarak. Mendoj se ka shumë më shumë për të bërë në parandalimin e këtyre konflikteve, sesa në angazhimin më vonë në konfliktet që do të jenë duke u zhvilluar.

RN: Sa të rëndësishëm e shihni kërkimin dhe zhvillimin si ndihmës në përmirësimin e zgjidhjeve për sfidat para nesh?

PACHAURI: Mendoj se është absolutisht kritike. Dhe do t'i klasifikoj kërkimin dhe zhvillimin në dy kategori të veçanta. E para ka lidhje me tipin e kërkimit të shkencave sociale ku shihet se si shoqëria do t'i përgjigjet ndryshimeve specifike që do të ndodhin në të ardhmen dhe ka mundësi të parashikohen llojet e veprimeve që mund të parandalojnë problemet e konfliktet.

Tjetra është kërkimi dhe zhvillimi i aplikuar në mënyrë strikte në teknologji dhe zhvillimi i teknologjisë. Në këto raste mendoj se ajo çfarë duhet është politika qeverisëse për të drejtuar kërkimin dhe zhvillimin.

Një nga gjërat që parashtruar në Raportin e Vlerësimit të PNNK-së është rëndësia e çmimit të karbonit.

Teknologjitë mund të zhvillohen me bollëk në laboratorë, por nuk do të funksionojnë po të mos ketë një çmim dhe forcë tregu që të lejojë dhe nxisë përhapjen e këtyre teknologjive.

Dhe prandaj ne e kemi marrë shtruar me këto çështje. Kemi shpenzuar para për kërkimin dhe zhvillimin. Çka na nevojitet janë kompanitë. Ka nevojë vërtet për konsumatorin që të mbështesë disa nga këto shpikje teknologjike dhe që kërkon disa vendime të vështira nga ana e qeverisë.

RN: Në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë, a mendoni se kërcënimi terrorist do të çojë në një planet më të rrezikuar ekologjikisht? Për shembull, a mendoni që sulmet ndaj komplekseve energjetike apo ndaj fushave të pasurimit do të bëhet më shumë një taktikë e terroristëve?

PACHAURI: Pa dyshim. Le të pranojmë faktin se këta terroristë fitojnë shumë para nga burime të ndryshme. Do të thotë shumë mbështetje. Prandaj metodat e tyre do të jenë

teknologjikisht më të sofistikuara. Dhe ata do të veprojnë në mënyrë të tillë për të krijuar incidente që do t'iu jepnin para, që do t'iu jepnin disa fuqi në rrjedhën e ngjarjeve.

Pra, ata sigurisht do të fillonin të vepronin në fusha të tilla si helmimi i ujësujellësve, shpërthimi i gazit apo naftësujellësve, veprimtarinë pirate në shumë pjesë të botës dhe ndërprerjen e furnizimeve të naftës e të burimeve të tjera.

Pra, këto janë probleme, të cilat duhet t'i parashikojmë. Kjo nxjerr në pah një fakt tjetër që, unë mendoj, organizata si NATO-ja kanë nevojë për një koordinim shumë më të madh me shërbimet sekrete dhe ndoshta për vendosjen e disa lidhjeve të reja në fusha që mund të bëhen pika të nxehta. Kjo do të ndihmonte shumë.

RN: Në vitin 2000 Robert Kaplan shkroi një libër të titulluar "Po vjen anarkia" dhe sigurisht duke lexuar përmes sfidave që janë përpara tokës, për statistikën, tendencat, është e qartë që ka një mundësi të madhe për një shkatërrim social ose një atmosferë dëshpërimi në rritje, ndoshta po aq të keqe se ajo në Evropë midis luftërave. A mendoni se kjo do të ndodhë dhe çfarë mund të bëhet për ta shmangur dhe nëse ndodh, mund të na tregoni çfarë pasojash mund të ketë?

PACHAURI: Mendoj se ka mundësi të ndodhë diçka e tillë, por do të doja të besoja se me informacionin që kemi sot, njerëzit do të ishin në gjendje t'i dallonin shenjat dhe simptomat e kësaj shumë më përpara se kjo të ndodhte, prandaj duhet të jemi të aftë të zbatojmë strategji përgjigjeje që do të shmangnin kriza të kësaj natyre.

Por kjo ndodh pikërisht aty ku unë besoj se lidhshipi do të jetë kritik. Duhet pak liderë gjigantë e shtatlartë, por që mund të shohin të ardhmen, që të jenë të përgatitur të tregojnë bindjen e tyre në formë aksionesh e veprimesh dhe në mungesë të kësaj dhe në rast se njerëzit do të jenë thjesht oportunistë me qëndrimet e liderëve, atëherë kam frikë se do të injorohet realiteti dhe bazat e këtyre kërcënimeve me të cilat ka shumë të ngjarë të përballemi.

Kemi pasur njerëz të tillë në të kaluarën. Abraham Linkoln ishte një prej tyre dhe ka shumë të tjerë. Unë thjesht nuk shoh shumë prej tyre në horizont sot. Dhe shpresoj se

ndërgjegjësimi mbi këto çështje do të nxjerrë llojin e duhur të lidërshipt sepse kjo do të jetë absolutisht kritike.

NR: Në fillim përmendët nevojën për një ndryshim dhe të njëjtën gjë dhe tani në fund. Një ndryshim kulturor. Si do ta shikonit që kjo gjë po vjen? Ç'duhet për këtë?

PACHAURI: Mendoj se duhet filluar me ndryshimin e sjelljes së konsumatorit. Mendoj se konsumatori duhet të fillojë të japë një sinjal që ai apo ajo nuk do të blejë mallra e shërbime që kanë lidhje me arsyt themelore që çojnë në konflikte për të cilat po diskutojmë. Dhe mendoj që nëse kjo ndodh, atëherë tregu do të bëhet një forcë e madhe në lindjen e këtij ndryshimi. Për momentin kjo është ajo ku unë mendoj se lidërshipti mund të bëjë një dallim. Aty ku një lider do të këshillojë njerëzit të ecin në një drejtim të caktuar në lidhje me zakonet e tyre të konsumimit apo tjetër, do të ketë rezistencë, kritika, por nëse ai apo ajo mundet të bindë komunitetin për të cilin është përgjegjës, atëherë mendoj se do të ketë një ndryshim në sjelljen e konsumatorit.

Më kujtohet në Bangkok kur paraqitëm Raportin e tretë të Grupit të Punës, një gazetar më pyeti në një konferencë shtypi: “A mund të rekomandoni ndonjë ndryshim të mënyrës së jetesës?” Unë i thashë se PNNK-ja nuk rekomandon ndonjë gjë, por nëse kërkoni opinionin tim personal, le të fillojmë duke ngrënë më pak mish. I thashë se do të ishte më i shëndetshëm dhe po kështu edhe planeti.

Pra, mendoj se është nevoja për ndryshime të kësaj natyre dhe për këto probleme njerëzit duhet ta kapin demin për brirësh dhe të ecin në këtë drejtim. Mendoj se nuk ka asgjë më të rëndësishme dhe më të fuqishme se një sinjal që i shkon tregut. Dhe mendoj se konsumatorët duhet të edukohen me të. Është sikur të blesh një frigorifer apo një llambë eficiente edhe pse ata kushtojnë pak më shumë sepse jo vetëm që përfiton konsumatori, por mbi të gjitha përfiton shoqëria si e tërë. Dhe unë mendoj që duhet ta bëjmë këtë.

RN: *Përballë gjithë këtyre sfidave Mike Childs i “Miqtë e Tokës” ka thënë se ne duhet të varemi nga zgjuarsia e njerëzimit. A mendoni se zgjuarsia e njerëzimit mjafton?*

PACHAURI: Kjo zgjuarsia është aty si një mundësi e aftësi. Është një potencial, por a do ta shfrytëzojmë? Kjo është çështja? Mendoj se nëse duhet ta bëjmë këtë, gjëja e parë që duhet bërë është të fillojmë të shohim të vërtetën në sy. Lester Brown, të cilin e respektoj shumë, e ka përmbledhur këtë. Ai thotë: “Komunizmi ra pasi tha gënjeshtria për ekonominë. Dhe kapitalizmi mund të rrëzohet sepse ne po themi gënjeshtria për ekologjinë”. Unë mendoj se fillimisht ne duhet të kuptojmë realitetin e problemit. Mund të shihni shumë liderë në një shtet të mohimit. E nëse ata vazhdojnë me këto intriga, atëherë ata do t’i bëjnë dëm shumë të madh jo vetëm botës si një e tërë, por vetë shoqërisë së tyre.

Pra, unë mendoj se duhet të fillojmë të shohim drejt realitetin. Duke mos e mbuluar të vërtetën kudo që ajo ndodhet. Dhe kur ne të mundemi ta bëjmë këtë, atëherë po, zgjuarsia njerëzore mund të marrë stafetën.

Rexhep Meidani

GLOBALIZIMI, TERRORIZMI DHE SIGURIA

(Pjesë e marrë me shkurtime nga libri "Globalizimi, Integrimi dhe Kombi Shqiptar", Rexhep Meidani, Botimet Toena, Tiranë 2002)

Debatet realiste mbi globalizimin, por dhe mbi raportet e reja midis individit, bashkësisë, shtetit e organizmave ndërkombëtare, janë zhvendosur disi nga fokusimi fillestar intensiv, pas ngjarjeve tragjike të 11 Shtatorit, që kanë nxjerrë në plan të parë problemet e sigurisë. Sidoqoftë, krahas këtyre problemeve të sigurisë njerëzore, proceset globalizuese mbeten përsëri po aq parësore në axhendën e veprimit kombëtar e ndërkombëtar.

Globalizimi si një proces ekonomik-shoqëror, integrues, nëpërmjet të cilit synohet të zhvillohet edhe afrimi midis individëve, popujve e komuniteteve të përkatësive të ndryshme, nëpërmjet një komunikimi e kontakti më të mirë, një *lëvizjeje të lirë* në rritje të ideve, njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitaleve, pasqyron në vetvete një *prirje njerëzore e natyrore* për zhvillim, për një jetë më të mirë, për rrugë e horizonte të reja të lirisë së zgjidhjes e zgjedhjes, për një *hapje* më të madhe politike, ekonomike e shoqërore, për një mbrojtje më të garantuar, madje tej kufijve shtetërorë dhe për një *ndërveprim* më të fuqishëm në nivel ndërkombëtar e aktivizim në rritje të instrumenteve globalë. Këto, në fund të fundit, janë të domosdoshëm e pararendës të vetë procesit botëror të demokratizimit e progresit social, e për më tepër të rritjes së sigurisë njerëzore, jo vetëm në kuptimin individual, rajonal e global apo në kuptimin territorial e politiko-kombëtar, por dhe si veprim *parandalues e goditës* ndërkombëtar, që në asnjë mënyrë e rast nuk duhet t'i kundërvihet lëvizjes së lirë së njerëzve.

Terrorizmi dhe siguria njerëzore

Ngjarjet tragjike të 11 Shtatorit, në këtë fillim shekulli, na dëshmuar edhe njëherë kërcënimin mjaft serioz me të cilin përballet ende bota, sistemi rregullator i saj dhe mënyra jonë e jetesës. Sepse ky kërcënim i kësaj përmase të përbindshme, apo ky profil i ri i shpalosur prej terrorizmit nuk njihet *distanca apo vende të sigurta*. Ai shoqërohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga dukuri të tjera mbështetëse me shtrirje botërore, *si krimi i organizuar, pastrimi i parave, trafikimi ilegal i armëve, drogës dhe qenieve njerëzore*. Si një kërcënim real për të gjithë, bëhet më se urgjent përqendrimi i vëmendjes tek instrumentet e duhur dhe më të përshtatshëm për të luftuar çdo burim terrorizmi, duke i dhënë njëkohësisht një formë të re edhe organizmave të ndryshme kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes së veprimeve të reja të domosdoshme të karakterit politik, diplomatik, ligjor, financiar dhe ushtarak si dhe nëpërmjet miratimit të rregullave të reja më efektive, pse jo edhe nëpërmjet ndërtimit të detajuar të *një doktrine të re globale*, që të përfshijë në përmbytjen e saj krahas instrumenteve, teknikave e strukturave të *parandalimit* të veprimtarive terroriste, ashtu dhe *goditjen e drejtpërdrejtë*, të shpejtë dhe të ashpër ndaj tyre. Madje, nga pikëpamja ligjore kombëtare e ndërkombëtare mund të rritet niveli dhe dinamika e reagimit duke e klasifikuar terrorizmin si një *tip të ri lufte* dhe duke e radhitur atë si dukurinë më të rrezikshme për sigurinë kombëtare dhe atë botërore, dhe mbi të gjitha për vetë *sigurinë njerëzore*, sepse në thelbin e tij terrorizmi është shumë më tepër se sa secila nga sfidat e shumta tradicionale e jo tradicionale të sigurimit. Të tilla janë, përveç dukurive kriminale mbarëkombëtare të përmendura më sipër, edhe konfliktet etnike dhe fetare, fatkeqësitë dhe shpërnguljet masive, paqëndrueshmëritë e katastrofat mjedisore, mit-marrja e korrupsioni politik e ekonomik, vjedhja e informacionit etj. Të gjitha këto kërcënime, ku shpesh përzihen krimi dhe konflikti nuk njohin kufi. Për më tepër, shkalla e shtrirjes së këtyre veprimtarive, për sa i përket përfshirjes mjaft të gjerë në to dhe transferimit të parave, është kaq e madhe sa që i eklipson ekonominë kombëtare të disa shteteve dhe

rrjedhimisht dhe kushtet e sigurisë njerëzore në këto vende. Sipas një raporti ndërkombëtar të strukturave të OKB-së, para pak vjetësh, paraja e pistë që qarkullonte në botë brenda një viti vlerësohej rreth 1500 miliard dollarë, d.m.th. po të pjesëtohej me popullsinë e botës (rreth 6 miliardë banorë) dilte afërsisht në vlerën 250 dollarë për frymë në vit, gjë që tregon se po të shfaqet kjo dukuri në vende tepër të varfra ajo bëhet jashtëzakonisht e rrezikshme, moleps keqani shëndetin e ekonomisë, të politikës dhe mbarë shoqërisë së atij vendi...

Në kushtet e reja globale po rritet në të njëjtën kohë dhe forca e ndikimi i organizatave legjitime, veçanërisht atyre ndërkombëtare, të cilat në sajë të veprimtarisë së tyre, jo vetëm me karakter ekonomik, por dhe humanitar, nuk kanë kufizime kufitare. Pra, globalizimi, së bashku me revolucionin në teknologjinë e informacionit, u ka dhënë epërsi edhe këtyre institucioneve. Për më tepër sot synohet, të paktën në mënyrë më të qartë e hapur, një kontroll më shumë i tregjeve financiare sesa i ndonjë strukture të caktuar gjeopolitike. Prandaj, ndoshta, nuk është aspak e habitshme që mekanizmat tradicionalë shtetërorë, veçanërisht ato të sigurisë, të ndërtuar apo të mbështetur në konceptin e kufijve, shfaqen sot disi të vjetruar, madje edhe të kërcënuar në funksionimin e tyre. Mbi të gjitha, struktura të tilla duken të papërgatitura apo shfaqen relativisht të paafta për t'u ngritur në lartësinë, që duhet, për t'u përballur me këtë sfidë të një natyre krejt tjetër të sigurisë. Për këtë arsye, sot, për përballimin e kësaj sfide, po bëhet më se urgjente që të programohen koncepte e strategji të tjera, të bazuara në përsosjen e drejtimit, të shkëmbimit të informacionit, të bashkëpunimit e koordinimit më me besim të ndërsjellë e zgjuarsi të gjitha shërbimeve partnere e inteligjente në nivel sa më të gjerë, tej kufijve shtetërorë. Po kështu, në vazhdimësi, po rivlerësohet edhe rifreskimi i teknologjisë "preventive" krahas shtrirjes së rrjeteve të drejtpërdrejta njerëzore të informacionit "të gjallë", që mesa po kuptohet e rikonceptohet, sot është i pazëvendësueshëm, edhe sikur të përdoret teknologjia më e sofistikuar.

Megjithatë, ndonëse në këto fusha ka pasur përparime të qarta e lëvizje pozitive, ato nuk kanë qenë aq të shpejta sa të

mund të arrinin në nivelet e përballimit të sfidave të sotme në rritje. Për shembull, agjencitë e zbatimit të ligjit, edhe në vendet më të zhvilluara, kanë qenë të paktën një dhjetëvjeçar mbrapa në thithjen dhe shpërndarjen e teknologjive më të avancuara, që disponoheshin nga disa prej grupeve kriminale më të rrezikshëm të këtij shekulli të ri, ndërkohë që strukturat policore, të informuara, të orientuara apo të udhëhequra nga shërbimet sekrete, duket se e kanë të rrallë suksesin e kapjes dhe ndalimit të më shumë se 10% të drogës dhe emigrantëve të paligjshëm, që hynë në këto shtete. Po kaq probleme seriozë ligjorë e kohorë në vendimmarrje kanë dhe organet e akuzës dhe të gjyqimit, ndërkohë që qendrat vendimmarrëse të terrorit e krimit të organizuar, në përgjithësi, nuk njohin asnjë kufizim kohor, se për atë ligjor-statusor as mund të bëhet fjalë! Si pasojë e këtyre mangësive, vonesave teknologjike dhe mundësive të kufizuara të kapaciteteve njerëzore, pushteti i vërtetë tashmë po kalon përtej “kufijve” të shteteve kombe, por dhe përtej institucioneve si KS-ja, OKB-ja, G8 apo strukturave të tjera të kësaj natyre. Përveç përmirësimit të shpejtë të teknologjive specifike dhe bashkëpunimit më të ngushtë e të sinqertë në nivel global, kërkohet sot një mendim i freskët, një vizion bashkëkohor për t’u përballur me këtë realitet të ri, madje në një mjedis krejt tjetër pa barriera kufitare, sepse, ndërkohë që çështjet vendore apo shtetërore do të vazhdojnë të mbeten themeli i veprimeve apo vonesave politike, nga “prapambetja zgjedhore” e vetë politikës; biznesi, me konceptet e tij dinamikë, duke qenë gjithmonë në gatishmëri, do të vazhdojë të jetë i aftë t’u përgjigjet me shpejtësi ndryshimeve të tregut.

Në të vërtetë, për këtë dinamikë depërtimi, shtrirjeje e efektiviteti ka nevojë dhe trajtimi teorik e praktik i problemeve të sigurisë. Kjo, edhe pse në një shikim të parë, në këtë përzierje politikë-biznes, përkatësisht brenda-kufitare dhe jashtë-kufitare, mund dhe të sfumohet apo dhe të humbasë rëndësia e tablosë më të gjerë strategjike, e domosdoshme për të luftuar me sukses krimin e organizuar dhe terrorizmin, që nga e tij synon e bën çmos për dinamizmin e shtrirjen. Ndoshta, kjo është dhe një arsye tjetër që ideja për të krijuar një strukturë strategjike krejtësisht dinamike e efektive në kuadrin e një

“qeverisje globale” antiterror, krahas “koalicioneve të vullnetit”, me një fuqi të plotë ndërkombëtare të instrumenteve të saj të sigurisë (natyrisht pa vetot apo kushtëzimet “përfituese” të anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së), nuk duket më as e tepërt, as dhe naive.

Vlerësimi i drejtë i të gjitha këtyre sfidave është i domosdoshëm edhe në këndvështrimin politik dhe institucional të Shqipërisë. Solidariteti i plotë, mbështetja nga i gjithë populli shqiptar i luftës globale antiterror dhe pjesëmarrja konkrete në koalicionin botëror, me misionë ushtarake në Bosnjë, Afganistan e Irak, kundër terrorizmit dhe materializimi hap pas hapi i objektivave integruar dhe bashkëpunues (me shtrirje evropiane ose globale) mbeten aktualisht elementë tepër të rëndësishëm të politikës dhe shoqërisë shqiptar. Nëpërmjet tyre realizohet dhe një korrelacion sa më i mirë me vetë të ardhmen e sigurt të kombit shqiptar. Gjithashtu, shteti shqiptar e ka bërë vazhdimisht të qartë se integrimi i tij i plotë në NATO dhe BE, janë përparësi strategjike absolute të politikës së tij, të lidhura ngushtë jo me strukturën dhe konceptet e vjetruara të sigurisë dhe sovranitetit kombëtar, por, mbi të gjitha, me procesin e demokratizimit dhe zhvillimit të mëtejshëm politik, social dhe ekonomik të vendit. Dhe, në mënyrë më specifike, me vetë *sigurinë njerëzore*.

Kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore dhe mënjanimi i tyre

Kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore mund të klasifikohen në disa grupime. Ndër to mund të veçohen ato të sigurisë *ekonomike*, të sigurisë *në lidhje me ushqimin*, të sigurisë *grupore* apo ato të sigurisë *politike*. Për t’u bërë ballë të gjithë këtyre kërcënimeve dhe për të kapërcyer vështirësitë e ndryshme, të hasura në kuadrin e sigurisë njerëzore, të vetë mbrojtjes së jetës njerëzore, si pjesa më themelore, si përbërësja më e rëndësishme e angazhimit tërësor në luftën kundër terrorizmit, del si i domosdoshëm kontributi dhe solidariteti mbarëbotëror në përpjekjet e përbashkëta për reduktimin e *varfërisë* në një pjesë të madhe të botës dhe, paralelisht me të, edhe për arritjen e një *shpërndarje* më të drejtë të teknologjisë në nivel botëror.

Këto “armë” manipulimi, pa ndonjë bazament historik, në duart e terrorit e të krimit duhen eliminuar...

Varfëria dhe qeverisja. Është më se e vërtetë se në botë, në periudhën e viteve 1980-2000, janë shënuar ndryshime e përparime të konsiderueshme në drejtim të qeverisjes demokratike dhe decentralizimit, qoftë nga pikëpamja sasiore, ashtu dhe ajo cilësore. Madje, sot, nuk mund të mohohet se shumë vende, përfshi këtu dhe Shqipërinë, kanë bërë hapa të rëndësishëm përpara në drejtim të qeverisjes, mbështetur në stabilitetin makro-ekonomik dhe në instalimin e të gjithë parametrave ligjorë e strukturorë të ekonomisë së tregut dhe hapjes së plotë ndaj tij. Veçanërisht në Ballkan ka filluar realizimi i një serie reformash komplekse dhe vëmendja tashmë po përqendrohet gjithnjë e më shumë në përmirësimin e klimës së investimeve. Madje po bëhet më se e qartë se aty ku angazhimi i brendshëm ndaj një politike të drejtë dhe të shëndoshë është i fortë, kontributi ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet mjaft më i efektshëm.

Ky përfundim mbi mirëqeverisjen apo keq-qeverisjen nuk është aspak i ri. Një vizion kuptimplotë i qeverisjes së mirë apo të keqe pasqyrohet dhe në afresket e famshme të shekullit të 14-të të Sienës, të realizuar nga Lorenzeti, e të titulluara “*Pasojat e qeverisjes së mirë dhe qeverisjes së keqe*”, ku pasqyrohen dy qytete. Në njërin prej tyre qeverisja udhëhiqet nga drejtësia, urtësia dhe dhembshuria njerëzore; në tjetrin ajo udhëhiqet nga arroganca, inati, sedra e sëmurë dhe koprracia. Forma e parë e qeverisjes prodhonte rregullsi, harmoni, lumturi dhe begati; ndërsa mënyra e dytë e ushtruar në qeverisjen e qytetarëve prodhonte vetëm varfëri, korrupsion, shtypje dhe fatkeqësi. Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit janë rikonsideruar më mirë disa të vërteta të vjetra dhe është thelluar më tej kuptimi e angazhimi njerëzor mbi *varfërinë* dhe rrugët e luftimit e të kapërcimit të saj. Me një vizion të drejtë, angazhim të qartë kombëtar e ndërkombëtar dhe *partneritet të ndershëm* mund të gjenden rrugë e zgjidhje kundër varfërisë dhe të mposhtet ajo; duke ndryshuar njëkohësisht edhe formën e ndihmës apo të asistencës për vendet e varfra.

T’u japësh leksione vendeve të varfra dhe të kritikosh qeverisjen e tyre të dobët, ndërkohë që atyre u jepen ndihma

të pakta për të mbështetur përparimin e tyre teknologjik, mbrojtjen e shëndetit publik, arsimin dhe nevoja të tjera të karakterit social-njerëzor, është sigurisht mjaft e lehtë. Por, siç rezulton nga përvoja e vendeve të varfra në nivel botëror, një gjë e tillë duket se praktikisht nuk funksionon mirë apo funksionon fare dobët. Aq më tepër kur rezulton që pagesa e specialistëve ndërkombëtarë, jo vetëm që mund të rezultojë deri në 100 herë më e lartë se sa ajo e specialistit më të mirë vendor, por ajo “përulan” një pjesë tepër të rëndësishme të vetë buxhetit të projektit përkatës. Prandaj, strategjia duhet detyrimisht të *ndryshojë*, veçanërisht për sa u përket raporteve të paargumentuara “*hardware-software*” ende në favor të atyre “*software*” në projektet e ndryshme, por dhe për sa i përket nevojës për rritje reale të kapaciteteve administrative-menaxhuese të burokracisë ndërkombëtare. Përfshirë këtu dhe reduktimin e pagesave të personelit të tyre. Në fund të fundit, kërkohet një analizë e vlerësim sa më konkret i veprimtarisë, suksesit apo dështimit në një vend konkret, i rolit efektiv pozitiv apo negativ të përfaqësive aty të FMN-së, BB-së dhe institucioneve financiare të BE-së. Apo, akoma, të shpenzimeve të pajustificuara trajnuese, ose trajtimit me përgjegjësi të ndihmave humanitare, sidomos gjatë krizave të ndryshme, ku ndeshen dhe spekulimet më të mëdha. Deri diku, këto të fundit jo vetëm që nuk bashkërendohen apo mirë-korrelohen midis tyre, por, më shpesh realizohen përmes shoqatave dhe institucioneve jo vendorë, duke rezultuar jo rrallë, si një përfitim për donatorët apo për organizatat e tyre. Nuk mungojnë dhe rastet, në të cilat manifestohen edhe interesa e preferenca të natyrave të ndryshme politike kombëtare apo gjeopolitike ndërkombëtare...

Ndarja dixhitale. Përgjithësisht pranohet se me mbarimin e Luftës së Ftohtë, ndarjet e vjetra ideologjike thuajse kanë marrë fund. Por, tashme po shfaqet një ndarje e re akoma më e ndërlikuar. Kësaj radhe e bazuar *mbi teknologjinë*. Një pjesë e vogël e planetit, e cila nuk përbën më shumë se 15% të popullsisë së tij, siguron pothuajse të gjithë zbulimet teknologjike në nivel botëror. Pjesa e dytë, ndoshta, sa gjysma e popullsisë së botës, vetëm i thith dhe i adopton këto

teknologji. Pjesa që mbetet, rreth 1/3 e popullsisë botërore, e ndodhur në një hendek të thellë *varfërie* nuk njih apo nuk disponon kurrfarë niveli teknologjik. Për ironi, kjo ndarje teknologjike ka prirje të theksohet me rritjen e rëndësisë e të rolit të drejtpërdrejtë të teknologjisë së informacionit, e cila i jep një pushtet më të madh dhe garanton një përfitim më të lartë ekonomik për vendet e pasura e të zhvilluara dhe njerëzit e tyre më të kualifikuar. Edhe pse një realitet tepër i diferencuar, me pasoja jo normale, frenuese e deri diku rrezikshme për të ardhmen e njerëzimit, “zbutja” e tij nuk nënkupton shmangien apo pengimin e informatizimit të botës e të “dixhitalizimit” të saj. Përkundrazi, çështja që shtrohet sot është se si të ngushtohet kjo ndarje dixhitale, apo, së paku, se si të gjenden rrugë dhe ndihma optimale për të krijuar hapësira e shanse të reja për shumë nga rajonet *teknologjikisht të përjashtuar*, për t’u bërë edhe ata përdorues të teknologjisë. Kjo nuk përbën vetëm një trampolinë për një evolucion të mëtejshëm demokratik, kulturor, teknik, qytetar dhe njerëzor, por edhe një angazhim të rëndësishëm në luftën kundër varfërisë nëpërmjet *thithjes* dhe *transferimit* të teknologjisë dhe dijes së përparuar. Në të njëjtën kohë ky hap i domosdoshëm në luftën kundër *ndarjes teknologjike* mund të ndihmojë e do të shërbejë edhe si mundësi pozitive për zvogëlimin e *largimit të intelektualëve* nga vendet e tyre, për t’iu kundërvënë në mënyrë konkrete e efektive dukurisë së “*tharjes së trurit*” (“brain drain”), që jo vetëm pakëson shkallën e potencialit intelektual dhe demokratik të një vendi, por përbën gjithashtu dhe një *humbje* të konsiderueshme financiare dhe shoqërore, në procesin e formësimit të vetë elitës intelektuale, për të gjithë vendet e varfra, përfshi këtu edhe Shqipërinë apo vende të tjera të Ballkanit. Vetëm duke iu kundërvënë me shpejtësi kësaj ndarjeje të re, pa iu referuar me “vetëkënaqësi” periudhës së gjatë, nëpërmjet të së cilës u arrit hap pas hapi, të paktën në Evropë, të shmanget ndarja ideologjike, mund të përshpejtohen procesi i demokratizimit të shoqërisë njerëzore dhe ai i rritjes së vetë sigurisë globale.

Procesi i integritimit. Nën këtë këndvështrim përgjithësues, po bëhet gjithnjë e më e qartë se është e pamundur të

perceptohet se si do të eci përpara demokratizimi i Ballkanit dhe i shoqërisë shqiptare në rast se ne nuk i shohim ato si pjesë përbërëse të kontinentit tonë e të gjithë mjedisit ndërkombëtar, si segmente vetëveprues dhe të përgjegjshëm të një bote në ndryshim të vazhdueshëm, me një kalim intensiv nga sistemet e mbyllur në ata të hapur. Është epërsia politike e padiskutueshme e sistemit të hapur, që lehtëson përshtatjen në mënyrë konkrete, të vetëdijshme, të natyrshme dhe progresive të sistemit arsimor, shëndetësor dhe atë të mbrojtjes së mjedisit, të ndihmës e përkrahjes sociale, me ekonominë e tregut, iniciativën e lirë dhe sistemin politik global e instrumentet e tij.

Ndërkohë, po bëhet gjithnjë e më e qartë se integrimi ynë i vërtetë rajonal, sidomos në fushën e shkëmbimeve, infrastrukturës dhe mbi të gjitha në fushën e energjetikës, përbëjnë hapa të domosdoshëm drejt integritit euroatlantik. Shqipëria e shikon integrimin e plotë të Ballkanit në BE si parësor ndaj integritit të pjesshëm apo vend pas vendi. Gjithashtu, për banorët e politikanët e këtij rajonit të mbetur (të paintegruar), pas euforisë, naivitetit politik dhe iluzioneve optimiste të fillimit, tashmë është e qartë se rregullat e ekonomisë së tregut dhe sistemet e hapur politike ndryshojnë tërësisht nga ato të ekonomive të mëparshme të komanduara dhe sistemet politike autoritarë të partisë-shtet, pavarësisht mbeturinave ende ekzistuese në mendësi dhe praktikë. Prandaj, dhe për të realizuar tranzicionin kërkoheshin jo vetëm ndryshime tepër të thella ligjore e strukturore, por dhe përmbyse të mëdha e të shpejta në mendësinë individuale e psikologjinë shoqërore. Por, nga ana tjetër, nuk mund të imagjinohet që, në të njëjtën kohë, rregullat dhe kërkesat për ekonomitë tona të tregut dhe sistemet e reja të hapura politike në rajon, të mund të ngjasojnë menjëherë dhe automatikisht me ekonomitë e fuqishme të tregut dhe sistemet politike të hapura e të zhvilluara në një proces normal “tretjeje” shumë kohë më parë. Siç shihet, në një perceptim të tillë, pavarësisht arsyeve, ekziston një parakusht i fortë, i cili mund të sjellë një tjetër vonesë të madhe në unifikimin e Ballkanit Perëndimor me familjen evropiane dhe NATO-n por, në të njëjtën kohë

mund të krijojë edhe një hendek mjaft të madh midis vetë BE-së dhe vendeve të rajonit tonë. Për ta shmangur këtë apo ndonjë krizë tjetër potenciale në rajon, pas një dhjetëvjeçari konfliktesh e gjakderdhjesh në ish Jugosllavi, “për të mos prodhuar më shumë histori se ç’ mund të konsumojë vetë Ballkani”, siç nënvizonte dikur Çerçilli, nevojitet jo vetëm një udhëheqësi këmbëngulëse dhe e vendosur rajonale dhe evropiane por njëkohësisht, shumë më tepër solidaritet, mirëkuptim dhe humanizëm. Sepse, procesi i asociimit dhe i integritimit është më tepër se sa një statistikë e thjeshtë, më tepër se sa një ushtrim ekonomik apo financiar, më tepër se sa një tërësi rregullash apo termash, që shtohen çdo ditë, siç po tentohet të trajtohet sot. Realiteti aktual politik i Evropës është shumë më i favorshëm se kurrë për të konkretizuar me shpejtësi një gjë të tillë. Tashmë Evropa është më e bashkuar se sa ç’ ka qenë ndonjëherë në dhjetëvjeçarët e mëparshëm, duke manifestuar qartë një bashkëpunim të lartë, një mirëkuptim reciprok dhe një potencial të fuqishëm ekonomik, por edhe një komunikim më të mirë se sa më parë midis vetë evropianëve.

Pavarësia dhe ndërvarësia. Në perspektivën e një bote të qëndrueshme dhe paqësore, me një standard të ri e më të fuqishëm të sigurisë njerëzore, nevojitet një përpunim i plotë politik i disa koncepteve themelore. I tillë, nën një këndvështrim politik, ekonomik, arsimor, mjedisor dhe atë të sigurisë është dhe koncepti i *sovrانيتit kombëtar*. Edhe kjo po bëhet gjithnjë e më e qartë në kuadrin e një ndërthurjeje në rritje, madje të domosdoshme të veprimtarive dhe shqetësimeve kombëtare me ato ndërkombëtare. Por kjo, në asnjë rast, nuk nënkupton humbje të sovranitetit kombëtar, por, përkundrazi, si një zgjedhje demokratike e populllore e vetë shteteve sovranë, një fuqizim të mëtejshëm nëpërmjet ndërveprimit dhe *ndërvarësisë* së këtij sovraniteti, jo vetëm në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, por dhe atë ekonomiko-sociale, mjedisore, etj. Futja e suksesshme e Euro-s, madje brenda një kohe tepër të shkurtër, si monedhë e përbashkët në hapësirën Euro dhe përtej saj, është një prej shembujve më të qartë të kësaj zgjedhjeje sovranë apo zhvendosjeje sovraniteti në një

nga politikat kryesore qeverisëse, siç është politika monetare. Perceptimi i drejtë i këtij procesi është i rëndësishëm, veçanërisht në rajonin e Ballkanit, në të cilin, në procesin e integritimit dhe të rritjes së shkallës së ndërvarësisë, këto çështje duhet të gjejnë mirëkuptimin e duhur, në mënyrë që aty të nxitet e të mbështetet një frymë e re, larg sëmundjeve nacionaliste, për ndërtimin modern të shoqërive demokratike multietnike.

Bashkekzistenca fetare dhe multietnike. Përvoja e Shqipërisë në ndërtimin e marrëdhënieve midis shtetit, feve e etnive është mjaft pozitive, dhe shoqëria shqiptare ka qenë dhe mbetet historikisht një ndër modelet më pozitive të bashkekzistencës fetare, të drejtpeshimit etnik-fetar, të respektit të ndërsjellë, të promovimit të bashkekzistencës dhe respektit përkundrejt grupeve të ndryshëm me përmbajtje fetare apo etnike. Për më tepër, opinioni i shumë juristëve të huaj, si p.sh. i atyre të Komisionit të Venecias, është se në disa drejtime, bazat ligjore të tilla si nenet e Kushtetutës tonë mbi pakicat kombëtare, fetare etj., janë shumë më demokratike, krahasuar me ato të disa vendeve të tjera të dala nga komunizmi, e madje, edhe më liberale e demokratike se sa ato të disa vendeve të zhvilluara, në të cilat parimet e përfshirjes dhe të përjashtimit zbatohen, në disa raste, nëpërmjet formave të kamufluara të “patriotizmi” fetar, historik, gjeografik, ligjor apo institucional. Veç hapjes etno-kulturore të shqiptarëve, shpirtit të tyre të solidaritetit, përbërjes së përzier multifetare dhe tolerante të familjeve shqiptare, një rol pozitiv kanë luajtur historikisht e në mënyrë pragmatike, në përputhje me bazën ligjore, statusore apo kanonike të tyre, dhe të gjitha fetë e praktikuara në Shqipëri. Në mënyrë të natyrshme, kërkohen ende përmirësime për një evolucion të mëtejshëm të këtij realiteti, për të hartuar dhe harmonizuar më drejtë legjislacionin shqiptar me atë të vendeve të Evropës Perëndimore dhe legjislacionin më të përparuar ndërkombëtar, që vë qartë theksin mbi karakterin sekular të shtetit. Pra, as fetë nuk mund të interferojnë drejtpërdrejt në përmbajtjen natyrore e demokratike të shtetit dhe të veprimtarisë sekulare të tij, as shteti nuk mund të interferojë me ndonjë rol “paternalist” në zhvillimin e ideve,

të lirisë së besimit apo mënyrës e strukturës së funksionimit të këtyre feve të praktikuara në Shqipëri. Në këtë kuadër, do të ishte krejtësisht pakuptim, madje diskriminuese dhe e rrezikshme, në qoftë se do të tentohej të luhej roli paternalist, të interferohej apo të ndërhyhej nga jashtë, apo këtë rol t'ia “delegonte” vetes një shtet tjetër apo ndonjë strukturë fetare e tij. Një përpjekje e tillë, që “lexohet” aktualisht në disa zona të Shqipërisë, prek thelbin e parimit të mishëruar në Magna Carta, në lidhje me fenë, që në mënyrë sintetike nënvizon se *“asnjë nuk mund të vuajë humbjen e lirisë”*.

Demokracia, të drejtat e njeriut dhe shoqëria civile. Duke dënuar fuqimisht terrorizmin e çfarëdo lloji apo origjine, duhet diferencuar qartë lufta kundër terrorizmit me përpjekjet e manipulimet për të mos respektuar të drejtat legjitime të popujve që ndodhen nën pushtimin, shfrytëzimin dhe kontrollin e huaj, të drejta këto të garantuara nga ligji ndërkombëtar dhe Karta e Kombeve të Bashkuara. Njëkohësisht, nuk duhet të mungojë vigjilenca lidhur me respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, për të shmangur edhe synimet më minimale të regjimeve antidemokratike dhe autokratike për të ushtruar dhunë apo spekuluar me “mbulesa” të sajara apo të kamufluara të luftës kundër terrorit e terroristëve, në ruajtjen e pushtetit antidemokratik. Krahas informacionit e mbikëqyrjes ndaj çdo abuzimi të kësaj natyre, kërkohet dhe një bashkërendim më i mirë për të reaguar drejt e shpejt ndaj këtyre synimeve autoritare, për të dhënë në çdo rast përgjigje ambicioze e të efektshme ndërkombëtare, nëpërmjet “kombinimit” të demokracisë, lirisë dhe të drejtave njerëzore me rritjen e aftësisë së strukturave të rendit e sigurisë dhe ndërveprimit sa më të ngushtë të shërbimeve sekrete, për të mos lejuar e për të bllokuar njëkohësisht dhe mundësitë e financimit të terrorizmit apo të rrjeteve të tjera kriminale. Për më tepër, po del si më se i nevojshëm përmirësimi e plotësimi i kompetencave ekzistuese ligjore në një numër fushash, duke rishikuar apo mbikëqyrur vetë zbatimin në praktikë të konventave mbi liritë dhe të drejtat njerëzore. Forcimi i mëtejshëm i demokracisë dhe i shoqërive civile në botë, i lirisë dhe të drejtave të njeriut, janë dhe do të jenë padyshim një

instrument tjetër jo pa rëndësi në luftën kundër terrorizmit, i cili mund të “mbillet” e të “kultivohet” më lehtë atje, ku ai mungon ose nuk ka peshë. Dhe ky instrument nuk mund të injorohet apo mohohet, për të lejuar një deficit në rritje të demokracisë në botë. Pasi Samuel P. Huntington emërtoi “*Välën e tretë të tranzicioneve*” që nisi në Portugali dhe në Spanjë, të ndjekur me Amerikën Latine gjatë viteve ‘80 dhe që arriti pikën kulmore me proceset demokratike në Evropën Lindore dhe në disa vende të krijuara nga shpërbërja e ish Bashkimit Sovjetik, bota është zhytur në një fazë të re, jo pa vështirësi praktike e konceptore. Madje, për shumë arsye, edhe nën kërcënimin e një “deficiti” demokratik dhe të një “brishtësie” sociale! Shpresat e mëdha që pasuan procesin marramendës së tranzicionit ia kanë lënë vendin, akoma dhe sot, zhgënjimit masiv, një ekonomie të dobët dhe një mungese demokracie në përmbajtje, duke ofruar opsione të pakta madje edhe gjatë zgjedhjeve periodike pluraliste, jo gjithnjë të lira e demokratike, për shkak të defekteve në mendësi, legjislacion e struktura institucionale apo si rrjedhojë e paaftësisë politike për të konsoliduar institucionet dhe për të kontrolluar korrupsionin, që në Shqipëri ka marrë dhe natyrë kapilare.

Shoqëria shqiptare merr pjesë në çdo iniciativë për demokratizimin e mëtejshëm, integrimin politik, bashkëpunimin ekonomik dhe globalizimin shumëpërmasor, duke pasur parasysh se çdo sistem i institucioneve të ndryshme kolektive, që përfaqësojnë tipin e globalizmit nga lart-poshtë nuk do të ishte i plotë dhe krejtësisht i frytshëm në rast se ai nuk do të ndiqej dhe nga procesi tjetër nga poshtë-lart i globalizimit nëpërmjet shoqërisë civile, për të cilën roli dhe fryma e një media të re konstruktive dhe të qytetëruar janë mjaft të nevojshëm e të mirëpritur. Njëkohësisht, është pjekur mendimi për të inkurajuar ose për të nxitur të gjithë ndryshimet në proces, që synojnë të rrisin efektshmërinë dhe dinamizmin e institucioneve, të organizatave dhe instrumenteve mbështetëse të tyre, si në nivel ndërkombëtar, ashtu edhe në atë evropian. Njëfarë mungese në efektshmëri, që buron në këtë nivel si rrjedhojë dhe e rregullave të tepërta, procedurave dhe veprimeve “aglomeruese” përkatëse, është

gjithashtu pjesë e çmimit të paguar për zhvillimin demokratik, për të shmangur si pushtetet e pakufizuar, ashtu dhe spontanitetin e arbitrarishtin në vendimmarrje. Sidoqoftë, në arkitekturën ndërkombëtare, politike, ekonomike dhe financiare, ende ndihet një nevojë urgjente për reforma të shpejta që plogështia të mos fitojë terren ndaj dinamizmit dhe veçanërisht për të realizuar një konkurrencë apo pajtueshmëri më të mire, një përputhje më të drejtë midis dy objektivave njëherazi plotësues dhe kontradiktor: objektivit të demokratizimit të mëtejshëm dhe atij për më tepër efektshmëri e dinamizëm. Dhe kjo kërkon shkallë më të lartë qytetarie, edukimi e kulture.

Vlera e edukimit dhe edukimi i vlerave. Me të drejtë mund të shtrohet pyetja: Pse u desh kaq kohë për të arritur në qytetërimin evolutiv që njohim sot? A nuk ishin vallë pengesa vetë sistemet shoqërore e politike dhe jo mungesa e përfytyrimit, të kapaciteteve e aftësive të gjenisë njerëzore? Në të vërtetë, jo në pak raste, ne kemi lexuar, parë ose përjetuar ato përvoja, ku shteti e institucionet e tij kanë penguar progresin dhe ndryshimet. Por kjo, edhe pse vonesë-sjellëse në shtrirjen e kufizuar kohore, nuk mund të ndryshonte prirjen e përgjithshme, që ka përfaqësuar progresin.

Në të vërtetë, ka qenë pikërisht revolucioni industrial me përmbajtje të thellë teknologjike-shkencore, që i hapi rrugën zhvillimit politik-social e pasurimit të mëtejshëm emancipues të shoqërive të civilizuar perëndimore, të ngritura mbi simbiozën e madhe: të shkencës dhe të teknikë-teknologjisë, të avancuara e të mbështetura gradualisht një legjislacion social, në të cilin përfshihej respektimi i sindikatave e i të drejtave të punëtorëve, kujdesi shëndetësor, kujdesi për të moshuarit, etj. Madje, prania “kërcënuese” e një kampi ideologjik komunist-centralist me një propagandë të fuqishme “barazie” e “shoqërizimi”, edhe pse jo të ndeshura në realitetin konkret, ndihmoi shoqëritë perëndimore të ecnin më shpejt në zhvillimin e tyre ekonomiko-social. Dhe, në këtë kuadër, edhe në ngritjen mesatare të standardit të jetesës e të reformimit serioz demokratik e veçanërisht të programeve të trajtimit social. Një betejë përfundimisht e fituar në të gjitha planet

nga shoqëritë demokratike perëndimore. Megjithatë, ende ka shumë pika të panjohura për të ardhmen e ekonomisë botërore e të vetë shoqërisë njerëzore, të vetë evolucionit civilizues të saj. Disa nga këto dyshime ekzistojnë për arsyen e thjeshtë se zhvillimi teknologjik e shkencor dhe vetë shkencë e humbën, në garën marramendëse të fitimit, një pjesë të prestigjit të tyre të mëparshëm, për shkak të keqpërdorimit të teknologjisë, veçanërisht në fushën ushtarake. Për më tepër, falë përsosjes teknologjike dhe “prirjeve fitimprurëse” të biznesit, deri në media, madje edhe në shkencë, art e kulturë, është shfaqur një prirje tepër negative. Kështu, në mënyrë të natyrshme, larg pasionit dhe idealizmit të kaluar të tyre, ka dalë tashmë në skenë një kundërvënie dialektike midis dy trashëgimive të mëdha të qytetërimit perëndimor: vlerës dhe arsyes. Tensioni midis tyre ka pasur një ndikim negativ mbi secilën hallkë të këtij binomi, gjë që gjen pasqyrim, edhe pse ndoshta jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, në rritjen e shkallës së ndotjes jo vetëm mjedisore, por dhe asaj shpirtërore...

Nga ana tjetër, raporti i ngushtë midis vlerave dhe edukimit janë çmuar që në kohët e lashta nga mësuesit, filozofët dhe shkencëtarët, të cilët kanë konstatuar se për mbijetesën e një populli e kombi nuk mund të injorohen vlerat e tradita, jetëgjatësia dhe pesha e të cilave varet nga shkalla e edukimit individual apo kolektiv. Me to janë kushtëzuar jo pak dhe siguria kolektive e individuale.

Lidhja midis vlerave dhe edukimit është kaq e qartë dhe e rëndësishme sa që bëhet pothuajse e pamundur të imagjinohet një edukim e arsimim pa vlera, një proces demokratizimi *pa edukim e qytetari*. Edhe në rastet kur duket se edukimi nuk transmeton drejtpërsëdrejti vlera, ai i mbart ato në vetvete, madje vepron dhe nëpërmjet shembujve. Në mënyrë të veçantë familja dhe feja janë elementë shumë të rëndësishëm për transmetimin e këtyre vlerave dhe të virtyteve si në nivelin individual, ashtu dhe në kuadrin e shoqërisë civile, në një plan shumë më të gjerë. Kjo ndihmon për të shmangur, qoftë dhe pjesërisht, rrezikun potencial të ashtuquajturit *homogjenizim njerëzor*, që “kërcënohet” edhe nga mbizotërimi i një kulture, gjuhe e teknologjie apo, në njëfarë niveli, përmes realizimit të

një edukimi më të unifikuar apo dhe vetë globalizimit një-përmator të informimit e të teknologjisë së tij. Dhe kjo nuk është se nuk po shfrytëzohet në propagandën e fundamentalizmit fetar, duke krijuar probleme serioze për sigurinë.

Një aspekt tjetër, që “zgjimi edukativ” apo rritja e shkallës së shkollimit do ta nxjerr edhe më në pah, është disniveli aktual midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, me fjalë të tjera, diferencat jonormale dhe një standard tepër i lartë jetese i ngritur mbi një tjetër tepër më të ulët apo të pakrahasuar me të. Ky do të jetë dhe “zgjimi” i pritshëm i kontinentit afrikan, ndërkohë që kontinenti aziatik pas zgjimit të ndodhur kohë më parë është futur tashmë përgjithësisht, jo pa pak probleme, në një rrugë intensive e konkurruese zhvillimi.

Po ashtu, nuk mund të kalohet në heshtje fakti se popullsia botërore është pothuajse dyfishuar gjatë shekullit të XX-të dhe ka prirjen të dyfishohet dhe të arrijë mbi 10 miliard banorë aty nga vitet 2050-2080. Kjo rritje e madhe do të ndodhë dhe ne nuk mund të presim dhe vetëm të imagjinojmë apo të ëndërrojmë se si do të jetë bota në këto vite dhe me çfarë problemesh do të përballet ajo, por dhe ta paraprijmë këtë rritje, të parashikojmë, të veprojmë, madje të modelojmë që sot e sa më drejtë këtë të ardhme mbi bazën dhe të një edukimi më masiv e cilësor për brezat që do të vijnë. Dhe njëkohësisht, në kuadër të sigurisë, ta ruajmë planetin tonë nga ndotja shkatërrimtare!

Nga ana tjetër, do të duhet, së paku, dyfishimi i sasisë së ushqimit për të plotësuar nevojat për konsum, kërkohen zgjidhje për problemet urgjente të furnizimit me ujë të pijshëm dhe për gjithnjë e më shumë energji. D.m.th., në fund të fundit, kërkohen zgjidhje të reja teknologjike që jo vetëm do të rrisnin por dhe do të përmirësonin efektivitetin e prodhimit të energjisë, shoqëruar domosdo dhe me përpjekje për të eliminuar, reduktuar apo kufizuar shkarkimin e mbeturinave apo rrjedhjen e panevojshme të gazrave në atmosferë dhe në përgjithësi, për të mënjanuar “efektin serë” dhe kërcënimet e mëdha ndaj mjedisit që, siç duket, mund të shoqërojnë, po të mos merren masa serioze e urgjente që sot, me një rrezikshmëri më të lartë shekullin XXI.

Megjithatë, është ky shekull, që i mbështetur në një zhvillim të ri demokratik e arsimor, do t'i japë një përmasë të re vetë zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, dhe do të rrisë në mënyrë të ndjeshme aftësinë e shoqërisë njerëzore për të përballuar sfidat e mëdha që e presin në vitet që do të vijnë. Por natyrisht, vetëm korrigjimet, përmirësimet e progresi i “teknologjisë së pastër” nuk mjaftojnë e nuk mund të mjaftojnë. Po bëhet më se i domosdoshëm zhvillimi i mëtejshëm i përbërëseve shpirtërore, duke synuar me më shumë preokupim ruajtjen e një familjeje të shëndoshë, si bazamenti më i fortë i zhvillimit qytetar dhe i edukimit të vlerave civile, si një qelizë e nevojshme e rendit shoqëror dhe e mirëqenies së kombeve dhe të shteteve. Pa e tepruar, vetëm mbi këtë njësi bazë të kohezionit e të ripërtëritjes së shoqërisë mund të ngrihen përbërëset e jashtme të sigurisë ekonomike dhe të drejtave e të lirive njerëzore. Kjo nuk do të thotë aspak që politika e re të ngrihet mbi nepotizëm, trashëgiminë dinastore, ngjashmërinë etnike, lidhjen fetare apo afërsinë hapësinore gjeografike e familjare, por përkundrazi mbi parimin moral të kohezionit familjar e qytetar dhe të parimit sintetik: “*Liri për të gjithë*”, të përcaktuar në Deklaratën e Pavarësisë të SHBA. Është ky parim, që sintetizon, në mënyrën më të përmbledhur, përfundimin “detyruës” dhe shqetësimin publik mbi universalitetin e gabueshmërisë njerëzore, që na bën apo duhet të na mbajë të ndërgjegjshëm për rreziqet që mund të lindin gjatë çdo qeverisjeje, duke përfshirë dhe atë që pretendohet si tepër demokratike! Është kjo më shumë se arsye që, një demokraci e mbështetur mbi parimet e lirisë dhe të barazisë, të ketë para së gjithash vlera morale, shkallë të lartë edukimi, një qytetari të formësuar për të vepruar në mënyrë efektive, sepse siç ka thënë dhe Lordi Brougham: “*Edukimi i bën njerëzit të lehtë për t'i udhëhequr, por të vështirë për t'ju imponuar, të manovrueshëm për t'i qeverisur, por të pamundur për t'i skllavëruar*”...

Pikërisht me këtë frymë të barazisë politike e të edukimit të gjithanshëm do të mund të përballohen më mirë dhe sfidat më kryesore të dhjetëvjeçarëve të ardhshëm. Edukimi, qytetërimi e kulturimi shoqëror, zhvillimi i mëtejshëm dhe

instalimi i vërtetë i “ideologjisë” së të drejtave dhe lirive të njeriut, si ideologji e “filozofi” e vetme e shekullit të ardhshëm, ngritja e një ekonomie morale tregu në shkallë ndërkombëtare në vend të një ekonomie sociale tregu në shkallë kombëtare në luftën për reduktimin e varfërisë dhe të hendekut teknologjik, rritja e kapaciteteve globale të sigurisë njerëzore, zhvillimi i pluralizmit gjuhësor dhe diversitetit kulturor në vend të homogjenizimit njerëzor etj. janë disa nga shtyllat e integritetit ndërkombëtar, të progresit shoqëror dhe të rritjes së sigurisë njerëzore. Madje, për zhvillimin normal të shoqërisë njerëzore, në përballimin e tendencave negative homogjenizuese të procesit të globalizimit, shumëllojshmëria e kulturave duhet të mbetet një faktor që të përkrahet nga të gjithë. Ajo imponon vullnetin e dëshirën e mirë politike të organizimit, të respektit reciprok etnik e fetar, fantazinë dhe pranimin e pasurisë kulturore shumëpërmasore, forcën shoqërore të transmetimit e përvetësimit historik, të depërtimit e integritetit, por mbi të gjitha ajo kërkon vetëdijen e identitetin e vet, ruajtjen e traditës, të së vërtetës historike dhe të qartësisë njerëzore e shkencore. Për këtë, më shumë impenjim reformues, konceptim realist e mbështetje serioze mund e duhet të realizohet e të aplikohet në nivelin botëror nga organizma të tilla globale si UNESCO, PNUD etj.

Gjithashtu, në përballimin e këtyre sfidave të mëdha do të ndihmonte dhe përshpejtimi i realizimit konkret e pararendës i shumë elementëve të tjerë siç janë: çarmatosja e përgjithshme; ngritja në pedestal e “tabusë morale” mbi dhunën; krijimi, përmirësimi apo rritja e efektivitetit dhe e dinamizmit të instrumenteve botërore e mekanizmave ndërkombëtarë; instalimi në rrafsh global i drejtësisë efektive dhe të kapshme ose të paktën ndërtimi i organizmave që dënojnë padrejtësitë e ndjeshme ndaj individëve dhe grupeve, siç u veprua e veprohet me Gjykatën e Hagës për Krime Luftë në ish Jugosllavi apo synohet sot me Gjykatën Penale Ndërkombëtare, Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg etj.; mbështetja e gjithanshme për tolerancë reciproke ndaj ndryshimeve dhe manifestim të lirë të shumëllojshmëri; angazhimi në çdo nivel në plotësimin e

nevojave thelbësore të gjithë njerëzve, qoftë edhe duke sakrifikuar diçka nga “parajsat” individuale apo lukset e tepruara; rritja e kujdesit për mjedisin dhe kalimi nga riparimi i dëmtimit e riciklimi i mbetjeve mjedisore në penalizimin e ashpër ndërkombëtar ndaj çdo “veshi të shurdhër” dhe zbatimi teknologjik në dëm të ruajtjes së natyrës dhe mjedisit në përgjithësi; lufta e tërësore kundra kriminit dhe degradimit njerëzor etj...

Por edhe me realizimin e këtyre kërkesave kjo botë nuk mund të jetë kurrë ideale, plotësisht e sigurt. Pakënaqësitë, ndryshimet, përplasjet e kontradiktat, konfliktet dhe pasiguritë do të vazhdojnë, pavarësisht që mund të arrihet një ulje e shënuar e intensitetit dhe frekuencës së tyre. Shoqëria njerëzore si një sistem tepër i ndërlikuar, si dhe çdo sistem tjetër makroskopik, nuk mund të arrijë dhe nuk ka si të arrijë “temperaturën zero” apo “*Happy End*”-in (“*Fundin e lumtur*”) të saj. Nuk mund të ketë kurrë “një fund të historisë” me bazë njerëzore, një fund të progresit apo të lëvizjes përpara të kësaj shoqërie, të paktën në kuptimin e arritjes në majën e një strukture politiko-sociale, të një sistemi ekonomiko-financiar dhe të një ideologjie, që mund të qetësonin e kënaqnin të gjithë, dhe ku çdo qenie njerëzore mund të jetonte tërësisht e barabartë, e lirë dhe e lumtur. Ndërkohë, nga pikëpamja shkencore, progresi i vërtetë shoqëror, në kuptimin e prirjes, pavarësisht historisë të mbushur me të ashtuquajtur apo të klasifikuar revolucione, është kryesisht një progres evolucionar me natyrë të pafundme, një ndryshim pozitiv në vazhdimësi, i realizuar nëpërmjet procesesh të njëpasnjëshme ndryshimesh, përmirësimesh e përafrimesh...

Megjithatë, pavarësisht këtij gjykimi përgjithësues, me të drejtë, sot ekziston bindja se arsimimi, edukimi qytetar dhe fuqizimi në vazhdimësi i shoqërisë civile, do të jenë, madje duhet të jenë parametra shoqëruar të këtij zhvillimi. Po aq e dobishme, madje e domosdoshme do të rezultonte dhe përsosja e dialogut ndërkulturor, që do të favorizonte një hapësirë të re lirie midis etnive, kombeve e feve. Madje, kultura do të duhet të realizojë më shumë njohje, kontakte, shkëmbim, dialog, marrëveshje e integrim dhe sa më pak mbyllje në “kuti”,

izolim, ndarje, kundërshti apo heshtje ndaj njëri-tjetrit. Pra, në këtë botë, në kërkim të zgjidhjeve më të mira, ende tepër larg një përsosjeje relative, ku kontaktet dhe marrëdhëniet njerëzore kanë një rol mjaft të rëndësishëm, është më mirë dhe më e frytshme për t'iu bashkuar procesit të hapjes e shkëmbimit intensiv kulturor, emancipimit politik, integritit e globalizimit sesa të qëndrosh jashtë tij, gjoja për t'u mbrojtur, dhe të presësh ndryshimin. Sepse në botën globale çdo gjë lëviz, lëvizin njerëzit, lëvizin njohuritë, lëvizin skemat kulturore e edukuese etj. Në të vërtetë, përfshirja në këtë proces, me guxim dinjitoz e tërë kapacitetin e shkëmbimit, është dhe mbrojtja më e mirë qytetare-kulturore, që i shërben përparimit social-ekonomik dhe një sigurie më të lartë kolektive e individuale. Kjo frymë e kulturë historikisht ndërvepruese e shkëmbyese, nga mjediset akademike-shkencore, artistike e sportive, “pa u kuptuar”, është transmetuar e induktuar, edhe pse jo tërësisht, edhe në nivelet vendimmarrëse, politiko-qeverisëse.

Kultura e re qeverisëse dhe globalizimi nga poshtë. Thelbi i mendimit të ri demokratik përmbledhet edhe në atë që shteti konsiderohet vetëm si një makineri administrative qeverisëse, e krijuar mbi bazën e vullnetit të lirë zgjedhor të qytetarëve, për të mirën e tyre, të qytetarëve të lirë të një shoqërie civile krejtësisht të hapur, të ndërtuar mbi respektin ndaj Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Pra, kjo makineri shtetërore funksionon në bazë të një kontrate sociale, të vendosur mbi rregulla plotësisht të përcaktuara të brendshme e të jashtme, për të shërbyer si mjet organizimi, administrimi e menaxhimi për mirëqenien, mirëkuptimin e sigurinë e qytetarëve, por jo për t'i shfrytëzuar, komanduar e shtypur ata . Dhe për sa kohë shteti e propagandon këtë rol, por dhe e shformon atë, për “vajosjen” e ingranazheve të tij, tepër të dobishëm janë dhe do të mbeten organizmat sensibilizues e reagues, pse jo dhe kontrollues, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, si Avokati i Popullit, Komitetet e Helsinkit të çdo niveli, forumet e tjera të të Drejtave e Lirive të Njeriut, OJQ-të e profileve përkatëse, gjykatat e llogarive, gjykatat e pavarura të çdo shkalle deri gjykatat ndërkombëtare, media e lirë etj.

Por sot po aq i rëndësishëm është edhe përcaktimi më i mirë i raportit të një shteti me shtete të tjera, ose akoma më thjesht, raportet ndërveprues midis tyre, veçanërisht në fazën e globalizimit e integritimit të gjithanshëm. Një nevojshmi e tillë, ligjore e strukturore, është kuptuar shumë kohë më parë. Madje shekulli i XX-të, ka qenë më se i dobishëm e prodhues në këtë drejtim. Kështu, p.sh., vite më parë, dy vjet përpara se Uilson të konceptonte idenë e *Ligës së Kombeve* (që më vonë çoi në krijimin e OKB-së), Ruzvelt bëri thirrje “*për një marrëveshje botërore midis të gjitha fuqive ushtarake të civilizuar për të mbrojtur të drejtën me forcë*” (gjë që çoi më vonë në krijimin e Aleancës së Atlantikut Verior, NATO-n).

Një raport ndërshtetëror efektiv, është sa i nevojshëm e orientues në përgjithësi, po aq dhe i pashmangshëm e i detyruar në fushën ekonomike. Edhe pse, në linja të përgjithshme, ai është menduar, projektuar e planifikuar me largpamësi nga ata që krijuan institucionet e Bretton Woods (sot BB-ja, FMN-ja) dhe GATT-it (sot OBT-ja), që aktualisht janë ende në lulëzim e ekspansion, përsëri vihen re probleme e shqetësime jo të pakët, të shoqëruar edhe me kriza lokale serioze. Nuk mungojnë as zërat kritikë për ecurinë, mënyrën e rekrutimit e trajtimit financiar të kuadrit, të sjelljes e përgjegjësisë apo mospërgjegjësisë reale të këtyre institucioneve në vendet, ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Megjithatë, pavarësisht kërkesës normale për rritje të efektivitetit të këtyre institucioneve, globalizimi, i bazuar në kombinimin e liberalizimit të shkëmbimeve të mirave materiale dhe të transferimit e lëvizjes së kapitalit në shkallë ndërkombëtare, po intensifikohet e profilizohet në mënyrë të shënuar, në sajë të ndryshimeve thelbësore politike e konceptore dhe përshpejtimit galopant të progresit teknologjik në fushën e informimit e telekomunikimit. Por kjo përmasë e re globalizimi kërkon një reflektim serioz për pasqyrimin e tij në jetë e shkollim, në mbështetje të lëvizjes së lirë dhe të mutacioneve të tregut të punës e të hallkave të ndryshme të menaxhimit dhe drejtimit, ku në vend të sistemit hierarkik duhet të adaptohet *organizimi rrjetor dhe puna në ekip*. Dhe kjo vlen edhe për makinerinë qeverisëse-shtetërore.

Por, në mënyrë të natyrshme, ashtu si krijimi i disa strukturave apo organizatave politike ndërkombëtare ndihmoi

fillimisht në rritjen e bashkëpunimit midis vendeve, ashtu dhe globalizimi ekonomik sot po shërben si mjet e bazament për fuqizimin apo krijimin e in granazheve dhe të mekanizmave globalë politikë apo politiko-ushtarakë. Kështu, përveç OKB-së, OSBE-së, BE-së, KE-së, NATO-s etj., janë krijuar e po krijohen edhe institucione të tjerë apo iniciativa rajonale e ndërkombëtare për t'i dhënë më shumë forcë, stabilitet e mbështetje shteteve pjesëmarrëse. P.sh., në Bashkimin Evropian në periudhën e fundit, në vend të BEP-it, është krijuar një strukturë e re e sigurisë dhe mbrojtjes e emërtuar ESDI (*European Security and Defense Identity*). Madje, për më tepër, çdo ditë e më shumë, vendet anëtare të BE-së, p.sh., po përpiqen të shpalosin statusin e tyre ndërkombëtar jo aq në përputhje me fuqinë e tyre kombëtare, sesa të lidhur ngushtë me anëtarësinë në BE. Por, siç është nënvizuar edhe më parë, ky globalizim “qeverisës” *vetëm nga sipër* nuk mund të jetë zgjidhja më e drejtë dhe e plotë e problemit, sepse ai mund dhe të shfaqë ndikime negative mbi thelbin e pluralizmit, të demokracisë dhe të diversitetit. Ndërkohë, që ai mund të shoqërohet edhe me hezitime e ndikim frenuese madje, ndoshta, dhe me frikë, ndaj vetë thellimit të procesit të mirëpritur të globalizimit nga sipër e homogjenizimit për të gjithë grupimet në shoqërinë njerëzore. Prandaj, dhe vlen të ëndërrohet për nevojën e globalizimit *edhe nga poshtë*, nëpërmjet shoqërisë civile, e cila përgjithësisht shfaqet si një forcë oponente dhe kundër-balancuese e qeverisjes, si një mjedis aktiv e inteligjent, që i zbut dhe sfumon politikat konfliktuale.

Në këtë konceptim, funksionimi e krijimi i disa mekanizmave ndërkombëtarë me përbërëse të veçanta përfaqësuese të shoqërisë civile (siç është p.sh., Kryqi i Kuq Ndërkombëtar), po krijon premisa pozitive në vetë procesin e domosdoshëm të globalizimit nga poshtë, për të dobësuar “bërrylat” apo “tërheqjet”, që vijnë nga shtetet e vjetër nacionalë dhe makineritë e vjetruara qeverisëse të tyre. Por dhe këto mekanizma, ashtu si dhe për strukturat e tyre lokale, duhet trajtuar me kujdes për të shmangur ekzistencën e një rreziku potencial të shformimit të tyre, në dëm të rritjes së standardit të përgjithshëm të jetesës dhe sigurisë.

Marina Caparini dhe Philipp Fluri

AKTORËT E SHOQËRISË CIVILE
NË ÇËSHTJET E MBROJTJES
DHE TË SIGURISË

(përmbledhur nga Elira Hroni)

Shoqëria civile është një term i rëndësishëm në analizën politike bashkëkohore.

Një trup i rëndësishëm i literaturës akademike e ka zhvilluar këtë koncept, dhe rolin kyç që ai mund të luajë në konsolidimin dhe mbështetjen e demokracisë. (Diamond 1994; Burnell dhe Calvert 2004; Burnell dhe Calvert 2005).

Procesi i demokratizimit në Amerikën Latine dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore i drejtoi ekspertët ta paraqisnin shoqërinë civile si një faktor thelbësor në ndihmën për kufizimin e qeverisjes autoritare, forcimin e pjesëmarrjes politike të njerëzve, interesin mediatik dhe në ushtrimin e presionit për llogaridhënie politike. Një shoqëri civile e fuqishme dhe kumbuese besohet se përmban potencialin për të përmirësuar cilësinë e qeverisjes, në nivele kombëtare dhe globale (Cardoso 2003). Si e tillë shoqëria civile po themelon një element thelbësor të programeve për promovimin e demokracisë së aktorëve kombëtarë, ndërkombëtarë dhe joqeveritarë. (Carothers dhe Ottaway 2000; Quigley 1997).

Emergenca e reformave në sektorin e sigurisë (RSS), e cila është një përpyetje e gjerë dhe holistike me synimin për të përmirësuar efektivitetin dhe kontrollin demokratik dhe llogaridhënien e një sërë institucioneve shtetërore, ministrive, dhe aktorëve të përfshirë në arritjen e sigurisë, veçanërisht në shtetet në zhvillim dhe tranzicion (Wulf 2005), njeh kontributin e rëndësishëm të aktorëve të shoqërisë civile në qeverisjen demokratike të sektorit të sigurisë, veçanërisht nëpërmjet aftësisë së tyre për të rritur dijeninë publike rreth

çështjeve të sigurisë, për të artikuluar nevojat dhe interesat, për të siguruar informacion të specializuar dhe për të bërë ekspertizën për politikëbërësit, dhe nëpërmjet një roli monitorues përkundrejt shtetit. (Ball 1998; DFID 2002, pp. 20-21). Donatorët, në mënyrë që të sigurojnë politikën, kanë mbështetur qasje më përfshirëse rreth procesit të politikëbërjes dhe qeverisjes së mirë, duke përfshirë edhe ato të sektorit të sigurisë. (UNDP 2003, pp.5-6). Grupet e shoqërisë civile konsiderohen si 'bashkëbisedues politik' potencial që mund të inkurajojnë kërkesën lokale për reforma në sektorin e sigurisë dhe të sigurojnë një input praktik në zbatimin e tyre (OECD 2004, p.4).

Me gjithë vëmendjen gjithmonë e në rritje të akademikëve dhe të donatorëve përkundrejt shoqërisë civile, literatura dhe kërkimet në internet zbulojnë disa studime surprizuese duke ekzaminuar specifikisht reformat në sektorin e sigurisë dhe qeverisjen nga një perspektivë e shoqërisë civile. Shumë studime fokusohen në një element të veçantë të sektorit të sigurisë, siç është sektori i drejtësisë. Një shkollë e studimeve thekson perspektivën nga poshtë-lart, në të cilën nevojat për siguri dhe drejtësi të njerëzve të zakonshëm survejohen bashkë me perceptimet e tyre mbi efektivitetin e sistemeve të drejtësisë dhe të politikës së shtetit. (Asia Foundation 2001). Një studim i rëndësishëm i Bankës Botërore, për shembull, dokumentoi se si çështjet personale dhe fundamentale të sigurisë dominojnë shqetësimet e njerëzve të varfër nëpër botë, të lidhura këto me dështimin e shtetit për të siguruar shërbime thelbësore në sigurinë publike dhe aksesin në drejtësi. (World Bank 2000, pp.478-9, 492). Të tilla studime sugjerojnë mënyra se si mund të parashtrihen efektivisht nevojat e qytetareve, si p. sh. nëpërmjet programeve të ndërtimit të kapaciteteve për organizatat e shoqërisë civile, për të influencuar më mirë axhendën e politikës së sigurisë dhe prioritetet e shtetit. (Williams and Ocaya-Lakidi 2004).

Një iniciativë tjetër në reformat e sektorit të sigurisë ka të bëjë me inkurajimin e një qasjeje multilaterale ndërmjet organizatave rajonale të shoqërisë civile, ose me krijimin e 'rrjeteve të rrjeteve' në mënyrë që të injektohen perspektivat

lokale dhe prioritetet e sigurisë njerëzore në axhendën politike rajonale dhe internacionale, e cila perceptohet si e influencuar nga agjencite multilaterale, të cilat i rendisin nevojat e sigurisë dhe zhvillimit të qytetareve të rajonit ndërmjet kërkesave internacionale të sigurisë (Ratynska 2004).

Rrjetet rajonale të shoqërisë civile synojnë të informojnë më mirë aktorët e shoqërisë civile mbi eksperiencat rajonale dhe praktikat e mira në RSS, të ndërtojnë marrëdhënie, si dhe të zhvillojnë qasje të përbashkëta drejt një angazhimi të mëtejshëm të shoqërisë civile në RRS (Rrjeti Lehtësues Global 2004a and 2004b).

Ajo që ngelet për t'u zbuluar është një kuptim më i detajuar i mënyrës se si aktorët e shoqërisë civile dhe media angazhohen me shtetin, dhe se si efektivisht në një kontekst specifik ato ushtrojnë influencë në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë mbi elitat politike dhe politikëbërësit, zyrtarët, median dhe publikun e gjerë. Ky vëllim është një përpjekje paraprake për të adresuar këtë boshllëk duke eksploruar në një mënyrë më të fokusuar nëpërmjet studimeve konceptuale dhe empirike, të kuptuarin tonë për aktorët e shoqërisë civile dhe impaktin e tyre në sferën e sigurisë, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë shteteve në rajonet post komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore që janë duke shkuar nga tranzicioni drejt konsolidimit të demokracisë.

Çfarë është Shoqëria Civile?

Shoqëria civile i referohet grupimeve shoqërore vullnetare në një shoqëri, të cilat bazohet mbi shprehjen publike të interesave, prioriteteve, ankesave dhe vlerave. Me fjalë të tjera, njerëzit vullnetarisht formojnë grupe për të avancuar vlerat dhe interesat e tyre, dhe angazhohen në jetën publike jashtë familjes dhe vendit të tregut. Megjithëse përgjithësisht me këtë emër iu jemi referuar organizatave jo-qeveritare, shoqëria civile mund të përfshijë gjithashtu grupet e mbrojtjes, grupet e interesit, kishat dhe grupet fetare, shoqëritë profesionale, shoqëritë akademike, grupimet e grave, grupet rinore, grupet sportive dhe çdo formë tjetër të grupimeve shoqërore vullnetare. Shoqëria civile është vlerësuar shpesh si një hapësirë

ku mund të shprehen diversitetet dhe pluralizmi shoqëror dhe nga e cila mund të rritet përfaqësimi publik në qeveri.

Rritja e popullaritetit të konceptit të shoqërisë civile në rrethet akademike dhe politike është pjesërisht rrjedhojë e ndryshimeve të pritjeve dhe vlerave që shqetësojnë demokracinë dhe qeverisjen. Pranohet tashmë gjerësisht se politikat demokratike shkojnë përtej konkurrimeve periodike elektorale që karakterizojnë demokracinë formale, dhe bazohen në një kulturë përfaqësimi në të cilën qytetarët kërkojnë të ushtrojnë zërin e tyre aktivisht nëpërmjet mekanizmave të shumta të mundshme, siç është një shoqëri civile aktive (OJQ, lëvizjet sociale, organizata të tjera autonome), partitë politike dhe media pluraliste (Luckham, Goetz dhe Kaldor 2003, p. 20).

Një shoqëri civile kumbuese mund të performojë një rol informal mbikëqyrës në sistemet demokratike dhe të përmirësojë mundësinë e një qeverisje të mirë nëpërmjet ekspertizës së saj të decentralizuar dhe interesave autonome që afektohen dhe mund të influencohen nga aspekte të ndryshme të politikës së sigurisë. Kur aktorët e shoqërisë civile kanë mundësi të monitorojnë dhe pyesin qeverinë dhe agjentët e shtetit të saj në një mënyrë informuese dhe të ditur, të sigurojnë analiza alternative dhe opsione për politikën, dhe të përmbushin një rol edukativ dhe informues mbi politikëbërësit si dhe mbi publikun e gjerë për çështje specifike, atëherë ata mund të kontribuojnë për kualitetin e qeverisjes në një demokraci.

Think tanket dhe institutet e kërkimeve të politikës publike janë sigurisht një pjesë e shoqërisë civile. Gjithsesi në sferën e mbrojtjes dhe të sigurisë ato janë shpesh aktorët më të spikatur të shoqërisë civile. Kjo pjesërisht për shkak të natyrës tepër të specializuar të çështjeve të mbrojtjes dhe të sigurisë, dhe të dijes së ekspertit që është e kërkuar në mënyrë që të influencojë politikën e qeverisjes në ato fusha. Përveç influencimit të politikës nëpërmjet furnizimit me informacion, analiza dhe këshilla, kërkimet në fushën e sigurisë dhe institutet politike mund të ndihmojnë për informimin e medias dhe publikut të gjerë mbi çështjet e politikës.

Aktivitetet e shoqërisë civile mendohet se kontribuojnë në kualitetin e demokracisë ashtu siç edhe presioni që ato ushtrojnë mbi qeverinë, ndihmon për të mbajtur politikanët e zgjedhur dhe shtetin më shumë në llogari ndaj njerëzve në periudhën midis zgjedhjeve, atëherë kur vullneti i njerëzve ushtrohet formalisht dhe shprehet drejtpërdrejtë në zgjedhën e përfaqësuesve të tyre. Rritja e suportit dhe miratimit të shoqërisë civile si një koncept politik është e bazuar në pikëpamjen se njerëzit në një politikë demokratike e shprehin mendimin dhe preferencat e tyre midis zgjedhjeve, duke kërkuar të influencojnë drejtimin e çështjeve publike dhe politikës publike, dhe kjo dëshirë për t'u angazhuar si grupe në jetën shoqërore dhe ndonjëherë politike të shtetit është një komponent fundamental i demokracisë.

Kështu pra, inputi i aktorëve të shoqërisë civile në politikën publike shihet si një shenjë e demokracisë liberale pluraliste.

Organizatat e shoqërisë civile (CSOs) shërbejnë si kanale për të shprehur diversitetin dhe ndonjëherë interesat sociale kontradiktore ose konfliktuale në një demokraci. Është e rëndësishme të theksojmë se angazhimi civil nuk është gjithmonë ose domosdoshmërisht 'qytetar', sepse ai mund të përmbajë demonstrime, bojkote, greva, protesta paqësore dhe ndonjëherë edhe protesta violente, si dhe elementë të mirë të vetë-ndihmës, si vullnetarizmi dhe puna e papaguar konstruktive në komunitete që mendohet zakonisht kur përmendet shoqëria civile.

Për më tepër, po pranohet gjerësisht se jo të gjithë aktorët e shoqërisë civile shfaqin vlera qytetare dhe disa grupe të shoqërisë civile mund të jenë përjashtues dhe të promovojnë vlera jodemokratike dhe joliberalë ose konflikte ndërkomunale (Chambers dhe Kopstein 2001). Disa grupe autonome në vendet në tranzicion ose në zhvillim mund të kenë një interes në mbajtjen e kapaciteteve të varfra shtetërore, në mënyrë që të shfrytëzojnë dhe të përfitojnë nga paaftësia e shtetit për të mbajtur kontrollin dhe rendin publik brenda territorit të tij. Aktorë të tillë si grupet e mafias, banda të armatosura, organizatat ushtarake dhe paraushtarake konsiderohen si 'shoqëria jocivile' (Kopecky dhe Mudde 2003). Në mënyrë të

ngjashme, në shtetet demokratike industriale të zhvilluara disa grupe si segregacionistët ose supremacistët e bardhë me siguri që nuk mund të zhvillojnë normat ose principet demokratike.

Ekzistenca e grupeve 'jocivile' në shoqëri thekson natyrën esencialisht kontestuese të përkufizimit të shoqërisë civile. Autorë të caktuar janë përpjekur të ngushtojnë nocionin e shoqërisë civile: në ato grupe që pranojnë rregullat shoqërore dhe sillen me një natyrë 'qytetare ose një natyrë respekti të ndërsjellë'. (Schmitter 1997, p.240). Gjithsesi, roli që shoqëria civile luan si në suportin e demokratizimit ose në pengimin e tij, si duke e mbajtur shtetin në llogari ose duke qenë të forcurar për t'iu nënshtruar një shteti shtrëngues, duket se varet nga konteksti politik dhe ekonomik rrethues. (Ehrenberg 1999, pp.247-8). Pra këtu është e mjaftueshme të shënojmë se jemi duke vështruar një tip te veçantë të aktorëve të shoqërisë civile, një tip që ndihmon për të informuar politikën dhe kërkon një rol mbikëqyrës informal, dhe kështu kontribuon për një qeverisje të mirë të sektorit të sigurisë. Tipi i aktorit të shoqërisë civile të ekzaminuar që këtej e tutje është i predispozuar të jetë i tipit të 'mirë' megjithëse kjo nuk mohon ekzistencën e tipave të tjerë dhe as të impaktit të tyre potencial në fushën e politikës së sigurisë.

Shoqëria Civile dhe Qeverisja e Sektorit të Sigurisë

Një nga funksionet fundamentale të shtetit është të vendosë siguri për qytetarët e tij. Në fakt nocioni i shtetit Westphalian mbështetet mbi monopolin e mjeteve të forcës së legjitimuar nga shteti ose nëpërmjet aplikimit të sanksioneve shtrënguese nga policia për të rregulluar marrëdhëniet ndërpersonale brenda komunitetit ose nëpërmjet mbrojtjes që i sigurohet shtetit dhe shoqërisë nga forcat e armatosura kundra armiqve të jashtëm. (shiko Bayley 1975, p.328). Sektori i sigurisë përfshin ato institucione shtetërore funksioni primar i të cilave është të mbrojnë shoqërinë. Termi 'sektori i sigurisë' e zgjeron qëllimin e sigurisë nga fokusi i tij tradicional mbi ushtrinë drejt 'sigurisë publike' ose sigurisë së qytetarëve nga kërcënimet e krimeve, parregullsisë dhe dhunës.

Është i nevojshëm një fokusim mbi institucionet shtetërore (shpesh ekzekutivin) dhe politikën publike sepse reformat në sektorin e sigurisë (RSS) janë të përqendruara në përdorimin e burimeve publike për të garantuar siguri për qytetarët. Këto institucione përfshijnë forcat ushtarake, shërbimet e policisë dhe të zbatimit të ligjit, forcat paraushtarake, gardat kufitare, agjencitë informative, sistemin gjyqësor dhe institutet penale si dhe departamentet shtetërore dhe ministritë që ekzistojnë për të formuluar politikën dhe për të menaxhuar institucionet. Shumica e institucioneve që janë pjesë e sektorit të sigurisë janë të autorizuar për të përdorur ose kërcënuar për përdorimin e forcës, nëse është e nevojshme, në mënyrë për të përmbushur këtë funksion. Gjithsesi përdorimi i legjitimuar i forcës kundër qytetarëve të shtetit është i rregulluar në demokraci në mënyrë strikte.

Nga të gjithë sektorët e politikës publike, sektori i sigurisë ka provuar historikisht të jetë më rezistenti nga inputet publike. Ky është pjesërisht një funksion i rëndësishëm dhe kryesor i sigurisë kombëtare përgjatë ekzistencës së vazhdueshme të shtetit, dhe përgjatë prerogativës tradicionale të pushtetit ekzekutiv të qeverisjes, për të mbrojtur sigurinë kombëtare. Koncepti i 'sigurizimit' është përdorur për të përshkruar procesin, ndërkohë politikëbërësit aplikojnë etiketën e sigurisë kombëtare për të ndryshuar çështjet kundërshtuese të politikës publike në mënyrë që t'i ngrenë ato në nivelin e debatit politik (Waever 1998).

E drejta ndërkombëtare njeh të drejtën e shteteve për të kufizuar disa të drejta thelbësore të njeriut për arsye legjitime të sigurisë kombëtare ose rendit publik. Kërkesat e sekretit publik vendosin gjithashtu disa detyrime mbi tipat dhe sasinë e informacioneve që mund t'i jepet publikut nga elitat e qeverisë dhe nga institucionet e sektorit të sigurisë. Siguria kombëtare shpesh trajtohet si një fushë speciale, e cila është më pak e hapur se fushat e tjera të politikës dhe që kërkon kufizime të veçanta dhe përjashtime për sa i përket aksesit në informacion (Roberts 2004). Megjithatë, një rrezik i ndalimit të informacionit për arsye të sigurisë kombëtare është që sekretit shtetëror mund të përdoret jo vetëm për të mbrojtur interesat

e sigurisë kombëtare, por edhe për të fshehur abuzimet dhe keqmenaxhimet për t'iu shmangur vështirësive politike dhe llogaridhënies.

Shoqëria civile mund të luajë një rol të rëndësishëm, megjithëse përgjithësisht informal, për mbikëqyrjen e vendimmarrjes së qeverisë dhe sjelljes në çështjet e sigurisë. Ekspertiza civile njihet gjerësisht si një element vital në kontrollin demokratik të forcave të armatosura dhe strukturave të sigurisë në mbrojtje dhe çështjet e sigurisë nëpërmjet kapaciteteve që ajo paraqet për monitorimin e pavarur, kërkimet dhe vlerësimet mbi performancën e qeverisë dhe të shtetit.

Organizatat jo-qeveritare (OJQ-të) dhe elemente të tjerë të shoqërisë civile janë kryesoret në të cilën ekziston ekspertiza civile në aspekte të mbrojtjes dhe të sigurisë dhe që i japin zë kësaj ekspertize. Fuqizimi i shoqërisë civile në RSS i përket së pari ndërtimit të ekspertizës civile dhe kapaciteteve për të vlerësuar, sfiduar, ose mbështetur në mënyrë të pavarur vendimet e qeverisë dhe analizat e çështjeve të mbrojtjes dhe sigurisë dhe kërkesave në të cilat bazohet politika. Organizatat e shoqërisë civile që janë veçanërisht të rëndësishme deri më tani për arsye së anëtarët e tyre mund të posedojnë ekspertiza të specializuara në disa aspekte të mbrojtjes dhe çështjeve të sigurisë, mund të përfshijnë edhe departamentet e universitetit dhe institutet akademike, shoqëritë profesionale, grupet e të drejtave të njeriut dhe të lirive qytetare, grupet e paqes, gazetarë dhe organizata joqeveritare. Së dyti, fuqizim do të thotë gjithashtu të krijosh mundësi ose 'hapësira' për artikullimin e perspektivave të pavarura dhe pjesëmarrjen në një diskutim politik ose debat publik. Në nivelin më fillestar kjo kërkon një minimum standardi të lirisë së shprehjes, në mënyrë që qytetarët të mund të shprehin lirisht opinionin e tyre mbi politikën e qeverisë pa frikën e hakmarrjes dhe sanksioneve. Kjo kërkon gjithashtu atë informacion për politikën e sigurisë që është publikisht i disponueshëm. Në një nivel praktik, kur ne e konsiderojmë të specializuar një sferë aq sa është arena e mbrojtjes dhe sigurisë, angazhimi i aktorëve të shoqërisë civile shpesh merr formën e konsultimit publik për çështjet më të

rëndësishme të interesit publik nga qeveria aktuale (si p. sh. gjatë një paraqitjeje gjithëpërfshirëse të politikës së jashtme dhe të mbrojtjes). Kjo mund të sjellë më specifikisht thirrjen e ekspertëve të njohur dhe përfaqësuesve të grupeve të interesit për t'u shfaqur para komiteteve parlamentare ose për t'u konsultuar gjatë një procesi të politikëbërjes.

Organizatat e shoqërisë civile mund të asistojnë qeverinë në gjetjen e përgjigjeve dhe qasjeve për çështjet e politikës publike. Nëpërmjet diversitetit të pikëpamjeve dhe eksperiencave që ato përfaqësojnë, inputi i tyre mund të ndihmojë për ta bërë politikëbërjen e qeverisë më përfshirëse. Disa organizata të shoqërisë civile mundën gjithashtu të ekzaminonin nga afër qasjet dhe politikën e qeverisë nga fusha e veçantë e ekspertizës së tyre, duke e zhvendosur vëmendjen politike dhe publike drejt aspekteve dhe qasjeve që janë injoruar, harruar ose keqkuptuar. Në këtë mënyrë, duke shërbyer si një burim shtesë i analizës dhe informacionit mbi politikën dhe vendimmarrjen e qeverisë, hetimi publik nga organizatat joqeveritare dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile kontribuon për një qeverisje më të mirë. Organizatat e shoqërisë civile të përqendruara në mbrojtje dhe në siguri mund të ndihmojnë për të përhapur dije dhe për të krijuar një klimë opinionit që inkurajon llogaridhënien e qeverisë dhe një politikë të zgjuar.

Por kjo është vetëm njëra pjesë e ekuacionit të marrëdhënies midis shtetit dhe shoqërisë civile. Është gjithashtu e rëndësishme të kuptosh rolin e shtetit në inkurajimin e shoqërisë civile dhe në lehtësimin e angazhimit të publikut në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë. Cila është natyra e marrëdhënies midis organizatave të shoqërisë civile dhe shtetit? A është një partneritet bashkëpunues, apo aktorët e shtetit dhe ata të shoqërisë civile e konsiderojnë njëri-tjetrin si oponent ose kundërshtar? Disa aktorë të shoqërisë civile mund të kërkojnë që të sillen si mbikëqyrës mbi shtetin dhe kështu të funksionojnë si një lloj force për llogaridhënie (duke kërkuar që zyrtarët të informojnë rreth vendimeve për një çështje të caktuar dhe të shpjegojnë çfarë janë duke bërë, pra në këtë mënyrë duke u përpjekur t'i mbajnë ata të përgjigjshëm për

atë ç'ka ata kanë vendosur), dhe gjithashtu ata mund të sfidojnë disa nga politikat dhe vendimet e tyre. Më specifikisht, cili është roli i shtetit në kontekstin post-socialist? Çfarë shkallë e suportit shtetëror për OSHC (organizatat e shoqërisë civile) që konsiderohet e nevojshme dhe legjitime, ka prirjen për t'u përcaktuar në mënyrë kulturore për shembull, pritjet e ShBA kanë tendencë për të qenë të ndryshme për këtë gjë përkundrejt demokracive perëndimore.

Thelbi i rolit të shoqërisë civile në hetimin publik dhe qeverisjen e mirë të sektorit të sigurisë është ekzistenca e shtypit që është i pacensuruar dhe i pakufizuar në aftësinë e tij për të monitoruar performancën dhe për të publikuar abuzimet e pushtetit. Një shtyp i lirë ndihmon për të kompensuar kur strukturat e tjera të mbikëqyrjes dështojnë ose kundërshtojnë për të adresuar abuzimet, dhe mund të ndihmojë për të drejtuar vëmendjen e publikut drejt këtyre abuzimeve duke ushtruar presion mbi qeverinë dhe politikanët.

Literatura e reformave në sektorin e sigurisë tregon se shoqëria civile kontribuon në qeverisjen e mirë të çështjeve të sigurisë dhe të mbrojtjes, kryesisht nëpërmjet funksionit të mbikëqyrjes së organizatave përfaqësuese, grupeve të interesit dhe OJQ-ve.

Përfshirja e shoqërisë civile gjykohet se kontribuon për një politikëbërje dhe zbatim të saj me efektive dhe të drejtë duke i siguruar politikëbërësit me një informacion të gjerë, perspektiva dhe alternativa. Inputi i shoqërisë civile konsiderohet si kryesor për procesin e demokratizimit të sektorit të sigurisë, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit e ekspertizës civile të pavarur që qeveria, parlamenti media dhe aktorë të tjerë mund të thërrasin, për t'iu siguruar atyre perspektiva të pavarura, analiza dhe këshilla për politikat dhe çështjet e sigurisë. Perspektivat alternative vlerësohen si një matës i interesave burokratike që mund të ndalojnë reformat ose ngjyrimet e analizës dhe rekomandimet politike të bëra nga anëtarët e institucioneve të sigurisë ose atyre që janë të lidhur me ta.

Shoqëria Civile në Shtetet Post-Komuniste

Në Evropën Qendrore dhe Lindore post-komuniste, ideja e shoqërisë civile është zhvilluar si një mjet për të përqendruar vëmendjen në sistemin represiv të shtetit socialist. Ndërsa represioni totalitar u zvogëluar në erën post-staliniste dhe u zëvendësua nga forma më pak të përhapura të kontrollit dhe penetrimit shtetëror të staveve të mëvonshme të shtetit socialist, u hap një hapësirë për disidentë në disa shoqëri të EQL. Shoqëria civile ishte një element kyç në politikën e anti-politikave. Megjithatë, me shuarjen e Traktatit të Varshavës, me zëvendësimin e regjimeve komuniste përgjatë rajonit, dhe me shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik, roli dhe kuptimi i shoqërisë civile në EQL ndryshoi dhe humbi ndjeshëm influencën në debatin publik. Megjithatë besohet gjerësisht se ajo ka ngelur vitale për konsolidimin e suksesshëm të demokracisë. Edhe pesëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të regjimeve socialiste, shoqëria civile nëpër Evropën Qendrore dhe Lindore pranohet të ketë qenë e dobët, e karakterizuar nga nivele shumë të ulëta të anëtarësisë qytetare dhe pjesëmarrjes në grupet dhe shoqëritë vullnetare në krahasim me nivelet në demokracitë e maturuara dhe vendet post-autoritare. Pavarësisht diferencimit që ndodhi shpejt midis vendeve post-komuniste në lidhje me performancën dhe strukturat politike dhe ekonomike dhe marrëdhëniet me shtetet e tjera, këto vende posedonin ngjashmëri të habitshme në lidhje me shoqëritë civile të tyre. Niveli i lartë i mosbesimit qytetar mbi organizatat vullnetare besohet se rrjedh nga një histori e përbashkët e pjesëmarrjes së detyruar në organizatat e epokës komuniste, rrjetet e vazhdueshme private ndërmjet shokëve të ngushtë dhe familjes dhe zhgënjimet në lidhje me kushtet ekonomike dhe politike në shtetet post-komuniste. Këto faktorë ndihmojnë për të shpjeguar shkallën e ulët të pjesëmarrjes qytetare në sferën publike përgjatë EQL post-komuniste. 1 Është e rëndësishme të theksojmë se dobësia e shoqërisë civile në EQL sugjeron se ekzistojnë tipa të ndryshëm të marrëdhëniet midis qytetarëve dhe shtetit.

Roli i vogël që shoqëria civile ka luajtur në fusha të veçanta të çështjeve të mbrojtjes dhe të sigurisë në disa rajone

shpjegohet pjesërisht nga mungesa e dukshme e anëtarëve të shoqërisë civile me interes të mjaftueshëm ose ekspertizë në çështjet e sigurisë. Në vende të ndryshme post-komuniste, për shembull, zhveshja 1 Marc Morjé Howard, Dobësia e Shoqërisë Civile në Evropën Post-Komuniste (Cambridge: Cambridge University Press, 2003) e aparatit të sigurisë së shtetit socialist, ose krijimit të tij në shtetet e reja sovraane, ishte një prioritet menjëherë pas tranzicionit dhe vendosjes së regjimeve të reja demokratike. Por kishte një interes shumë të vogël në përballjen afatgjatë me reformat policore ose të shërbimeve informative dhe veç kësaj një mospëlqim në përballjen me çështjet e sigurisë së brendshme.

Nga ana kontribuese, përfshirja e shoqërisë civile u minimizua nga një preokupim fillestar me strukturat legale dhe reformat institucionale dhe kontakti dhe asistenca e drejtpërdrejtë polici-polici, ushtarak-ushtarak. Kjo prirje vazhdon gjerësisht sot nëpërmjet programeve të asistencës ushtarake, vendosja reciproke e ekspertëve institucionalë, dhe programeve të binjakëzimit. Me përgjithësisht, sektori i sigurisë tradicionalisht është dominuar nga ekzekutivi dhe karakterizuar nga një nivel i nevojshëm i sekretit. Kjo nuk ka qenë tradicionalisht shumë e lejuar as nga anëtarët e tjerë të sektorit politik. Mbikëqyrja parlamentare e agjencive informative, për shembull, është një zhvillim relativisht i vonshëm në demokracitë perëndimore dhe është akoma larg të qenit e përshtatshme në shumë vende. Ideja për një përfshirje më të gjerë në monitorimin dhe institutet e kontrollit të sigurisë, dhe inputi i gjerë publik në politikën e sigurisë po pranohet shumë ngadalë, por prapë po përballet me shumë pengesa. Kjo shtrihet në rolin e medias, veçanërisht në frenat formale dhe informale të lirisë së shprehjes së medias për të raportuar për çështjet e sigurisë dhe korrupsionit brenda sektorit të sigurisë, ç'ka mbetet e vështirë në shumë shtete.

Përmbledhje e Librit

Seksioni i parë i librit ekzaminon dimensionet e ndryshme konceptuale të marrëdhënieve të shoqërisë civile me sektorin e sigurisë. Johanna Mendelson Forman ekzaminon qasjet

kontribuese, veçanërisht transferimin nga marrëdhëniet tradicionale civile-ushtarake drejt reformave në sektorin e sigurisë si dhe ndërlikimet në lidhje me suportin dhe përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile. Ajo shënon se transferimi drejt RSS në shtetet në zhvillim shpesh kërkon një forcim të kapaciteteve të shtetit që të realizohen njëkohësisht me demokratizimin. Duhet të ketë gjithashtu një zgjerim të preokupimit me elitat politike dhe të sigurisë përtej marrëdhënieve tradicionale civilo-ushtarake dhe t'i kushtohet një vëmendje më e madhe qytetarëve. Në mënyrë të ngjashme, qasjet duhet të lëvizin përtej ringritjes institucionale dhe të kërkojnë të ndryshojnë sjellje dhe të krijojnë një kulturë demokratike në të cilën nevojat e sigurisë të qytetarëve mesatarë, duke përfshirë grupet e marginalizuara, të marrin një rëndësi dhe influencë të madhe.

Kontribuesit duhet të përmirësojnë metodat e tyre, duke shmangur një qasje të vetme, dhe t'i përshtatin më mirë programet e tyre me kontekstin specifik. Ata gjithashtu kanë tentuar të trajtojnë shoqërinë civile si një mjet sesa si një qëllim, dhe kanë krijuar një grup elite të drejtuesve të shoqërisë civile për të përparuar axhendat e tyre, duke kontribuar në tendencat sipërmarrëse midis këtyre elitave të shoqërisë civile dhe një shkëputje midis organizatave të shoqërisë civile dhe zgjedhësve të tyre lokalë në emër të të cilëve ata flasin.

Ian Leigh fokusohet në marrëdhënien midis shoqërisë civile dhe ligjit në një shtet demokratik. Ai gjurmon interpretimet e ndryshme të mbivendosura të shoqërisë civile, nga mishërimi i mosbesimit të shtetit dhe sjellja si kundërpeshë e tij drejt sjelljes si një institucion ndërmjetësues midis qytetarëve dhe shtetit dhe madje themelimit të partnerëve potencialë për shtetin në shpërndarjen e shërbimeve publike të caktuara. Shoqëria civile mundëson përfshirjen e gjerë të njerëzve, veçanërisht të shtresave të marginalizuara, në politikat demokratike nëpërmjet proceseve konsultative.

Nëpërmjet ekspertizës së saj të pavarur dhe kapacitetit të saj për të monitoruar performancën e aktorëve të shtetit, shoqëria civile mund të luajë një rol të rëndësishëm në procesin politik.

Duhet të ekzistojnë parakushte kushtetuese dhe ligjore nëse është duke u shfaqur një shoqëri civile dinamike, duke përfshirë mbrojtjen e lirisë së grupimit dhe lirinë e shprehjes. Më përgjithësisht, shteti demokratik duhet të ushtrojë vetëkontroll në lejimin e formimit të grupeve të pavarura dhe autonome, në mbrojtjen e të drejtave të tyre për të shprehur opinionet e tyre, duke përfshirë protestat kundër politikës së qeverisë. Leigh në këtë mënyrë nënvizon se një shoqëri civile e fuqishme që luan një rol në qeverisjen e mirë është e varur në shumë mënyra të rëndësishme nga shteti i cili lehtëson kapacitetet e saj për të luajtur atë rol.

Nicole Ball tregon lidhjen e qartë midis varfërisë dhe mungesës së sigurisë, dhe kështu pra për nevojën për institute efektive dhe llogaridhënese të sigurisë në mënyrë që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik politik dhe social. Profesionalizimi i forcave të sigurisë dhe bërja e tyre subjekte të mbikëqyrjes është i lidhur brendësisht me demokratizimin, veçanërisht me vendosjen e kontrollit dhe balancimit, duke përfshirë faktorë ligjorë, institucionalë, proceduralë dhe shoqërorë. Ball thekson se shoqëria civile dhe vendosja e normave mund të funksionojë në nivele të ndryshme – lokale, kombëtare, rajonale, dhe ndërkombëtare dhe që ky multiplicitet duhet inkorporuar në qasjet kontribuese për të mbështetur qeverisjen në sektorin e sigurisë. Për më tepër, ka diferenca të rëndësishme midis rajoneve në zhvillim, lidhur me rolin që aktorët e shoqërisë civile po luajnë në RSS, duke konsideruar pjesëmarrjen me aktive të saj të parë në Afrikë. Kështu që mund të themi, se ka disa pengesa të përbashkëta që pengojnë përfshirjen e shoqërisë civile në RSS, duke përfshirë mungesën e ekspertizës, dështimin në përdorimin e ekspertizës në fushat që lidhen me pasigurinë, dyshimin reciprok të aktorëve të shoqërisë civile me aktorët qeveritarë të sigurisë, dhe prioritetin kontribues të ndërtimit eficient të shërbimeve të sigurisë, pa i kushtuar vëmendje mbikëqyrjes demokratike dhe llogaridhënies së tyre.

Dusan Reljic ekzaminon rolin e medias në hetimin e qeverisë dhe veçanërisht të sektorit të sigurisë. Analiza e tij paralajmëron për shumë pengesa që minojnë dhe bllokajnë

këtë rol sot. Ai shënon se hapësira deri në të cilën gazetarët mund të luajnë këtë rol është e limituar nga 'lufta mbi terrorizmin', dhe kufizimet ndaj aksesit në informacion, lirinë e shprehjes dhe të drejtat e tjera të njeriut që janë parashtruar nga qeveritë e demokracive mature si p. sh. në shtetet në tranzicion. Në mjedisin aktual, marrëdhëniet qeveri-media janë nën tension dhe media në vende të ndryshme është duke u angazhuar drejt auto-censurës dhe duke pezulluar ekzaminimin kritik të politikave qeveritare. Për më tepër, përqendrimi i zotërimit të medias në shtetet perëndimore ka pasur një impakt negativ në kualitetin e gazetarisë. Reljic më tej zhvlerëson perceptimin publik për aftësinë e medias për të siguruar llogaridhënien e qeverisë dhe të sektorit të sigurisë sepse siç thotë ai, se gazetaria investigative është një përjashtim dhe jo një rregull në këtë industri. Së fundi, shteti vendos parametrat për llogaridhënie dhe transparencë, dhe është në dorë të qeverisë dhe autoriteteve shtetërore për të vendosur sesa do ta lejojnë median të luajë një rol në qeverisjen e mirë të sektorit të sigurisë.

Biljana Vankovska paraqet pikëpamjet e njoftuara të 'marrësve' mbi aktivitetet promovuese të demokracisë perëndimore në Ballkan. Shumë probleme kanë dalë gjatë ngutjes perëndimore për të ndërhyrë dhe për të lehtësuar demokratizimin: Aktorët perëndimorë nuk e kanë orkestruar qasjen e tyre, ata kanë dërguar shpesh personel me mision të cilët janë të painformuar rreth rrethanave dhe historisë lokale ose dështojnë të pranojnë ose të përdorin dijeninë lokale ose ekspertët, ofrojnë qasje të thjeshta dhe principe bazike, ndërkohë që ekziston shumë konkurrencë midis donatorëve dhe përfituesve. Shoqëria civile në shtetet në tranzicion shpesh tregon një numër të lartë zhgënjyes të shoqërive zyrtarisht të regjistruara, kur në fakt shumica e qytetarëve nuk beson në bashkimin me ndonjë organizatë. Megjithëse Vankovska përmend politizimin e shoqërisë civile në vendet post-komuniste në Ballkan, ndërsa disa liderë të shoqërisë civile lëvizin në sferat e larta politike ose shtetërore administrative, shumë OJQ lokale janë shpesh jo më shumë se shfaqje vetjake me shumë pak influencë reale politike dhe sociale. Aktorët

shtetërorë tentojnë të mos përfshijnë aktorët lokalë të shoqërisë civile në sferën e sigurisë, megjithëse me shpresën për të fituar një imazh të mirë ndërkombëtar dhe anëtarësim në NATO/EU, i vijnë rrotull OJQ-ve ndërkombëtare. Aktorët perëndimorë kanë tentuar të mos njohin pushtetin që ato mund të shfaqin në ndërtimin e suportit për bashkëpunimin shtetëror me OJQ-të lokale. Ata kanë tentuar njëkohësisht të injorojnë ‘anën e errët’ të shoqërisë civile në shtetet në tranzicion - ie. Ato elemente si bandat kriminale dhe grupet paraushtarake që mund të mbajnë lidhje të ngushta me strukturat e shtetit. Për më tepër, ata kanë tentuar të mos njohin që RSS dhe promovimi i demokracisë mund të jetë një përpjekje e rrezikshme për partnerët e tyre lokalë.

Duke u kthyer në kapitujt e vendit, shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore ekzaminohen bashkërisht së pari, studimet e çështjeve të veçanta të përfshirjes së shoqërisë civile në çështjet e sigurisë në Estoni, Hungari, Poloni, Sllovaki dhe Ukrainë. Grupi i dytë i vendeve të ekzaminuara është marrë nga Evropa Juglindore, domethënë Bullgaria, Ballkani me një fokus mbi Maqedoninë, Rumaninë, Serbinë dhe Slloveninë. Ka një fokus mbi median në këtë grup shtetesh. Autorët e studimit estonian i referohen përgjithësisht shoqërisë civile si dhe kushteve shumë të dobëta të saj në vend, si dhe i referohen asaj më specifiku edhe si një element i kontrollit dhe i mbikëqyrjes demokratike të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes. Me gjithë shtimin e shpejtë të OJQ-ve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, e reflektuar kjo në numra zyrtarë të lartë, këto organizata ekzistojnë më së shumti në letra. Për më tepër, mbrojtja dhe politikëbërja e jashtme mbetet një rezervë e elitave politike dhe administrative, një tendencë që u përforcua nga mungesa e debatit politik mbi mbrojtjen dhe politikën e jashtme gjatë 1990, përderisa ekzistonte një konsensus shoqërisht i gjerë mbi prioritetet për të arritur anëtarësimin në BE dhe NATO, duke shmangur nevojën për përkrahje nga OJQ-të në këtë fushë. Lëvizje nga poshtë ekzistojnë shumë pak në këtë sferë.

Ato institute të kërkimit dhe politikës që ekzistojnë në Estoni në çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë tentojnë të jenë

OJQ 'kuadro' ose elita, ose pro grupeve BE/NATO, dhe janë pjesërisht të financuara nga shteti dhe pjesërisht nga donatorët e jashtëm. Si të tilla, ato tentojnë të pranojnë zgjedhjet politike të qeverisë sesa t'i asistojnë ata në mënyrë kritike. Aktorët qeveritarë akoma nuk po konsultojnë ose angazhohen me OSHQ estoniane, të fokusuar në mbrojtje dhe siguri, megjithëse sipërfaqja e vogël e vendit nënkupton që shumë individë që shkruajnë ose punojnë në fushën e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes e njohin njëri-tjetrin. Ndërsa është relativisht e lehtë për institutet kërkimore dhe think tank-et për të publikuar komentaret në median lokale, vëmendja në ulje që u kushtohet çështjeve të jashtme dhe ndërkombëtare ka çuar që të paktën një OSHQ të fillojë publikimin e buletinit të tij informativ.

Ferenc Molnar ekzaminon rolin që shoqëria civile ka luajtur në transformimin e marrëdhënieve civilo-ushtarake në Hungari. Molnar tregon se shoqëria civile ishte burimi i parë i kundërshtimit të regjimit komunist, dhe në mënyrë të ngjashme shërbeu si burimi primar i anëtarëve të qeverisë së re demokratike. Sapo u miratua faza e parë e reformave institucionale, u duk qartë se aspekti horizontal i marrëdhënieve civilo-ushtarake duhet të adresohet, duke përfshirë ndërtimin e ekspertizës civile në mbrojtje brenda dhe jashtë qeverisë. Çështja e anëtarësisë në NATO ka pasur një impakt të rëndësishëm në aktivitetin e shoqërisë civile në sferën e mbrojtjes dhe sigurisë në Hungarinë post-komuniste, duke i dhënë ngritje iniciativave të OJQ-ve dhe lëvizjeve protestuese, si dhe përpjekjeve nga shteti për të arritur më shumë kontroll mbi organizatat e shoqërisë civile në sferën e mbrojtjes. Ndërsa bashkëpunimi i ministrisë së mbrojtjes me organizatat e shoqërisë civile është rritur, kryesisht kanë përfituar nga ky zhvillim vetëm ato organizata që kanë mbështetur politikën shtetërore, duke i dhënë rritje një lloj klientelizmi që nuk e ka lehtësuar transparencën ose llogaridhënien në sektorin e mbrojtjes. Grupet që ishin shprehimisht kundër politikës qeveritare, si në rastin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak u përjashtuan nga forumet ku u debatuan çështje të tilla. Megjithatë çështja hungareze

demonstron se grupet protestuese dhe OJQ-të me raste kanë mundur të detyrojnë qeverinë dhe partitë politike të identifikojnë dhe qartësojnë publikisht pozicionet e tyre për çështje kryesore.

Agnieszka Gogolewska shkon përtej sipërfaqes, të ndryshme në dukje të organizatave të shoqërisë civile që janë të angazhuara me sferën e sigurisë dhe i vlerëson ato si fragmentare shpesh të lidhura me interesa speciale dhe elitare, dhe ndonjëherë të angazhuara në aktivitete të korruptuara ose dyshuese, dhe që kanë efektivitet të limituar në lehtësimin e hetimit publik. Ndërkohë çështjet e sigurisë patën një vëmendje publike gjatë bashkimit të Polonisë në NATO dhe rriten shpresat që shoqëria civile do të bëhej më e angazhuar në sektorin e sigurisë, gjë e cila u shua, ndërsa anëtarësimi në NATO u arrit dhe publiku tani shfaq një interes të vogël në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare. Mungesa e interesit publik është një pjesë e pasqyimit të nivelit të ulët të angazhimit publik në organizatat vullnetare, dhe gjithashtu një ndjenjë e ulët e efikasitetit në influencimin e çështjeve publike, si dhe një nivel i ulët i besimit publik në profesionet e lidhura me sigurinë si ushtria dhe policia. Mungesa e financimit të qëndrueshëm dhe mungesa e partneriteteve funksionuese me agjencitë qeveritare e kufizon më tepër potencialin e grupeve të vërteta të shoqërisë civile për të influencuar politikën. Duke marrë parasysh natyrën shumë të centralizuar të administratës, natyra sekrete e shërbimeve të sigurisë, dhe natyra dyfunktionale e organizatave të shoqërisë civile në sektorin e sigurisë, Gogolewska mban qëndrimin se sektori polak i sigurisë do të mbetet nën kontrollin civil të limituar, do të ketë mungesë transparence dhe do të jetë i prirur ndaj korrupsionit. Organizatat e shoqërisë civile sllovaqe janë vlerësuar nga Vladimir Tarasovic, Elemir Necej dhe Matus Korba dhe konsideruar: të jenë të pakta në numër, dhe ashtu si çështja polake, jo në nivelet e homologëve perëndimorë, të kenë mungesë kontakti pune me agjencitë qeveritare, dhe rrjedhimisht të mos luajnë ndonjë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen publike të institucioneve të sigurisë ose në krijimin e ideve të reja politike. E rëndësishme në çështjen

sllloake ishte roli i administratës në shtetin e ri të pavarur, veçanërisht ministritë e jashtme dhe të mbrojtjes, me fillimin e vendosjes së instituteve politike dhe kërkimore, dhe pastaj me ndërmarrjen e zhvillimit të tyre, duke interferuar në strukturat e tyre dhe personelin. Sekretet tradicional që karakterizonte çështjet e sigurisë ishte një faktor tjetër kufizues dhe aktorët politikë ishin të ngadalshëm të përqafonin një stil politikë-bërje më të hapur. Një tjetër kufizim në zhvillimin e shoqërisë civile ishte qeveria 1994-1998 e Vladimir Meciar, e cila nuk kishte asnjë interes në bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile në këtë sferë dhe kishte përgjithësisht marrëdhënie antagonistike me OSHQ. Ndërsa antagonizmi u zhduk me ardhjen e qeverisë së re në 1998, ngelën pak rrugë për zhvillimin dhe edukimin e ekspertizës në çështjet e sigurisë në shoqëritë civile. OSHC kanë mungesë të financimit të brendshëm dhe bashkëpunimit institucional me agjencitë qeveritare që do t'i mundësonin ato të ndërmerrnin studime të pavarura dhe kështu të shërbenin si burim i shqyrtimit të pavarur publik të çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes.

Sipas Leonid Polyakov, një sërë organizatash të shoqërisë civile të lidhura me mbrojtjen dhe veçanërisht think tank-et politike, që janë shfaqur në Ukrainë, kanë siguruar gradualisht më shumë ekspertizë në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes si dhe më shumë personel me eksperiencë të drejtpërdrejtë në këto fusha dhe produktet e tyre po fitojnë një vëmendje në rritje nga qeveria, forcat e armatosura media dhe publiku. Duke mos përfituar mbështetje shtetërore substanciale për projekte, suksesi i tyre i befasishtëm ka ardhur pjesërisht nga grantet e organizatave donatore perëndimore, dhe pjesërisht nga çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë që nuk janë çështje politikisht dhe ekonomikisht të ndjeshme, si rrjedhim duke i lejuar think tank-et t'i shpëtojnë vëmendjes së zbatimit të politizuar të ligjit dhe autoriteteve të taksave. Think tank-et ukrainase kanë pasur një impakt të dallueshëm, për shembull, duke e drejtuar në mënyrë të suksesshme vëmendjen publike në boshllëkun midis planeve ambicioze për reforma në mbrojtje të qeverisë dhe burimeve ekonomike joadekuate të shënuara për atë reformë. Ndërsa të pavarur politikisht, ekspertët dhe gazetarët në sferën

e sigurisë dhe të mbrojtjes gjithsesi vazhdojnë të praktikojnë auto-censurën, veçanërisht për sa i përket niveleve të larta të korrupsionit dhe aktiviteteve kriminale të anëtarëve të forcave të sigurisë. Ai mbaron me një shenjë optimizmi që për sa kohë shteti ukrainas ndoshta duke kërkuar më shumë bashkëpunim në të ardhmen me OJQ-të dhe duke mbështetur punën e tyre nëpërmjet kontratave dhe kërkesave për studime, ky aspekt i shoqërisë civile ukrainase do të maturohet akoma më shumë.

Grupi i dytë i shteteve i intereson shoqërisë civile dhe sektorit e sigurisë në Evropën Juglindore. Emil Tsenkov fillon duke shfaqur drejtimet kryesore të politikës së mbrojtjes dhe reformat e brendshme të sigurisë së Bullgarisë, dhe shënon emergjencën e një problemi serioz të krimit të organizuar të lehtësuar nga konfliktet në Ballkanin Perëndimor dhe regjimet embargo. Ndërkohë që shoqëria civile ishte një koncept i ri për Bullgarinë post-komuniste, sektori u zhvillua shpejt pas ndryshimit të regjimit. Megjithatë, shumë OJQ janë joaktive ose nuk punësojnë staf në mënyrë të rregullt. Tsenkov identifikon tre tipa të organizatave joqeveritare të lidhura me reformat e sektorit të sigurisë së Bullgarisë: shoqëritë profesionale, organizatat ruajtëse të të drejtave të njeriut, dhe think tank-et/institutet politike. Këto të fundit kanë provuar të jenë veçanërisht influencuese në ndryshimin e qëndrimeve publike drejt anëtarësimit në NATO, dhe duke bashkëpunuar me ministrinë e mbrojtjes në influencimin dhe shndërrimin e reformave ushtarake dhe të mbrojtjes. Në krahasim, bashkëpunimi i ministrisë së brendshme dhe hapja ndaj shoqërisë civile donte kohë që të zhvillohej, dhe u arrit të vendosej me bashkimin e përpjekjeve të antikorrupsionit dhe antikrimit të organizuar që daton fundin e 1990. Asistenca e huaj drejt organizatave të shoqërisë civile bullgare derivon nga një sërë burimesh dhe ka krijuar një “trekëndësh bashkëpunues” midis donatorëve të huaj, OJQ-ve lokale dhe autoriteteve shtetërore bullgare. Këtë ai e konsideron një zhvillim politik sepse lehtëson bashkëpunimin si brenda vendit ashtu dhe me aktorët ndërkombëtarë, ndërkohë që ndërtohen kapacitete dhe mbështetje për një hapje dhe transparencë më të madhe. Megjithatë mund të dalin probleme nga

mosmarrëveshjet ndërmjet partnerëve në lidhje me prioritetet, eksperiencën jo të përshtatshme të shoqërisë civile në çështjet e sigurisë, problemet me integrimin e ushtrisë së mëparshme dhe personelin e sigurisë në strukturat e OJQ për arsye të vlerave dhe qëndrimeve të ndryshme dhe mungesës së koordinimit të donatorëve.

Marian Chiriac studion rolin e medias rumune në raportimin e çështjeve të sektorit të sigurisë, duke u fokusuar veçanërisht në çështjen e bashkimit të Rumanisë me NATO-n. Me rënien e dhunshme të regjimit të Çausheskut, u shfaq një mjedis i ri për median që ishte shumë dinamik, megjithëse u desh kohë që lajmet objektivisht të raportuara dhe me neutrale të arrinin standardet. Gjatë viteve të para, media në praktikë zëvendësonte me raste opozitën politike ose gjyqësorin, për institucionet e dobëta. Ajo filloi t'i adresojë seriozisht çështjeve të mbrojtjes me anëtarësimin e Rumanisë në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP) vetëm në 1994, veçanërisht në pikëpamjen e theksuar nga programi për transparencën dhe kontrollin demokratik, dhe me emergjencën e anëtarësimit të Rumanisë në NATO si një prioritet kyç i politikës së jashtme që prej 1995. Një fushatë e madhe publicitare e organizuar nga qeveria gjatë valës së parë të zgjerimit të NATO-s në 1997 dhe kjo zuri një vend të madh në media, edhe pse Rumania nuk mori ftesën e shumëpritur prej saj për t'u bashkuar me NATO-n. Pas 1997 prirjet publike pro-NATO mbeten, por u frenuan nga mungesa e popullaritetit të pozicionit të NATO-s gjatë krizës në Kosovë dhe nga simpatia për aleaten tradicionale të Rumanisë, Serbinë. Fushata për zgjerimin e NATO-s në 2004 u përcoll në mënyrë më të qetë dhe të përmbajtur. Gjithsesi, gazetaria e informuar dhe kritike e sigurisë përgjithësisht ka munguar, ç'ka nuk është befasuese, bazuar në kufizimet mbi lirinë e shprehjes siç është ndalimi i shpifjes kundër vendit ose kombit e sanksionuar në Kodin Penal rumun. Gazetarët rumun raportojnë vetëm formulimet e qeverisë dhe politikën pa u bërë më të edukuar për këto çështje, ose pa i marrë në pyetje ato formulime ose supozimet mbi të cilat ato bazohen. Për më tepër, Chiriac përmend se raportimi i sigurisë është i rrethuar nga përpjekje

të vazhdueshme të qeverisë për të kontrolluar, centralizuar dhe manipuluar mbulimin nga ana e medias të çështjeve të politikës së sigurisë, duke e parë median si një lloj makinerie të marrëdhënieve publike të zgjeruara. Duke marrë parasysh burimet komerciale dhe profesionale të kufizuara, përqendrimi i pronësisë së medias që shërben për të homogjenizur mbulimin e lajmeve dhe shmangur kundërshtimet dhe mjedisin e punës gjithmonë e më shumë të korrumpuar të punëtorëve të medias shumë pak të paguar, nuk është surprizuese kur Chiriac pohon se masmedia ka bërë vetëm një impakt minimal mbi llogaridhënien e sektorit rumun të sigurisë.

Roli i medias serbe konsiderohet më pas nga Vlada Milic.

Duke rishqyrtuar natyrën e medias jugosllave nën komunizëm, ai nënvizon funksionin e tyre si një altoparlant i nënshtruar i partisë në fuqi.

Me reformat e decentralizuara, u hap më shumë hapësirë për një trajtim më të madh kritik, sidoqoftë nisur nga kushtet e shkuara, media e përdorte atë hapësirë për të sulmuar etnitetet e tjera dhe rivalët politikë të zotëve të tyre klientelistë. Në transmetimin e pakritikueshëm të informacionit nxitës që u sigurua nga shërbimet e sigurisë të kudogjendura, media ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë rënies së spirales së luftës. Si gjatë komunizmit ashtu edhe gjatë regjimit të Milosheviqit, media serbe ishte e kontrolluar dhe infiltruar nga anëtarë të Shërbimit të Sigurisë së Shtetit. Media e pavarur ishte veçanërisht subjekt i presioneve të shumta pa mundësi 'për t'jua mbledhur atyre'. Milic pasqyron një lidhje të qartë midis atyre fushave ku media e pavarur luftonte për të operuar dhe emergjencës së kundërshtimit qytetar të regjimit. Në Serbinë post-Miloseviq, Shërbimi i Sigurisë së Shtetit, krimi i organizuar dhe grupet paraushtarake vazhduan të influenconin qeverinë dhe shoqërinë, gjë e cila u demonstrua në vrasjen e kryeministrit Zoran Djindjic në 2003. Nën kushte të tilla, gazetarët janë subjekt i kërcënimeve dhe dyshimeve kur raportojnë për çështjet që lidhen me sigurinë. Milic mbështet mendimin se derisa shteti të copëtojë me sukses lidhjen midis strukturave ushtarake, informative dhe policore nga njëra anë

dhe grupeve të krimit të organizuar nga ana tjetër, media nuk mund ta përmbushi funksionin e saj mbikëqyrës.

Ljubica Jelusic hedh një vështrim prapa te zhvillimet nën shtetin socialist, të cilat influencuan fuqishëm karakterin e shoqërisë civile në Slloveni, që do të thotë krijimin e një sistemi të decentralizuar që passjell një autonomi më të madhe të individëve dhe përforcohet nëpërmjet idesë së vetëmenaxhimit. E frikësuar se mos humbasë pozicionin e saj të privilegjuar, ushtria jugosllave iu kundërvu shoqërisë civile veçanërisht në rajonet jo-serbe, duke përfshirë Slloveninë dhe shkaktoi shumë lëvizje paqësore, përkrahëse dhe protestuese që kritikonin praktikat ushtarake diskriminuese dhe ndërhyrjen e tyre në çështjet civile si dhe gjithashtu prezencën ushtarake në Slloveni. Me shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e forcave të reja të armatosura sllovake, shoqëria civile veprroi si një inovatore idesh dhe qasjesh progresive për forcat e armatosura, duke përfshirë dhe paraqitjen e kundërshtimeve të ndërgjegjshme dhe hyrjen e femrave.

Megjithatë, menjëherë pas vendosjes së shtetit të pavarur, Jelusic thekson se shoqëria civile sllovake faktikisht po dobësohej ndërsa shumë figura drejtuese po bëheshin aktorë politikë në qeverinë e parë të desidentëve të mëparshëm, ose po futeshin në administratën shtetërore. Ndërkohë që shumë grupe të shoqërisë civile, të cilat merren me çështjet e sektorit të sigurisë ekzistojnë tani në Slloveni, shumë prej tyre shqetësojnë politikën e mbrojtjes dhe të sigurisë, ndërkohë që ka shumë pak aktorë në shoqërinë civile që hetojnë policinë, shërbimet informative ose ministrinë e brendshme. Ato janë aktive në fushata para elektorale si kritikuese të platformës ose politikës, organizojnë evente për të paraqitur përfundime dhe debate dhe angazhohen në aktivitete të gjera edukative që përfshijnë publikun dhe anëtarë të forcave të sigurisë. Media në Slloveni është e hapur në paraqitjen e perspektivave kritike të politikës së qeverisë. Ndërkohë që aktivitetet e shoqërisë civile janë përgjithësisht të financuara nga vendi dhe nuk kanë pse të varen nga financimi i jashtëm, shfaqen disa kufizime kur pranohen këshillimet e qeverisë, si p. sh. perceptimet publike se këto lloj organizatash funksionojnë si një zë për

qeverinë, ose imponimi i kufizimeve për publikimin e të dhënave ose edhe sistemimi i një studimi kur përfundimet e tij minojnë pozitën e qeverisë.

Referencat

- FONDACIONI ASIA. 2001. *Raport mbi perceptimin qytetar për sektorin indonezian të drejtësisë: zbulime paraprake dhe rekomandime*. Jakarta: Fondacioni Asia. <http://www.asiafoundation.org/pdf/IndoLaw.pdf>
- BALL, NICOLE. 1998. *Shpërndarje e Praktikave të Mira në Reformat e Sektorit të Sigurisë: Opsione Politike për Qeverinë*. London: Saferworld.
- BAYLEY, DAVID H. 1975. 'Policia dhe Zhvillimi politik në Europë'. In Tilly, Charles (ed). *Formimi i Shteteve Kombëtare në Evropën Perëndimore*. Studime në Zhvillimet Politike 8. Princeton, NJ: Princeton University Press.
- BURNELL, PETER, DHE PETER CALVERT. 2004. *Shoqëria Civile në Demokratizim*. London: Portland, OR, 2004.
- BURNELL, PETER, DHE PETER CALVERT, (Eds.) 'Promovimi i Demokracisë Jashtë'. 2005. Çështje Speciale. *Demokratizimi* 12, 4 (gusht)
- CARDOSO, FERNANDO HENRIQUE. 2003. 'Shoqëria Civile dhe Qeverisja Globale'. Leter Backgroundi i prezantuar për mbledhjen e parë **of the Secretary-General's High-Level Panel on Civil Society**. <http://www.un.org/reform/pdfs/cardosopaper13june.htm>
- CAROTHERS, THOMAS, DHE OTTAWA, MARINA S. 2000. *Funding Virtue: Ndihma e Shoqërisë Civile dhe Promovimi i Demokracisë*. Washington, DC: Ndihma Carnegie për Paqe Ndërkombëtare.
- DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (DFID). 2002. *Mirëkuptimi dhe Mbështetja e Reformave në Sektorin e Sigurisë*. London: DFID.
- DIAMOND, LARRY. 1994. 'Rimendimi i Shoqërisë Civile: Drejt Konsolidimit Demokratik'. *Gazeta e Demokracisë* 5, 3 (korrik).
- EHRENBERG, JOHN. 1999. *Shoqëria Civile: Historia Kritike e një Ideje*. New York dhe London: New York University Press.

- RRJETI LEHTËSUES GLOBAL PËR REFORMAT E SEKTORIT TË SIGURISË (GFN-SSR). 2004a. *Mbledhja për Zgjedhjen e një Komiteti për Drejtim të Përkohshëm për Rrjetin e Rrjeteve të Afrikës në Çështjet e Sigurisë*. GFN Letra No. 35 (16 janar 2004). Anicia Lala dhe Chris Ferguson.
- RRJETI LEHTËSUES GLOBAL PËR REFORMAT E SEKTORIT TË SIGURISË (GFN-SSR). 2004b. *Simpoziumi i rrjetit të Sigurisë në Amerikën Latine dhe në Karaibe*. GFN Letra No. 66 (10 maj 2004).
- HOWARD, MARC MORJÉ. 2003. *Dobësia e Shoqërisë Civile në Europen Post-Komuniste*. Cambridge: Cambridge University Press.
- KOPECKY, PETR, DHE MUDDE, CAS. 2003. 'Rimendimi i Shoqërisë Civile', *Demokratizimi* 10, 3 (vjeshtë).
- LUCKHAM, ROBIN, GOETZ, ANNE MARIE DHE KALDOR, MARY. 2003. 'Institucionet Demokratike dhe Politikat Demokratike'. In BASTIAN, SUNIL DHE LUCKHAM, ROBIN (Eds), *Mund të Dizenjohet Demokracia? Politikat e Zgjedhjes Institucionale në Shoqëritë e Rënuara nga Konflikti*. London & New York: Zed Books, 2003.
- ORGANIZIMI PËR BASHKËPUNIMIN DHE ZHVILLIMIN EKONOMIK (OECD). 2004. 'Reformat e Sistemit të Sigurisë dhe Qeverisja: Politika dhe Praktika e Mirë', *Përmbledhje e Politikës* (maj).
<http://www.oecd.org/dataoecd/20/47/31642508.pdf>
- QUIGLEY, KEVIN. 1997. *Për Hir të Demokracisë: Fondacionet dhe Asistenca Demokratike në Evropën Qendrore*. Baltimore: Johns Hopkins University Press.
- RATYNSKA, ANETA. 2004. 'Pikëpamje mbi pjesëmarrjen e Shoqërisë Civile në Proceset Rajonale dhe Sub-Rajonale: Çështja e Amerikës Latine dhe Karaibeve'. GFN Letra No. 47 (shkurt).
- ROBERTS, ALASDAIR. 2004 'Siguria Kombëtare dhe Qeverisja e Hapur'. *Rishqyrtimi i Politikës publike të Georgetown* 9, 2 (pranverë).
- SCHMITTER, PHILIPPE C. 1997. 'Shoqëria Civile Lindje dhe Perëndim'. In DIAMOND, LARRY, PLATTNER, MARC F., CHU, YUN-HAN, DHE TIEN, HUNG-MAO (eds.). *Konsolidimi i Demokracive të Valës së Tretë. Temat dhe Perspektivat*. Baltimore: The Johns Hopkins University Press.

- SIMONE CHAMBERS DHE JEFFREY KOPSTEIN. 2001. 'Shoqëria Civile e keqe', *Teoria Politike* 29, 6 (dhjetor).
- PROGRAMI I ZHVILLIMIT I KOMBEVE TË BASHKUARA (UNDP). 2003. Raporti i Konferencës mbi 'Koherencë, Bashkëpunim dhe Forcat Krahasuese', Konferencë mbi Drejtësinë dhe Reformat e Sektorit të Sigurisë, 10-11 prill 2003, Oslo, Norvegji.
- WAEVER, OLE. 1998. 'Sigurizimi dhe Pasigurizimi'. In Lipschutz, Ronnie (ed.). Mbi sigurinë. New York: Columbia University Press.
- WILLIAMS, ISHOLA, DHE OCAYA-LAKIDI, DENT. 2004. 'Roli i Shoqërisë Civile në influencimin e Axhendës së Reformave në Sektorin e Sigurisë në Afrikë In. FITZGERALD, ANN M. DHE LALA, ANICIA (eds.). *Lidhja e Network-eve: Mbështetja e Paqes Rajonale dhe Axhendat e Sigurisë në Afrikë* Shrivensham, UK: Rrjeti Lehtësues Global Për Reformat e Sektorit të Sigurisë.
- BANKA BOTËRORE. 2000. *Zëri i të Vërfërve: Nga Shumë Vende*. New York: Oxford University Press për Bankën Botërore.
- WULF, HERBERT. 2005. 'Reformat e sektorit të sigurisë në vendet në zhvillim dhe tranzicion'. Në Manualin e *Berghof për Transformimin e Konfliktit*.
- Seria e Dialogëve në Reformat e Sektorit të Sigurisë. Versioni online i mundur në:
URL: <<http://www.berghof-handbook.net>>

James. V. Arbuckle

NUK ËSHTË PUNË PËR NJË USHTAR?

James V. Arbuckle ekzaminon konfliktin civilo-ushtarak në operacionet humanitare.

Gjatë 50 viteve të fundit ka pasur një dështim të vazhdueshëm të ushtrisë dhe agjencive civile për zhvillimin e marrëdhënieve të besueshme dhe eficiente. Në fakt, operacionet paqeruajtëse nuk kanë ndryshuar shumë që nga fillimi i tyre modern pas Luftës së Dytë Botërore.

Ato nuk ndryshuan as pas të supozuarës rilindje pas Luftës së Ftohtë. Ky problem është veçanërisht i mpreshtë në operacionet humanitare e të paqes, të cilat shpeshherë janë shoqëruar ose paraprirë nga vendosja e prania e ushtrisë.

Një rol i ndryshueshëm për një mjedis të ndryshueshëm

Roli i ushtrisë ka evoluar që nga një mandat relativisht i thjeshtë ushtarak i epokës së paqeruajtjes “klasike” siç parashikohet nga Kapitulli VI i Kartës së Kombeve të Bashkuara. Mandati parashikonte vëzhgimin ose ruajtjen e diçkaje ekzistuese: një kufi armëpushimi, një zone ndarëse, një kufi tërheqjeje, një zone të gjelber, një zone të çmilitarizuar. Misionet kërkonin konsensusin e palëve në konflikt. Përdorimi i forcës ishte i kufizuar vetëm për vetëmbrojtje, një e “drejtë e qenësishme” përmendur në nenin 51 të Kartës.

Ky rol filloi të ndryshojë gjatë krizave të vitit 1974 në Qipro. Deri atëherë, ushtria kishte pasur fushën e paqeruajtjes pothuajse tërësisht të vetën. Që prej vitit 1964, mandati i Forcave të Kombeve të Bashkuara në Qipro (UNFICYP) ka konsistuar në vetëm tre pika: parandalimi i përsëritjeve të luftimeve, ndihma ndaj ligjit dhe rendit si dhe kontributi për kthimin e kushteve normale.

Të gjitha këto ndryshuan pas pushtimit turk në vitin 1972. UNFICYP-ja u mor me personat e shpërngulur brenda vendit, të cilët përbënin një situatë urgjente humanitare. Përgjegjësia për zbutjen e kësaj emergjence iu ngarkua fillimisht UNFICYP-së.

Kjo ishte dhe mbetet ndryshimi i vetëm i mandatit të UNFICYP-së gjatë 40 viteve. Përfundimisht roli drejtues u mor nga UNHCR-ja. Dhe funksioni ushtarak u transformua gradualisht në një funksion më shumë mbështetës sesa udhëheqës.

Meqë operacionet e paqes pas Luftës së Ftohte kishin evoluar, shumë ndërhyrje kanë qenë operacione për vendosjen e paqes, të autorizuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në bazë të kapitullit VI të Kartës. Ky mandat për “paqeruajtje më të gjerë” ndikon në mundësinë e përdorimit të forcës për arritjen e misionit dhe në mundësinë që palët të mos japin miratimin e tyre për misionin dhe për kryerjen e tij.

Kështu në bashkimin e sotëm paradoksal të operacioneve humanitare me ato të vendosjes së paqes, ushtrisë nuk i kërkohet të ruajë një status quo, por ta krijojë një të tillë. Në mënyrë eufemike, kjo përshkruhet shpesh si krijimi i një “mjedisi pozitiv të sigurisë”, i domosdoshëm për agjencitë civile në kryerjen e operacioneve të tyre në mënyrë të sigurt dhe efektive.

Dilema e ushtarit?

Por fjala “forca të armatosura” mund të kuptohet ndryshe nga ushtria, nga qeveritë që kontribuojnë me trupa, nga civilet dhe agjencitë civile dhe nga opinioni publik.

Në një operacion të vendosjes së paqes që ishte në shume mënyra një prolog i operacioneve “moderne”, Forcat e Kombeve të Bashkuara në Kongo në 1960 (ONUC), shtruan pyetje, të cilat ende nuk kanë një përgjigje. Karl von Horn, Komandanti suedez i Forcave të Kombeve të Bashkuara, theksoi disa nga këto pyetje në shkrimet e tij:

“Vështirësitë fizike të vendosjes së rregullave të paqes u bënë shumë të dukshme... urdhrat tanë ishin specifike: forca

duhej përdorur vetëm në rast vetëmbrojtjeje, ne nuk na lejohej asnjë tolerancë pavarësisht situatës kërcënuese... urdhra si këta paraqesin një komandant me një problem të dukshëm moral, nëse do të rrezikojë jetët e njerëzve të tij, duke i përfshirë në një situatë ku mund të qëllohen para se të kenë mundësi të vetëmbrohen apo të rrezikojnë dështimin e misionit (në suksesin e të cilit mund të varet jeta e shumë civilëve) duke ngurruar për t'i ekspozuar ushtarët e tij ndaj asaj që ai e konsideron si rrezik të një shkalle të patolerueshme”.

Pavarësisht eksperiencave më të fundit me operacionet e vendosjes së paqes në Bosnje, Somali dhe Ruande, ende nuk ka përgjigje të kënaqshme për këtë pyetje thelbësore të parashtruar afërsisht 50 vjet më parë.

Ushtria nuk mund të bëjë çdo gjë për të gjithë njerëzit. Nëse është e mirëstrukturuar dhe e mirëpozicionuar, ajo mund të ofrojë mbrojtje, komunikim, mbështetje logjistike, trajtim mjekësor emergjent dhe evakuim, si dhe gjithashtu një koordinim rigoroz dhe lehtësira kontrolli. Te gjitha këto janë thelbësore në fazat e para të një përgjigjeje komplekse ndaj emergjencave.

Çfarë ushtria nuk mund të realizojë në mënyrë efektive është rivendosja e refugjatëve të kthyer – dhe ushtarët shpesh kanë një prirje të forte drejt detyrave për zbatimin e ligjit. Zakonisht, ndërhyrja direkte në përpjekjet për qetësim të situatës nuk është përdorimi më i mirë i ushtrisë.

Mbi të gjitha, forca ushtarake nuk mund të përdoret për sulme në operacionet humanitare duke luftuar në mes të karvanëve të furnizimeve. Roli i ushtrisë do të jetë me natyrë mbrojtëse: të ndalojë agresionin e armatosur dhe të mbrojë punonjësit e paarmatosur humanitarë, në rast agresioni. Por ushtria nuk mund të angazhohet vetë në shpërndarjen e furnizimeve.

Sfidat e marrëdhënieve moderne civilo-ushtarake

Ironikisht, forcat e armatosura mund të angazhohen në detyra që më shumë i përkasin agjencive civile, vetëm kur ato janë të paafta në krijimin e një mjedisi pozitiv sigurie. Ka prova

që kjo gjë po ndodh tani me forcat e koalicionit ne Irak. Në një raport të fundit të një oficeri që kishte vizituar Irakun, thuhet:

“Iraku mbetet një mjedis gjysmë-armiqësor. Punëdhënësit civilë kanë si detyrë të kujdesen për stafin e tyre dhe shumë prej organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve kane vendosur të rrinë larg. Prandaj forcat e koalicionit kanë aktualisht një rol shumë më të rëndësishëm në rindërtimin e Irakut, sesa në sigurimin e tij”.

Dhe gjithë kjo pa dyshim po ndodh me mospëlqimin e te gjitha palëve: ushtria e nxehur se po i tejkalon rolet e saj e civilët po aq të nxehur nga ajo që ata e konsiderojnë të parregullt.

Një rast tjetër ndodhi në Timorin Lindor, ku shërbimet mjekësore të forcave të armatosura, siguruan, restauruan dhe vunë në punë një spital të Mjekeve pa Kufij. *Por, me kthimin e stafit të Mjekeve pa Kufij, i cili nuk mund të punonte përkrah personelit ushtarak, ushtria e la spitalin në duart e civilëve.*

Në Irak, ashtu sikurse në Timorin Lindor, mundet që as civilët as ushtria të mos shohin faktin se ushtarët bënë thjesht atë çfarë duhej bërë. Pavarësisht suksesit të tyre, ajo “nuk ishte punë për ushtarët”. Këto role, të cilat ushtria mund t'i ketë kryer jashtë nevojës urgjente, nuk do kalojnë lehtë te civilët kur të vijë koha (dhe nëse do të vijë).

Kështu përvoja nuk i jep përgjigje shumë pyetjeve, si përkufizimi i forcës dhe veçanërisht përcaktimi se sa e domosdoshme është ajo në çdo situatë. Nuk ka asnjë kufi ndarës ku ushtria të mbështesë agjencitë civile nga njëra anë dhe të konkurrojë me to nga ana tjetër.

Besimi reciprok mbetet i paqartë. Forcat e armatosura mund ta shohin veten e tyre të futura në një rreth vicioz të drejtuar nga agjencitë. Dhe ata i shohin këto agjenci si të vetmet që kanë qenë të paafta për përcaktimin e roleve të qarta për secilën palë, pavarësisht se kjo gjë është subjekt i debateve ndërkombëtare për një gjenerate. Nga ana tjetër, civilët shpesh kundër dëshirës pranojnë domosdoshmërinë e rolit të ushtrisë në projektet humanitare sepse “vetëm një ushtar mund ta bëjë atë.

Çfarë vjen më pas?

Mbetet shume për t'u bërë për të përcaktuar rolet e ushtrisë në mbështetje të operacioneve humanitare. Përdorimi i forcës, rëndësia e konsensusit në operacionet e vendosjes së paqes dhe marrëdhëniet mes këtyre dy faktorëve, do të vazhdojë të shkaktojë ankth ndërmjet ushtrisë dhe partnerëve të saj civilë. Faktorët komplikues përfshijnë:

- Prezencën e forcave ushtarake të fuqive të mëdha.
- Rolet dhe mundësitë e organizatave kryesore rajonale.
- Marrëdhëniet e organizatave ndërkombëtare, rajonale, qeveritare dhe jo qeveritare.

Bashkëpunimi midis agjencive dhe organizatave duhet të iniciohet në nivelet më të larta. Bashkëpunimi në bazë, i cili varet pothuajse tërësisht nga personalitetet e përkohshme, është i dobët, episodik dhe jetëshkurtër.

Njohja e bazave rrallë përçohet në një mision të ri edhe kur në stafin e tij përfshihen persona me eksperiencë. Është diçka e zakonshme që bashkëpunimi në një mision të ri zhvillohet shume ngadalë pavarësisht niveleve kolektive të përvojës së anëtarëve të organizatave dhe agjencive të ndryshme.

Paragjykimet dhe konfliktet kulturore janë shpesh thelbi i konflikteve që komuniteti ndërkombëtar shpreson të zgjidhë. Përçimi i konflikteve të tilla nga vetja jonë nuk është as profesionale dhe as efektive. Nëse ushtria duhet të funksionojë në operacionet humanitare, partnerët e saj potencialë duhet të kuptojnë qartë aftësitë dhe kufizimet e saj.

Kjo do të përmbushet në mënyrë më efektive nëpërmjet trajnimit, arsimimit dhe ngritjes së marrëdhënieve. Kjo për ne është mënyra më e mirë për të tejkaluar diferencat e shkuar drejt një pike ku ngjashmëritë prodhojnë bashkëpunim, në vend të konkurrencës.

Në një demokraci, ushtria nuk harton politika - por i zbaton ato. Një dështim politik dhe diplomatik për zgjidhjen e këtyre çështjeve nënkupton që punonjësit ushtarakë e civilë duhet të përballen me këto sfida në rrugë dhe në fushën e konflikteve.

Kjo kërkon shumë punë. Pa marrëdhënie të besueshme, kjo është gati e pamundur.

Kështu, shkurtimisht, nuk është e çuditshme që koordinimi civil-ushtarak nuk funksionon më mirë. Në fakt, e habitshme është që ai funksionon.

James. V. Arbuckle është autor i botimit Forcat Ushtarake të Operacioneve të Paqes në shek 21: Nuk është punë për një ushtar? (Routledge, Londër dhe Nju Jork, 2006). Ky artikull botohet me lejen e botuesit.

Marilyn Peterson

POLICIM I DREJTUAR NGA INTELIGJENCA: ARKITEKTURA E RE E INTELIGJENCËS

(përmbledhur nga Elira Hroni)

Hyrje

Një mësim i rëndësishëm që ka rrjedhur nga tragjedia e 11 Shtatorit 2001, është se inteligjenca është puna e gjithsecilit. Edukimi i një kulture mbi konceptet e inteligjencës dhe bashkëpunimit del e nevojshme për të mbrojtur Shtetet e Bashkuara nga krimet e çdo lloji. Parandalimi i krimit dhe shmangja e tij duhet të bazohet në grumbullimin e të gjithë informacionit dhe analizën e tij.

Për këtë arsye nëse policimi i bazuar me inteligjencën duhet të vendoset në SHBA, atëherë duhen marrë në konsideratë të gjitha nevojat e agjencive të zbatimit të ligjit. Shkrimi i mëposhtëm analizon se si agjencitë e zbatimit të ligjit mund të rrisin veprimtarinë e inteligjencës për sigurinë e atdheut, zbatimin tradicional të ligjit dhe parandalimin e krimit pavarësisht sa të sofistikuar mund të jenë operacionet konkrete. Ky shkrim sqaron kuptimet e përdorimet e inteligjencës, ofron shembuj të praktikës së inteligjencës dhe shpjegon si mund të krijosh dhe të mbash kapacitete për inteligjencën.

Çështje të inteligjencës:

Futja e praktikës së policimit, bazuar mbi inteligjencën në agjencitë e zbatimit të ligjit në SHBA shfaqet problematike për shumë arsye. Së pari, shumë agjenci nuk e kuptojnë çfarë është inteligjenca dhe si ta menaxhojmë atë. Së dyti, agjencitë duhet të punojnë për të parandaluar dhe reaguuar ndaj krimit

që ndodh çdo ditë, e njëkohësisht prej tyre pritet të parandalohet terrorizmi. Së treti, kapacitetet ekzistuese të financimit dhe personelit shpesh janë pengesë për zbatimin e policimit të bazuar mbi inteligjencën.

Çfarë është inteligjenca?

Për shkak të keqpërdorimit fjala “inteligjencë” nënkupton çështje të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Gabimi më i rëndomtë është vënia e shenjës së barazimit midis fjalëve “inteligjencë” dhe “informacion”. Informacioni nuk është inteligjencë. Keqpërdorimi i shprehjes ka çuar edhe në frazën “grumbulloj inteligjencë”, në vend që të thuhet “grumbulloj informacion”.

Pavarësisht shumë përcaktimeve të fjalës “inteligjencë” që janë zhvilluar kohët e fundit, përcaktimi më i thjeshtë dhe më i qartë është “informacion plus analizë baras me inteligjencë”. Kjo formulë sqaron ndryshimin midis informacionit të grumbulluar dhe inteligjencës së prodhuar. Kjo do të thotë se inteligjencë nuk është ajo që është grumbulluar, por ajo që është prodhuar, pasi informacioni është vlerësuar dhe analizuar.

Nëse inteligjenca është informacion i analizuar, atëherë çfarë kuptojmë me analizë? Disa agjenci mendojnë se “truri” (software) i kompjuterëve mund të prodhojë analizë, prandaj ata investojnë në teknologji më shumë sesa në analistë të trajnuar.

Megjithatë, analiza kërkon një vëzhgim të thellë, i cili përfundon me konkluzione dhe rekomandime. Kështu, kompjuterët mund të ndihmojnë analizën, duke sjellë në një format të përgjithësuar sasi të mëdha informacioni, që në fund të fundit është vetëm informacion i grumbulluar, i cili është shumë larg së qeni inteligjencë. Me qëllim që informacioni të jetë i përdorshëm ai duhet të analizohet nga një profesionist i trajnuar. Me fjalë të tjera, është inteligjenca ajo që i pajis zyrtarët me atë ç’ka duhet të dinë përpara se ata të vendosin për një planveprim të caktuar. Për shembull, inteligjenca i jep vendimmarrësve në institucionet e zbatimit të ligjit fakte dhe

alternativa përpara se të merren vendime të rëndësishme.

Ia vlen njëkohësisht, për të vërejtur ndryshimin midis inteligjencës taktike dhe asaj strategjike. Inteligjenca taktike kontribuon drejtpërsëdrejti te një hetim i caktuar, ajo drejton veprimin e menjëhershëm, ndërsa ajo strategjike merret me veshje “të natyrës së madhe” siç mund të jenë planifikimi apo alokimi i kapaciteteve njerëzore, ajo shtrihet në kohë dhe përpiqet të japë zgjidhje afatgjatë dhe të natyrave më globale.

Pse inteligjenca është mjaft e rëndësishme?

Inteligjenca është kritike për *vendimmarrjen, planifikimin, pikësynimin strategjik dhe parandalimin e krimit*. Agjencitë e zbatimit të ligjit varen nga operacionet e inteligjencës në të gjitha nivelet; ato nuk mund të funksionojnë në mënyrë efektive pa grumbulluar, përpunuar dhe përdorur inteligjencën.

Vendimmarrja

Grumbullimi i informacionit dhe vendimmarrja se çfarë do të bëhet me të janë çështje rutinore në agjencitë e zbatimit të ligjit. Oficerë dhe menaxherë të agjencive të zbatimit të ligjit shpesh zotërojnë sasi të mëdha informacioni, megjithatë jo në pak raste vendimet bazohen në informacionet që mund të mos jenë të sakta, të plota, apo të jenë keqorientuese. Lëvizja nga grumbullimi i informacionit te vendimmarrja varet nga procesi analitik/inteligjenca dhe që jep si rezultat një vlerësim të saktë të asaj që ka ndodhur apo do të ndodhë.

Përvoja dëshmon që inteligjenca dhe analiza duhet të forcohen edhe në SHBA për t’u përballur me kërcënimet e terrorizmit, dhe personeli i agjencive të zbatimit të ligjit ka shumë për të bërë në këtë drejtim.

Planifikimi

Inteligjenca është mjaft e rëndësishme për një planifikim efektiv dhe veprimin që pason. Në shumë agjenci të zbatimit të ligjit, planifikimi realizohet pa një kuptim të qartë të problemeve të kriminalitetit me të cilat përballlet një njësi e

caktuar urbane. Në këto raste, planifikimi strategjik nuk mbështetet në analizën strategjike apo inteligjencën strategjike, por mbështetet vetëm në çështje të financave dhe vështirësive operacionale. Në një rast buxhetimi të tillë, ky lloj planifikimi vuan nga një mospërputhje midis çështjeve kryesore dhe nevojave të sigurisë që has komuniteti dhe mënyrës se si këto fonde përdoren për të për të adresuar këto nevoja.

Drejtuesit e agjencive të zbatimit të ligjit shpesh inkurajohen për ta parë policimin si një biznes. Modeli Kombëtar i Inteligjencës në Britaninë e Madhe kërkon që:

Biznesi i zbatimit të ligjit është veçse arti i menaxhimit të suksesshëm dhe reduktimit të krimit dhe problemeve të tjera që lidhen me zbatueshmërinë e ligjit... Komponenti qendror e më i rëndësishëm për një planifikim të suksesshëm është identifikimi dhe kuptimi sa më i qartë i situatës dhe gjendjes së biznesit, domethënë, çfarë po ndodh me të vërtetë në terren, natyrën dhe përmasat e problemit, tendencat e krimit, dhe ku janë kërcënimet kryesore⁷.

Duke iu referuar këtyre parimeve, drejtuesit mund të hartojnë plane reaguese për të plotësuar nevojat e komunitetit për siguri. Kjo nuk mund të realizohet vetëm nga vizioni menaxherial i drejtuesit. Kjo duhet të bazohet në një vlerësim kritik mbështetur në inteligjencën dhe analizën.

Objektivi Strategjik

Fokusimi strategjik dhe prioritizimi përbëjnë gjithashtu një rol të rëndësishëm të inteligjencës. Agjencitë e zbatimit të ligjit në kushtet e një buxheti të kufizuar dhe reduktimin e personelit duhet të përdorin me kujdes burimet ekzistuese duke u fokusuar tek individë, zona, dhe operacione që premtojnë rezultatet më të mira për sukses. Është pikërisht inteligjenca që i bën oficerët e hetimit të punojnë me më shumë efikasitet.

Për shembull, për t'u përballur me terrorizmin dhe dhunën në familje Departamenti i Drejtësisë së Kalifornisë shqyrton karakteristikat e një grupi, regjistrin kriminal, analizën e objektivit, dhe pasojat e ndërhyrjes për të përcaktuar se cilat grupe përbënin kërcënim kryesor për shtetin. Pasi të jenë rishikuar dhe krahasuar këto informacione, agjencia priorizon

se te cili grup duhet ndërhyrë më shpejt. Për më tepër, strategjia e ndërhyrjes mund të përcaktohet mbi bazën e të kuptuarit të aktiviteteve të grupit dhe mbi kuptimin e qartë se çfarë burimesh dhe mjetesh janë në dispozicion.

Parandalimi i krimit

Çështja e fundit për të cilën intelijenca është mjaft e rëndësishme është parandalimi i krimit. Duke përdorur intelijencën nga krimet e mëparshme në njësinë urbane të caktuar apo nga zona të tjera, mund të krijohen indikatorë dhe më pas të ndahen përvojat me agjenci të tjera të zbatimit të ligjit. Analistët mund të parashikojnë tendencat e kriminalitetit, bazuar në krahasimin e indikatorëve për njësi të caktuara urbane apo lagje të caktuara, e më pas të marrin masa parandaluese e zbutëse të impaktit të këtyre krimeve.

Ekspertët e kategorizojnë procesin e inteligjencës sipas gjashtë shkallëve: planifikim dhe drejtim, grumbullimi i informacionit, përpunimi, analiza, përhapja dhe rivlerësimi.

Pas 11 Shtatorit 2001

Një muaj pas 11 shtatorit 2001, Komiteti i Operacioneve Investiguese i rekomandoi drejtuesve të tij që të zhvillohej një Samit për Shkëmbimin e Inteligjencës. Samiti u mbajt në mars 2002 me rreth 100 ekspertë të inteligjencës që përfaqësonin agjenci të zbatimit të ligjit në nivel federal, shteti, e vendor nga SHBA dhe Europa. Pjesëmarrësit në të analizuan dy modele: Planin e Përgjithshëm të Inteligjencës Kriminale të SHBA-së dhe Modelin Kombëtar të Inteligjencës së Britanisë së Madhe si udhërrëfyese për policimin e drejtuar nga intelijenca në SHBA.

Rekomandimet kryesore të këtij Samiti ishin:

- Të zhvillohej policimi i bazuar në inteligjencë
- Të ruhej një balancim kritik me të drejtat e njeriut
- Të rriteshin mundësitë për krijimin e partneriteteve
- Të përmirësohen mangësitë analitike dhe të informacionit
- Të merren me trajnime dhe çështje të teknologjisë.

Zhvillimi kryesor i këtij samiti ishte krijimi i Grupit të Punës të Inteligjencës Globale me rreth 30 ekspertë profesionistë. Ky grup hartoi Planin Kombëtar të Ndarjes së Inteligjencës Kriminale, i cili përmbante 28 rekomandime për ndryshime thelbësore në qasjen ndaj policimit. Disa nga këto rekomandime trajtohen më poshtë.

Ku jemi sot:

Disa strategji dhe filozofi të sotme të agjencive të zbatimit të ligjit kanë përqaftuar policimin e drejtuar nga intelijenca.

Policimi i orientuar nga intelijenca

Termi “policim i drejtuar nga intelijenca” e ka origjinën nga Britani e Madhe. Policia e Kent-it e zhvilloi këtë koncept në përgjigje të rritjes së menjëhershme të krimeve ndaj pronës (p. sh., vjedhje shtëpish apo makinash) në një kohë kur buxheti i policisë po tkurrej. Zyrtarët besonin se një numër shumë i vogël individësh ishin përgjegjës për një numër krahasimisht të lartë krimesh. Ata besonin se punonjësit e policisë do të ishin të suksesshëm për të luftuar kriminalitetin, duke u fokusuar në krimet mbizotëruese që ndodhnin në zonën e tyre të policimit¹⁹.

Model i policimit Kent, siç u quajt fillimisht, filloi me klasifikimin e telefonatave duke i priorizuar ato, duke ia kaluar telefonatat më pak të rëndësishme agjencive të tjera jo-policore. Kështu, u fituan shumë orë pune të policisë për t’ia përkushtuar krijimit të njësive të inteligjencës, fillimisht për çështjet e pronësisë, për të 9-të zonat e policimit që kishin në juridiksion. Rezultati ishte një rënie prej 24% të kriminalitetit në 3 vjet²⁰.

Policimi i drejtuar nga intelijenca fokusohet në aktivitetet kryesore kriminale. Sapo problemet e kriminalitetit të identifikohen dhe vlerësohen nga pikëpamja sasiore nga vlerësimi i inteligjencës, menjëherë kriminalistët kryesorë ngarkohen me detyrat e hetimit dhe penalizimit. Meqë grupet dhe individët që u vunë në objektiv të punës së policisë në Kent ishin ata që ishin përgjegjës për një masë të

konsiderueshme të krimeve, ulja e kriminalitetit ishte e konsiderueshme. Shefi i policisë së Kent-it është shprehur se “kjo i dha policisë së Kent-it mundësinë që të konfrontohej me krimin në një mënyrë racionale, aktive, dhe për të vazhduar që të ndërtohej edhe më tej në të ardhmen mbi këtë përvojë të suksesshme.

Policimi i drejtuar nga inteligjenca në SHBA, nga ana e vet ka përfituar mjaft nga përvojat e fundit të zhvillimit të “qendrave të lidhjeve”, të cilat i shërbejnë nevojave policore të shumë agjencive. Këto “qendra lidhjesh” i japin informacion policëve të patrullës, kriminalistëve, menaxherëve dhe pjesëtarëve të tjerë të personelit të agjencive mbi kriminelë konkretë, grupe kriminelësh dhe aktivitete kriminale. Për shembull, qendrat mund të kenë objektiv anti-terrorist, apo edhe kundër krimeve të llojeve nga më të ndryshmet. Qendrat mund të kërkojnë dhe hetojnë shumë informacione (database) të institucioneve publike apo private për të grumbulluar dhe analizuar informacionin. Ato mund të prodhojnë produkte inteligjencë të tyre, të ofrojnë pikëpamje mbi grupe terroriste apo të krimeve të tjera, të analizojnë tendencat e kriminalitetit si dhe të ofrojnë çështje të tjera informacioni për agjencitë pjesëmarrëse.

Aktualisht, ka “qendra lidhjeje” (fusion centers) në mbi 25 shtete të SHBA dhe shumë të tjera janë drejt ngritjes së tyre. Qendra e lidhjes së shtetit të Iowa-s është pjesë e Programit të Parandalimit të Terrorizmit dhe shërben si “pikë grumbullimi” (clearing house) për informacionin dhe të dhënat që potencialisht mund të duhen për të çuar në interpretime të sakta, vlerësime apo veprime parandaluese. Kjo qendër ka shumë objektiva që përfshin edhe një qendër për inteligjencën strategjike për të gjithë shtetin, sisteme të centralizuara të menaxhimit të informacioneve, operacione rajonale, dhe një qendër vëzhgimi 24-orëshe për të shtatë ditët e javës. Ajo mbështet shkëmbimin e informacionit rajonal ndërmjet agjencive dhe emëron një oficer të inteligjencës në çdo rajon²³.

Megjithëse misioni i qendrës është anti-terrorizmi, shumë shpesh ajo përfshin të gjitha llojet e krimeve kryesore, apo lloje të veçanta krimesh si vjedhja e identitetit, pastrim parash, kontrabandë cigaresh, vjedhje me armë, falsifikim

dokumentesh e të tjera. Qasja “për të gjitha krimet” e këtyre qendrave është miratuar tashmë nga grupet këshillimore të politikave të shërbimeve informative.

Policim i mirë është parandalim i mirë i terrorizmit. Me fjalë të tjera, policim profesional i çdo lloji është parakusht për zbulimin e inteligjencës e lidhur si me aktivitete terroriste ashtu edhe me krime të ndryshme konvencionale. Nxitja e kësaj qasjeje i aftëson strukturat vendore të policisë që të përfshijnë policët e thjeshtë në terren që në mënyrë më aktive të punojnë dhe të përforcojnë bindjen se zbatimi i ligjit, parandalimi i krimit dhe parandalimi i terrorizmit janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Kjo qasje ndihmon për të vendosur një balancë midis përpjekjeve anti-terroriste me përpjekjet tradicionale antikrim. Policimi i drejtuar nga inteligjenca i bën policët e thjeshtë të ndihen edhe pjesë e luftës anti-terroriste.

Modeli i Inteligjencës Kombëtare – Mbretëria e Bashkuar

Modeli i Inteligjencës Kombëtare të Britanisë së Madhe ka si funksion sigurinë në komunitet, uljen e kriminalitetit, kontrollin e kriminelëve dhe kontrollin e çrregullimeve publike. Për të arritur këto rezultate ky model përcakton këto objektiva:

- Vendosja e detyrës dhe e procesit koordinues
- Zhvillimi i produkteve të inteligjencës për të udhëhequr operacionin
- Zhvillimi i rregullave për trajnimin me praktikat më të mira të të gjitha niveleve të policimit
- Zhvillimi i sistemeve dhe protokolleve për të lehtësuar inteligjencën.

Takime periodike i mbajnë pjesëmarrësit të fokusuar mbi qëllimet e deklaruara dhe ruajtjen e ciklit të inteligjencës.

Më poshtë po japim disa shembuj se si koncepti i këtij modeli mund të përdoret në kushtet e SHBA-së.

- Sherifi i një konteje mund të identifikojë si prioritet të lartë kontrollin e narkotikëve dhe mbështetur në këtë zhvillon

strategjinë operacionale. Zyra e sherifit përcakton si objektiv eksponentë keqbërës apo grupe trafikantësh, mbyll tregjet e hapura të drogës apo edhe të mbyllura, zhvillon aktivitete sensibilizuese nëpër shkolla për parandalimin e përdorimit.

- Një agjenci shtetërore e zbatimit të ligjit përcakton si prioritet për zbatimin e ligjit mashtrimet me sigurimin e makinave. Agjencia fokusohet tek ata keqbërës që fabrikojnë aksidente, identifikon komunitetet ku mashtrimi me siguracionet është më i shpeshtë, kërkon për metoda të ngjashme veprimesh që mund të dëshmojnë për vazhdimësinë e këtij aktiviteti, dhe ngre një fushatë propagande sensibilizuese publike në lidhje me këtë çështje.
- Një agjenci policie në një qytet të vogël bën prioritet sigurinë në rrugë. Atëherë agjencia fokusohet në vendosjen e rendit në pikat më të nxehta të qytetit. Ajo gjithashtu vendos si objektiv kriminelët e “karrrierës”, kapja e të cilëve ul në masë të konsiderueshme numrin e krimeve që ndodhin. Masat parandaluese mund të përfshijnë rritjen e patrullave, përmirësimi i ndriçimit nëpër rrugë, ashtu si dhe programe sensibilizuese për vëzhgimin e krimit.

Secili prej këtyre shembujve dëshmon se si prioritizmi i një aktivitetit kriminal të ndihmon në zhvillimin e strategjive reaguese respektive. Disa nga këto reagime i përkasin policisë ndërsa të tjerët, mjedisit, edukimit, apo zgjidhje me bazë komunitetin.

Policimi i orientuar nga problemi

Policimi i orientuar nga zgjidhja e problemeve (Problem-oriented policing, POP) është një filozofi policimi e zhvilluar nga Herman Goldstein. Sipas kësaj teorie, policimi i drejtuar nga problemi e shikon kontrollin e kriminalitetit si një studim të problemeve që çon në veprimtari policore të suksesshme dhe strategji korrektuese. Ky model mbështetet në atë që “analiza, studimi dhe vlerësimi janë në themel të policimit të orientuar nga problemi”.

Policimi i orientuar nga problemi kërkon që të vlerësohet çdo problem i ri, dhe të zhvillohet reagim ndaj këtij problemi.

Kjo qasje kërkon gjithmonë krijimtari, jo thjesht zbatimin e së njëjtës ide sado e mirë të jetë ajo.

Modeli SARA (Scanning, Analyzing, Responding, and Assessing) që do të thotë shqyrtimi, analizimi, reagimi dhe vlerësimi shpeshherë konsiderohet të jetë sinonim i policimit të drejtuar nga problemi. Megjithatë, modeli SARA mund të zbatohet për grumbullimin dhe zbatimin e inteligjencës.

Ndërthurja e inteligjencës me policimin e orientuar nga problemi

Siç është bërë e qartë më sipër, operacionet e inteligjencës janë mjaft afër policimit të drejtuar nga inteligjenca.

Si policimi me bazë në komunitet ashtu edhe policimi i orientuar nga inteligjenca janë përdorur për analizën e krimeve, e cila është një analizë e mbështetur në statistika dhe në incidente, më shumë sesa një analizë strategjike inteligjence, e cila mbështetet në probleme të një natyre më të gjerë. Inteligjenca është një proces formal i marrjes së informacionit dhe e shndërrimit të tij në dije. Të dhënat e analizës kriminale, që zakonisht mblidhen për qëllime hetimi përgjithësisht nuk arrijnë të njëjtat standarde si dhe të dhënat e inteligjencës, megjithëse mund të ketë interferenca. Konfuzioni që krijohet shpesh në lidhje me ndryshimin midis të dhënave të analizës kriminale dhe të dhënave të inteligjencës ka të bëjë me ngatërrimet në mjediset policore për natyrën e analizës dhe përdorimit të të dhënave.

Modeli amerikan i policimit të orientuar nga inteligjenca përfshin kapacitetet e inteligjencës të të gjitha agjencive të zbatimit të ligjit. Tradicionalisht, policia vendore (në nivel bashkie) kanë qenë mbështetur më shumë në analiza të kriminalitetit, ndërsa policitë në nivel rajonal, shtetëror apo federal kanë përdorur më shumë analistë inteligjence. Ndërkohë, mbajtja e veçuar e analizës së krimit me analizën e inteligjencës duket se nuk është më e kohës. Agjencitë e vogla të cilët mund të mbajnë një apo dy analistë duhet të përdorin të gjithë oficerët e policisë në mënyrë të gjithanshme, jo thjesht për analiza statistikore, financiare e të tjera.

Tashmë ka ardhur koha që të shuhen barrierat ndarëse midis policive vendore dhe atyre shtetërore apo federale. Analistët

duhet të njihen me një numër gjithmonë e më të madh të burimeve dhe teknikave dhe jo të specializohen vetëm për një çështje si për shembull vetëm për vjedhjet, bandat, apo krimin e organizuar. Megjithëse, agjencitë mund të caktojnë analistë vetëm për një çështje të veçantë, shërbimet më të mira dhe rezultate mund të merren nga analistë që mund të realizojnë të gjitha detyrat e inteligjencës qoftë të kaluara, qoftë të tashme apo edhe të ardhme. Ky fleksibilitet bëhet i mundur nëse ndërthuren së bashku policimi i drejtuar nga intelijenca me policimin e drejtuar nga problemi.

Kjo lloj ndërthurje e inteligjencës duhet të ndodhë edhe në nivelin bazë të policisë. Oficerët e patrullës (inspektorët e rendit, shënimi im E.H) janë sytë dhe veshët e të gjithë policisë, ata duhet të inkurajohen dhe trajnohen për të parë dhe dëgjuar me vëmendje. Informacion që vjen nga kontaktet me njerëzit, bisedat me përfaqësues të biznesit dhe nga takime a vëzhgime të tjera duhet të merret dhe të përcillen tek analistët e inteligjencës, të cilët mund të analizojnë të dhënat dhe të arrijnë në plan veprimi adekuat, të cilët duhet t'ia përcjellin përsëri rolit bazë. Praktika e deritanishme e ndarjes së informacionit vetëm disa struktura të veçanta nuk duhet të vazhdojnë më. Për shembull, kur punonjësit e inteligjencës janë në dijeni të disa aktiviteteve të dyshimta, ata duhet ta analizojnë informacionin dhe t'u japin instruksione policëve në rrugë qoftë për sigurinë e tyre apo për tendencat e krimit.

Partneritetet Polici-Komunitet

Partneritetet polici-komunitet kane qenë një realitet i gjithëpranuar gjatë dekadës së fundit në strategjinë e policimit në SHBA. Doktrina e partneritetit polici-komunitet përfshin:

- Partneritetet e policimit në komunitet
- Parandalim krimi
- Zgjedhja e problemeve

Lufta kundër terrorizmit kërkon lokalizimin dhe matjen e rreziqeve terroriste për të parandaluar veprimtarinë terroriste dhe policitë vendore janë përfshirë në këto përpjekje. Por si

mundet që policitë vendore të njohin kërcënimet potenciale në një njësi urbane në caktuar? Ata duhet të njohin komunitetin, domethënë të njohin përbërjen e komunitetit, lidhjet e tij me vende të tjera apo strukturën e besimeve, si dhe potencialet e tij për të mbajtur anëtarë ekstremistë apo terroristë. Si rregull, oficerët e policisë janë mjaft mirë të njohur me komunitetet dhe normat e tij. Për shembull gjatë patrullimit, punonjësit e policisë mësojnë se kush shoqërohet më kë, ata njohin mirë se me çfarë merren apo dëfrehen anëtarët e komunitetit. Goldstein vlerëson nevojën për të shfrytëzuar më shumë dhe më mirë potencialet e policëve të rolit në bazë. Goldstein beson se policëve në rrugë duhet t'u jepet më shumë mundësi për të menduar dhe të jenë krijues në punën e tyre të përditshme, që duhet të mirëmenaxhojnë njohuritë dhe ekspertizën e akumuluar në vite. Ky qëndrim bën njëkohësisht që punonjësit e policisë të jenë më të kënaqur me punën e tyre, duke i dhënë njëkohësisht qytetarëve një shërbim gjithmonë e më të mirë për investimin e tyre te policia.

Fuqizimi i punonjësve të policisë në nivel vendor me autoritet vendimmarrës dhe duke i njohur ata me indikatorët e terrorizmit mund të jenë mjaft të rëndësishëm në parandalimin e një veprimi terrorist. Mbështetja në policimin në komunitet dhe policimin e drejtuar nga problemi çon në rritjen e sensibilitetit dhe përfshirjen në zgjidhjen e problemeve që bëhen shkas për krime. Kjo përfshirje çon në përpjekje anti-terroriste. Megjithatë, pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, disa agjenci policie i hoqën policët nga komuniteti për t'i angazhuar në veprimtari anti-terroriste, gjë e cila mund të jetë jo frytdhënëse në shmangien e një akti terrorist.

Por, agjencitë e zbatimit të ligjit në nivel vendor janë pjesë e luftës anti-terror, dhe tashmë janë plotësisht të vlerësuara për rolin që luajnë. Alarme apo informacione të tjera u përcillen edhe policive vendore shumë më shumë sesa më parë. Po kështu, janë zhvilluar metoda të veçanta se si aktivitete të dyshimta i raportohen agjencive të tjera në nivel shtetëror apo federal. Bile edhe qytetarë të thjeshtë janë përfshirë në matricën e inteligjencës, nëpërmjet formave të ndryshme e mekanizmave të raportimit nga ana e tyre të sjelljes jo të

zakonshme apo të dyshimtë, që mund të jenë të lidhura me aktivitet kriminal apo terrorizëm.

Këto shembuj tregojnë se policimi në komunitet dhe i orientuar nga problemi nuk janë në kundërshtim me policimin kundër terrorizmit; përkundrazi ato janë forma bashkëpunuese dhe plotësuese të policimit.

Çfarë duhet të bëjmë:

Përpara se një agjenci të zhvillojë policimin e drejtuar nga intelijenca, ajo duhet të adresojë disa çështje kritike. Ndërmjet këtyre çështjeve qëndrojnë:

- Ndërthurjen e inteligjencës me policimin e orientuar nga problemi
- Ndërtimi i partneriteteve polici-komunitet
- Ndërthurjen e inteligjencës strategjike me planifikimin policor
- Zbatimi i politikave për shkëmbimin e informacionit
- Ndërtimi i kapaciteteve për mbështetje analitike të agjencive të policisë.

RREGULLIMI I SIGURISË PRIVATE NË EVROPË: STATUSI DHE PERSPEKTIVA

Hans BORN, Marina CAPARINI & Eden COLE

me asistencën e Vincenza SCHERRER

**Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të
Forcave të Armatosura (DCAF)**

(përshtatur në shqip nga Erjon Alikaj)

1. Hyrje

Kompanitë Private të Sigurisë (KPS) janë një industri në zhvillim të shpejtë. Nga vlerësimet e fundit rezulton se në vitin 2003 të ardhurat totale në nivel botëror të KPS-ve, duke përfshirë shërbimet ushtarake dhe të sigurisë në tregjet e brendshme dhe ato ndërkombëtare, ishin mbi 100 bilion USD dhe se parashikohet të rriten në më shumë se 202 bilion USD në vitin 2010. Studimet e bëra në shtetet evropiane tregojnë gjithashtu një rëndësi në rritje të KPS-ve. Në vitin 2004, personeli i KPS-ve e tejkalonte numrin e punonjësve të policisë së shtetit në shumicën e shteteve të BE-së dhe mesatarisht, një në 500 evropiane ishte punonjës i KPS-ve. KPS-të nuk janë duke u rritur vetëm në personel, por edhe në llojin e shërbimeve që ofrojnë. Këto shërbime variojnë nga ato të detektivëve privatë të sigurimi i transportit të vlerave monetare e materiale, nga shërbimet private të inteligjencës të sigurimi i qendrave të biznesit, aeroporteve, si dhe e komplekseve nukleare e ushtarake. Gjithnjë e më shumë, ato ofrojnë shërbime sigurie në zona të cilat më parë konsideroheshin fushë veprimi e Policisë së Shtetit.

I mandatuar nga Këshilli i Evropës (KE) dhe me mbështetjen e shteteve anëtarë të tij, ky studim fokusohet në zhvillimin e shpejtë të sigurisë private në këto shtete. Arsyeja kryesore e këtij studimi është se pavarësisht se shërbimet private të sigurisë japin një kontribut të vlefshëm në këtë aspekt, fusha e gjerë e aktiviteteve të tyre, ndërthurur me mungesën e standardeve minimale të përbashkëta në këtë sektor, me sjelljen joprofesionale të personelit të sigurisë private dhe me kontrollin e pamjaftueshëm publik të këtyre shërbimeve, ngrenë një rrezik potencial ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

2. Objektivat, qëllimi dhe kufizimet

Siç përcaktohet në mandatin e KE-së, objektivi i këtij dokumenti është të identifikojë zhvillimet e fundit në fushën e kompanive private të sigurisë në shtetet anëtare të KE-së duke përfshirë shembuj të praktikave të mira dhe mënyra për të mundësuar shkëmbimin e tyre. Për më tepër, studimi analizon rregullimin ekzistues në shtetet anëtare të BE-së dhe të KE-së duke synuar identifikimin e pikave të forta e të dobëta në nivelin evropian si dhe në atë kombëtar. Gjithashtu, diskutohet dhe vetërregullimi. Në veçanti, studimi fokusohet në aspektet e mëposhtme të funksionimit të KPS-ve:

- Rregullimi në nivel evropian – mes shteteve anëtare të BE-së dhe të KE-së;
- Rolet ekzistuese dhe detyrat e kompanive private të sigurisë;
- Lidhjet mes kompanive private të sigurisë dhe policisë së shtetit;
- Kontrolli dhe përgjegjësia e kompanive private të sigurisë;
- Kërkesat e pranimit (licencimi i personelit të KPS-ve);
- Përzgjedhja dhe rekrutimi i personelit të sigurisë private;
- Trajnimi i personelit privat të sigurisë;
- Identifikimi i personelit privat të sigurisë;
- Përdorimi i forcës dhe i armëve të zjarrit nga personeli privat i sigurisë;
- Kërkimi dhe bllokimi/ndalimi, kompetenca të punonjësve të KPS-ve.

Studimi mbulon këto probleme për secilin nga 46 shtetet anëtare të KE-së (duke mos përfshirë ato vëzhguese) dhe fokusohet në KPS-të që veprojnë në këto shtete dhe që kanë funksione policore jopublike. Këto funksione mund të jenë mes të tjerash:

- Parandalimi dhe zbulimi i hyrjeve apo aktiviteteve të paautorizuara dhe vandalizmit në pronën private. Këtu përfshihen patrullimi, ruajtja e pronës private, fushave energjetike (nukleare), instalimeve ushtarake dhe siguria në aeroporte;
- Parandalimi dhe zbulimi i vjedhjeve, humbjeve, përvetësimit apo fshehjes së mallrave, parave, obligacioneve financiare, stoqeve, shënimeve, dokumenteve apo letrave me vlerë, p.sh. ruajtja e vlerave monetare gjatë transportit;
- Mbrojtja e individëve – truprojat;
- Pjesëmarrja dhe zbatimi i rregullave, rregulloreve, masave, politikave dhe praktikave të miratuara të kompanisë në lidhje me uljen e kriminalitetit;
- Ruajtja e rendit publik në aktivitete (koncerte, ndeshje futbollit);
- Kallëzimi dhe kapja e shkelësve;
- Transportimi i të burgosurve dhe ruajtja e burgjeve;
- Raportimi dhe përgjigjja ndaj incidenteve dhe thirrjeve, duke përfshirë projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe qendrave të alarmit.

Një sfidë finale e studimit të KPS-ve është fakti që literatura nuk jep një përkufizim të njëjtë të tyre. Këto përkufizime priren të reflektojnë aspektin e policimit të shërbimeve; megjithatë aktivitetet që ato listojnë, si përbërëse të këtyre shërbimeve, përfshijnë fusha që mund të konsiderohen si pjesë të një përkufizimi më të gjerë të KPS-ve, si p.sh. vëzhgimi apo aktivitetet zbuluese. Përkufizime të tjera theksojnë që objektivi kryesor i KPS-ve është përfitimi (përkundrajt objektivit të policisë së shtetit për t'i shërbyer interesit publik). Të tjera nënvizojnë tipin specifik të shërbimeve që KPS-të ofrojnë, si: ruajtja, siguria elektronike, shërbimet e vëzhgimit dhe sensorëve, shërbimi i inteligjencës dhe shërbimet e menaxhimit të riskut. Kërkues të tjerë pohojnë se KPS-të

merren vetëm me sigurinë dhe ruajtjen e brendshme kundrejt sigurisë së jashtme që është fushë veprimi e kompanive ushtarake shtetërore e private. Përballë këtyre përcaktimeve, ne e përkufizojmë një KPS si një entitet tregtar që ofron shërbime sigurie për klientët qeveritarë e privatë.

3. Nevoja për rregullim

Siç u përmend më lart, sektori i sigurisë private në përgjithësi është maturuar në terma të vëllimit dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve të ofruara. Edhe po të konsiderohej nxjerrja jashtë ligjit e KPS-ve, kjo do të që e pamundur për shkak të pikës ku ka arritur kërkesë-oferta për shërbimet e tyre. KPS-të janë të pranishme në shumë fusha të drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, si dhe në ruajtjen e energjisë, transportit, komunikacionit, sigurisë së brendshme, shëndetit dhe rastet e emergjencave. Meqenëse nuk është as e dëshirueshme e as e mundur t'i nxjerrësh ato jashtë ligjit, del e rëndësishme që standardet minimale të identifikohen dhe të integrohen në rregulloret përkatëse të zonës së KE-së.

Rregulloret ndërkombëtare janë në të vërtetë të nevojshme pasi KPS-të ashtu sikurse dhe Kompanitë Private Ushtarake mund të bëhen nomade me qëllim shmangien e legjislacionit kombëtar, të cilin e shohin si të papërshtatshëm dhe të tepërt. Legjislacioni nevojitet për të bërë personelin dhe vetë kompanitë përgjegjës për veprimet e tyre, veçanërisht përballë diferencës së madhe ndërmjet KPS-ve dhe institucioneve shtetërore të sigurisë që konsiston në faktin se këta të fundit janë të kontrollueshëm e vlerësueshëm nga parlamenti, qeveria e publiku, ndërsa KPS-të duhet të përgjigjen vetëm përpara aksionarëve dhe klientëve. Ky rregullim është thelbësor përballë demit potencial që mund të shkaktojë korrupsioni në fushën shumë të ndjeshme të sigurisë. Ai mund të sigurojë gjithashtu mospërfshirjen e punonjësve privatë të sigurisë në krim. Shkurtimisht, rregullimi mund të interpretohet si mekanizmat formalë të kontrollit të miratuara për të drejtuar dhe siguruar zbatimin universal të ligjit. Përgjithësisht mund

të pohohet se një rregullim më i plotë mund të çojë në një përgjegjshmëri më të madhe.

Edhe nga industria e sigurisë private është pranuar se ka nevojë për rregullim. Ai do të ndihmonte në dallimin mes KPS-ve të ndershme dhe të pandershme dhe mundësisht largimin e këtyre të fundit. Kështu rregullimi do të kontribuonte në rritjen e profesionalizmit të sektorit dhe të besimit të publikut te kjo industri. Kjo shpjegon dhe përpjekjet e shumta të KPS-ve në vetërregullimin dhe nxjerrjen e kodeve të sjelljes nga disa firma e organizata (Kapitulli 6). Kjo nevojë serioze nxitet dhe nga një numër rastesh të sjelljeve joprofesionale, abuzive e korruptive e madje edhe të skandaleve publike që kanë përfshirë personelin e KPS-ve në shtetet e KE-së vitet e fundit.

4. Rregullimi: Niveli Evropian

4.1. Bashkimi Evropian

Në lidhje me industrinë private të sigurisë, në nivelin evropian nuk ka asnjë harmonizim të legjislacionit. UNI-Evropa dhe Konfederata e Shërbimeve Evropiane të Sigurisë nxisin miratimin e kërkesave minimale në nivel evropian dhe kanë arritur nënshkrimin e disa opinioneve të përbashkëta mbi licencimin dhe trajnimin. Gjithashtu, është nënshkruar një kod sjelljeje me qëllim rritjen e standardeve dhe garantimin e një niveli të lartë etik e profesional në këtë sektor në BE. Megjithatë, rregullimet kombëtare ndryshojnë nga një shtet te tjetri dhe pasqyrojnë mjedisin e ndryshëm kulturor.

Gjithsesi, mungesa e një legjislacioni të standardizuar evropian për KPS-të nuk nënkupton një vakuum të rregullave përkatëse. Ligji evropian jep shumë shembuj në bazë të të cilëve Komisioni i Komuniteteve Evropiane iu ka kërkuar shteteve rregullimin e KPS-ve në bazë të principeve të lirisë së krijimit, lirisë për të ofruar shërbime dhe lëvizjes së lirë të njerëzve. Gjithashtu, vendimet e Gjykatës Evropiane kanë përcaktuar kompetencën e saj për çështjet e lidhura me industrinë private të sigurisë, meqenëse ai konsiderohet si një sektor ekonomik

i BE-së. Direktiva e fundit e BE-së i përjashton KPS-të nga tregu i brendshëm për shkak të natyrës specifike të shërbimeve të sigurisë, lidhjes së ngushtë me sigurinë publike dhe nevojës për kushte strikte për hyrjen në treg. Por theksohet nevoja për arritjen e një baze të përbashkët dhe harmonizimin e rregullimit të industrisë private të sigurisë në nivelin evropian për të cilin ka filluar dialogu dhe bashkëpunimi.

Në terma të politikës së jashtme, BE-ja pranon që KPS-të janë pjesë e sistemit shtetëror të sigurisë. Prandaj, politikat mbi KPS-të mund të përfshihen në politikat e zgjerimit, integritetit dhe ndihmës së jashtme.

4.2. Këshilli i Evropës

KE-ja ka miratuar shumë pak rregullime specifike për KPS-të, por një numër të madh konventash dhe rekomandimesh në lidhje me funksionimin e tyre në shtetet anëtare. Pjesa më e madhe e tyre ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe me mbrojtjen e ligjit në këto shtete. Konventat janë detyruese për shtetet që i kanë ratifikuar, ndërsa rekomandimet kanë efekt këshillimor. Shkurtimisht disa prej tyre:

4.2.1. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Është themeli i institucioneve të KE-së. Nenet 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues), 5 (e drejta e lirisë dhe sigurisë), 8 (e drejta e jetës private), 11 (e drejta e grumbullimit) dhe 14 (antidiskriminimi).

Në lidhje me ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor (Neni 3), KPS-ve u ndalohet qartësisht të nënshtrojnë shtetasit ndaj një trajtimi të tillë.

E drejta e lirisë (Neni 5) mund të interpretohet në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë deri në provimin e fajësisë dhe me lirinë e lëvizjes.

Kur flitet për lidhjen e KPS-ve me të drejtat e njeriut (Neni 8), pika më e ndjeshme është jeta private pasi aktivitetet vëzhguese të KPS-ve mund ta cenojnë atë. Një shembull është dhënia një pale të tretë e të dhënave të marra nga kamerat.

E drejta e grumbullimit (Neni 11) bëhet objekt kur KPS-të luajnë rol në ruajtjen e ligjit dhe rregullit në aktivitete e demonstrata të mëdha. KPS-të mund të kufizojnë këtë të drejtë, në varësi të rolit të tyre specifik dhe “rregullave të angazhimit”.

Së fundmi, ndalimi i diskriminimit (Neni 14) ka lidhje me funksionimin e KPS-ve. Ato janë të orientuara nga fitimi dhe mund të diskriminojnë ata që nuk mund të përballojnë shërbimet e tyre. Po më shqetësues është diskriminimi i të pambrojturve. Gjithashtu, diskriminimi mund të jetë dhe për shkak të racës, ngjyrës, besimit apo origjinës.

4.2.2. Konventa për mbrojtjen e personave në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale

Kjo Konventë është e një rëndësie të veçantë për funksionimin e KPS-ve pasi përpiqet të përcaktojë standardet minimale në përpunimin automatik të të dhënave personale që është një nga shqetësimet kryesore në lidhje me jetën private. Në veçanti (Neni 5) ajo jep 5 kritere për përpunimin e të dhënave personale të cilat:

- a) do të merren e përpunohen në mënyrë të ndershme e ligjore;
- b) do të mbahen për qëllime legjitime e të specifikuar dhe nuk do të përdoren jashtë këtyre qëllimeve;
- c) do të jenë të duhura, jo të tepërta dhe në lidhje me qëllimin përse mbahen;
- d) do të jenë të sakta dhe, nëse duhet, të rifreskuara;
- e) do të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave jo më gjatë sesa kërkohet për qëllimin për të cilin mbahen.

Për më tepër, Konventa sanksionon që çdo person të mund të verifikojë nëse mbahet informacion për të, si dhe qëllimin dhe identitetin e personit përgjegjës për dosjen e tij (Neni 8). Gjithashtu, Neni 14: Ndalimi i diskriminimit - të drejtat dhe liritë e sanksionuara në këtë Konventë do të sigurohen pa diskriminim për arsye seksi, race, ngjyre, gjuhe, feje, opinioni

politik, origjine kombëtare ose sociale, etj. Neni 5: Personi mund të kërkojë informacion rregullisht pa vonesa të tepërta dhe të kërkojë fshirjen apo korrigjimin e informacionit nëse ai është përpunuar në kundërshtim me legjislacionin kombëtar. Neni 7 sanksionon se KPS-të duhet të marrin masa për ruajtjen e sigurisë së këtyre të dhënave.

Megjithatë, Konventa lejon disa përjashtime thelbësore nga mbrojtja e të drejtave të njeriut në rastet kur të dhënat e mbledhura kanë lidhje me sigurinë e shtetit e atë publike.

4.2.3. Konventa mbi kontrollin e blerjes dhe mbajtjes së armëve të zjarrit nga individët

Kjo Konventë merret kryesisht me transferimin e armëve midis shteteve dhe nuk ka ndonjë referencë të veçantë për mbajtjen e tyre. Ajo jep një kuadër të përgjithshëm për këto transferime çka ka lidhje me KPS-të që veprojnë në kufij ndërkombëtarë.

4.2.4. Konventa për pastrimin e parave, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi

Ajo përshkruan miratimin e masave dhe instrumentet e luftës kundër krimeve të rënda. Konventa nuk i përjashton KPS-të nga zbatimi i saj duke sanksionuar që çdo palë duhet të miratojë masat e nevojshme për identifikimin e gjetjen e pronave që janë objekt konfiskimi (Neni 3). Kjo mund të bëhet nga KPS-të, të cilat përdorin teknika hetimore të parashikuara në Nenin 4 par. 2, si përgjimet.

4.2.5. Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të KE-së

Rekomandimi Nr. R (87) 15 - mbi përdorimin e të dhënave personale në sektorin policor

Seksioni përkatës i këtij rekomandimi lidhet me komunikimin e të dhënave nga policia te KPS-të vetëm mbi bazë të një detyrimi të qartë ligjor e një autorizimi të autoritetit

kompetent. Kjo në rastet kur ky komunikim bëhet me pëlqimin e subjektit të të dhënave apo kur duhet parandaluar një rrezik i atypëratyshëm.

Rekomandimi Nr. R (84) 10 - mbi gjendjen gjyqësore dhe rehabilitimin e personave të dënuar

Sugjeron që vetëm autoritetet përgjegjëse të sistemit të drejtësisë duhet të kenë të drejtë të plotë hyrjeje në regjistrat e gjendjes gjyqësore, ndërsa KPS-të të kenë të drejta të pjesshme të ky arkiv.

Rekomandimi Nr. R (91) 10 – mbi komunikimin të palët e treta të të dhënave personale të mbajtura nga autoritetet publike

Deklarohet se ky komunikim dhe të dhënat personale duhet të mos cenohen duke u shoqëruar edhe me rojë e garanci të veçanta.

Rekomandimi Nr. R (84) 23 – mbi harmonizimin e legjislacioneve kombëtare në lidhje me armët e zjarrit

Sugjeron miratimin në ligjet kombëtare të klasifikimit të armëve në bazë të kriterëve për listimin e atyre të ndaluara për individët, atyre që kanë nevojë për leje e atyre që duhet të deklarohen. Kjo mund të ketë ndikim në tipat e armëve që personeli i KPS-ve do të mbajë e në praktikat për dhënien e lejeve të armëve.

Rekomandimi Nr. R (82) 15 – mbi rolin e ligjit penal për mbrojtjen e konsumatorit

Jepet nocioni se KPS-të janë jo vetëm përgjegjëse për shërbimet e ofruara, por dhe penalisht përgjegjëse për veprimet e tyre. Inkurajohet hartimi i kodeve të etikës së tregtisë për mbrojtjen e konsumatorëve.

Rekomandimi Nr. R (88) 18 – mbi përgjegjësinë e ndërmarrjeve për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre

Mund të interpretohet si një hap tjetër i rëndësishëm për të siguruar që KPS-të të jenë përgjegjëse për veprimet e aktivitetet e tyre edhe nëse shkeljet nuk kanë lidhje me qëllimet e ndërmarrjes. Gjithashtu, rekomandohen sanksione nga paralajmërimet deri te gjobat e heqja e licencës.

Rekomandimi Nr. R (87) 19 – mbi organizimin e parandalimit të krimit

Është nga rekomandimet e pakta të KE-së që përmend shprehimisht industrinë private të sigurisë. KPS-të luajnë një rol parandalues të krimit dhe është e nevojshme të merren masa për të siguruar që veprimtaritë e tyre të mos bien ndesh me funksionet e policisë dhe të mos rrezikojnë liritë individuale dhe rendin publik. Ai përpiqet të rregullojë marrëdhëniet themelore midis policisë private e asaj publike.

I rekomandon qeverive që:

a) të miratojnë, rishikojnë apo kompletojnë rregulloret që normojnë autorizimin fillestar, licencimin periodik e inspektimin e rregullt nga autoritetet publike ndaj KPS-ve;

b) të vendosin standarde bazë për personelin e KPS-ve, si: uniforma e ndryshme nga ajo e policisë së shtetit, dokumente identifikimi, trajnim të mjaftueshëm, njohje bazë të ligjit penal, të teknikave të sigurisë e të drejtave, detyrimet e përgjegjësitë si dhe norma sjelljeje;

c) të inkurajojnë marrëdhënie pozitive mes policisë dhe KPS-ve në mënyrë që kjo e fundit të ndihmojë të parën në parandalimin e krimit.

Rekomandimi Rec (2003) 21 – mbi partneritetin në parandalimin e krimit

Edhe ky mëshon mbi idenë e bashkëpunimit policor publik-privat. Veçanërisht hedh idenë se përgjegjësia për parandalimin

e krimit duhet të ndahet gjerësisht në shoqëri dhe se partneritetet janë mënyra praktike për ta arritur këtë.

Rekomandimi Nr. R (2000) 10 – mbi kodet e sjelljes për personelin publik

Kërkon miratimin e kodeve kombëtare të sjelljes për zyrtarët publikë sipas një modeli që i aneksohet rekomandimit. Dispozitat e kodit i përshtaten dhe aktivitetit të KPS-ve.

Rekomandimi Rec (2001) 10 – Kodi Evropian i etikës së policisë

Është i rëndësishëm për vetërregullimin e KPS-ve sepse i adresohet heshtjeve, si: rekrutimi, trajnimi, uniforma, mbrojtja e të dhënave, korrupsioni dhe përdorimi i forcës. Megjithëse zbatohet në policinë e shtetit, shumë dispozita mund të përdoren dhe nga KPS-të.

4.2.6 Konkluzion

Nga sa më sipër, del se aktiviteti i KPS-ve mund të prekë të drejtat e njeriut. Megjithëse ka shumë konventa e rekomandime të KE-së, ka një mungesë të rregullimit të qartë të industrisë private të sigurisë.

5. Rregullimi: Niveli Kombëtar

Më poshtë jepet gjendja e rregullimit në nivel kombëtar në shtetet anëtare të KE-së.

5.1. Detyrat dhe rolet e mundshme të KPS-ve

Larmia e shërbimeve të KPS-ve në shtetet e KE-së ndahet në 6 kategori: ruajtja e vendeve e ndërtesave pothuajse në të gjithë shtetet, fushat nukleare (Gjermani e Rumani), ruajtja e instalimeve ushtarake (Austri, Estoni e Gjermani), aeroportëve

(Austri, Gjermani, Rumani, Britani e Madhe, Suedi, Holandë, Greqi, Francë e Shqipëri), porteve (Shqipëri, Bullgari e Holandë) dhe parlamenteve (Bullgari e Rumani). Këtu përfshihen dhe instalimi e mirëmbajtja e sistemeve të alarmit dhe të vëzhgimit. KPS-të ofrojnë shërbime për ruajtjen dhe transportin e vlerave të çmuara materiale e monetare, si dhe shërbime truprojash.

Roli i saktë i KPS-ve në shtetet e KE-së varet nga disa faktorë: miratimi gjerësisht i modeleve liberale të organizimit të sektorit publik, tenderimet konkurruese, kontraktimi i KPS-ve për shërbime që më parë kryheshin nga shteti, qeverisja liberale, niveli i demokracisë dhe i respektimit të ligjit në vendet post-komuniste, reforma e thellë në institucionet e legjislacionin e tyre. Publiku në këto vende priret të mos besojë se policia e shërbimet shtetërore të sigurisë nuk mund të merren efektivisht me problemet e krimit dhe i drejtohet shërbimeve të KPS-ve. Faktor tjetër është dhe tipi i kërcënimeve apo rreziqeve që has shoqëria (p.sh. në Serbi për shkak të vrasjeve të shumta, është rritur ndjeshëm kërkesa për truproja).

Roli i KPS-ve në Rusi e në vendet ish-komuniste duhet kuptuar në kontekstin e ndryshimeve dramatike në situatën dhe reformën e sigurisë në këto vende pas viteve '90. Si dhe në Perëndim, siguria nuk mund të konceptohej më si monopol i shtetit. Në këto shtete privatizimi i sigurisë dhe zhvillimi nuk ishte progresiv, por filloi me një big-bang pas '90 si pasojë e mungesës së një sistemi efektiv të mbrojtjes së pronës. Rreth 70 % e kontratave në vitet e para pas '90 në Rusi ishin me KPS. Por mbushja e këtij vakuumi të madh solli dhe një përhapje të gjerë të korrupsionit jo vetëm në sektorin privat, por sidomos në atë publik të sigurisë. Siguria u bë një komoditet pavarësisht kush e ofronte atë.

5.2. Lidhjet midis KPS-ve dhe policisë së shtetit

Ato mund të jenë problematike për shumë arsye, si p.sh. konflikti i interesave për sa i përket punësimit privat-publik, të cilin disa shtete e kanë zgjidhur me miratimin e ligjeve që

kufizojnë akumulimin e aktiviteteve. Në Belgjikë, Greqi e Portugali, KPS-të nuk lejohen të merren me prodhimin e shpërndarjen e armëve, punonjësit e tyre nuk duhet të kenë punuar në polici a shërbimin sekret 5 vitet e fundit (Belgjikë, Francë e Portugali), ose të mos punojë në polici (Suedi) apo në policinë kriminale (Holandë) ose në një pozicion publik (Spanjë, Lituani e Maltë). Në disa shtete këta punonjës nuk mund të jenë avokatë apo noterë si në Lituani. Në Francë, KPS-të nuk mund të jenë aktive në një aktivitet tjetër ekonomik. Në Rusi ushtarakët mund të punësohen dhe në ndërmarrje të tjera që nuk kanë lidhje me punën, me lejen e drejtorit.

Një konflikt tjetër mund të ndodhë në rastet e konkurrimit për të njëjtën kontratë apo kur ato janë duke punuar në të njëjtën zonë ose në të njëjtin aktivitet. Në Kosovë, gjatë aktiviteteve KPS-të përgjigjen për sigurinë e ambienteve, kurse policia për kontrollin e trazirave të mundshme. Në Kroaci e Bullgari, KPS-të mund të konkurrojnë për të njëjtën kontratë duke rrezikuar që KPS-të të ofrojnë shërbim më të lirë.

Në Shqipëri, nga ana tjetër, konkurrenca pothuajse nuk ekziston sepse favorizohet policia publike për arsye se ligji i KPS-ve nuk i lejon këto të fundit të kenë një numër të punësuarish më të madhe se 5 % të numrit të policive vendore.⁸⁰

Problemi i konkurrimit mund të rëndohet në rastet kur policia është institucioni që lëshon licencat e KPS-ve dhe i kontrollon ato.

Konflikt tjetër lind kur shumë ish-policë apo ushtarakë punojnë për KPS-të. Meqenëse KPS-të mirëmenaxhohen dhe funksionojnë mbi një bazë të qartë ligjore, kjo nuk është domosdoshmërisht një problem. Por në vendet e demobilizimit post-konflikt apo të reformave të sektorit të sigurisë, KPS-të janë një mundësi pune interesante e shpesh e vetmja e tyre. Megjithatë, nëse sektori i KPS-ve nuk është i rregulluar siç duhet apo nëse ligjet nuk zbatohen, ekziston një rrezik për ushtrim influence apo bërjen e favorizimeve a detyrimeve midis policëve në detyrë dhe ish-kolegëve të tyre që aktualisht punojnë për KPS-të.

5.3. Kontrolli dhe përgjegjësia e KPS-ve

Shkalla e kontrollit dhe përgjegjësive së KPS-ve varet nga një kuadër i qartë ligjor, institucionet efektive të mbikëqyrjes dhe tipi i mbikëqyrjes. Nëse kontrolli nuk bazohet në një kuadër rregullator uniform, ai dobësohet ose bëhet jo efektiv. Kështu, në Qipro mungojnë ligjet për KPS-të, Malta ka një legjislacion rregullator për këtë industri, por rregullimi specifik i kontrollit e përgjegjësive është lënë jashtë tij, në të tjera shtete si Zvicra e Italia rregullimi është çështje e qeverisjes së deleguar që përshtat pjesë të ndryshme të legjislacionit me pjesë të ndryshme të territorit të vendit; në disa shtete si Gjermania e Austria, kuadri rregullues bazohet në ligjet e përgjithshme tregtare në vend të ligjeve specifike mbi KPS-të. Shtrohet pyetja se deri në ç’pikë ligjet tregtare mund të zbatohen plotësisht në sektorin privat të sigurisë, i cili është dinamik dhe specifik e lidhet me ruajtjen e ligjit e rendit në respekt të të drejtave të njeriut. Një grup i fundit shtetesh si Franca, Britania e Madhe e Holanda kanë miratuar ligje specifike mbi sigurinë private.

Në shtete të ndryshme të BE-së ka një larmi institucionesh mbikëqyrjeje të KPS-ve. Në disa prej tyre KPS-të janë nën kontrollin e policisë (lokale) si Greqia, Danimarka, Sllovakia e Hungaria, në të tjera përgjegjëse për kontrollin janë autoritetet civile lokale si në Gjermani, Itali e Suedi; Ministria e Brendshme kontrollon KPS-të në Slloveni, Itali, Poloni e Holandë; Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse në Luksemburg dhe në Irlandë e Britani është një autoritet special i sigurisë.

Çështje tjetër është dhe se si ushtrohet mbikëqyrja, a kufizohet vetëm në “letër” – çka do të thotë t’u kërkohet KPS-ve të paraqesin raporte vjetore, a përfshin ajo vizita kontrolli të paralajmëruara apo të papritura, apo a bazohet në ankesat e qytetarëve a bizneseve për veprimtari të paligjshme të KPS-ve. Në këtë aspekt, një studim i gjerë i BE-së mbi KPS-të nuk merr në konsideratë rolin e komisioneve hetimore parlamentare apo të Avokatit të Popullit, të cilët mund të bëjnë kërkime të pavarura mbi ankesat e skandalet. Një aspekt tjetër

është dhe ekzistenca e sanksioneve në raste shkeljesh. Në vendet e BE-së ato variojnë nga gjrobat, heqja e përkohshme a e përhershme e licencës e deri te burgimi.

Në shumë vende të Evropës Juglindore (EJL), është Ministria e Brendshme përgjegjësjë për mbikëqyrjen e aktiviteteve të KPS-ve. Megjithatë, mbikëqyrja është e dobët dhe e paqartë. Në Shqipëri vetë policia është ngarkuar të mbikëqyrë KPS-të. Në të gjithë shtetet e EJL-së pushteti parlamentar mbi këtë fushë nuk ushtrohet dhe funksionimi i Avokatit të Popullit është i dobët e i paqartë. Vetërregullimi në termat e kodeve të sjelljes së KPS-ve nuk ekziston në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci e Moldavi. Në disa shtete të tjera vetëm disa KPS kanë kod sjelljeje, ndërsa të tjerat kanë kode sjelljeje sekrete, të panjohura nga publiku.

Mungesa e kuadrit kombëtar rregullator dëmton mbikëqyrjen në shumë shtete të EJL-së. Në Serbi nuk ka ligj specifik, në Bosnjë-Hercegovinë nuk ka legjislacion kombëtar (federal), por vetëm në nivel entitetesh që çon në diferenca midis tyre dhe kontribuon zhvillimin e KPS-ve në linja etnike. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka shqetësime për moszbatimin e duhur të ligjit, ndërsa në Moldavi legjislacioni është tepër i ndërlikuar dhe sanksionet të pamjaftueshme për të ndëshkuar paligjshmërinë e KPS-ve. Në Rumani ligji lë shteg për keqinterpretim dhe policia nuk ka fuqi të mjaftueshme për të mbyllur aktivitetin e paligjshëm apo të dobët të KPS-ve. Kosova paraqet një rast interesant pasi kuadri rregullator bazohet në rregullimin e komunitetit ndërkombëtar (UNMIK) në ndryshim nga ligjet e tjera kombëtare.

5.4. Kërkesat e pranimit

Sistemet e licencimit përcaktojnë ç'tip shërbimi mund të sigurohet nga KPS-të dhe ç'kriteret të përdoren ndaj tyre. Këto kriteret mund të jenë në nivelin e kompanisë e në atë personal. Në shumicën e shteteve të BE-së nevojitet një licencë që KPS-ja të bëhet operacionale. Në shtete të ndryshme ka institucione të ndryshme që e lëshojnë këtë licencë dhe kohëzgjatja e saj varion (p.sh. 5 vjet në Danimarkë).

Shumë nga vendet e EJL-së kanë një sistem licencimi, përveç Serbisë. Gjithsesi, ligjet kanë boshllëqe. P.sh. në Bullgari, megjithëse KPS-të duhet të licencohen, ligji lejon kompanitë private të kenë rojat e departamentet e tyre të sigurisë. Ky përjashtim mundëson një keqpërdorim të ligjit e çon në mosregjistrimin e KPS-ve. Në Rumani, si dhe në Bullgari, licenca jepet për 3 vjet, që, duke qenë periudhë relativisht e gjatë, ul probabilitetin që aktiviteti jociësor të çojë në heqjen e saj. Në Malin e Zi ka rreth 500 KPS të paregjistruara që veprojnë. Në Rusi kërkesat e hyrjes ekzistojnë për kompaninë dhe për nivelin e punonjësve; kompanive u duhet një licencë, drejtorët duhet të kenë një shkallë të lartë arsimimi dhe ligji përcakton papajtueshmërinë e pozicionit të menaxherit me ndonjë funksion publik.

5.5. Përzgjedhja dhe rekrutimi i personelit privat të sigurisë

Rregullimi i tyre është vital për profesionalizmin dhe integritetin moral të sektorit. Në fakt konsiderohet në interesin e KPS-ve të vetërregullohen sipas disa standardeve bazë. Për shkak të vështirësisë së përcaktimit të moshës dhe nivelit të shkollimit që duhen për të arritur një performancë maksimale, është i nevojshëm standardizimi i kërkesave bazë për rekrutimin në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Veçanërisht, puna në sigurinë private sjell rrezikun e përdorimit të panevojshëm të forcës nga personeli, i cili nuk është kontrolluar siç duhet para rekrutimit. Legjislacioni për përzgjedhjen e rekrutimin në shtetet e KE-së është i ndryshëm.

Shumë vende në BE kanë miratuar një kriter bazë për përzgjedhjen e personelit të sigurisë private, që është kërkesa për mosqenien skeduar për kryerjen e veprave penale. Përveç Gjermanisë e Republikës Çeke ku ky kriter nuk është i detyrueshëm, në shtetet e BE-së është një aspekt i standardizuar. Përveç kësaj në disa shtete janë futur dhe disa kriteret e tjera si mosha minimum (18 ose 21 vjeç), tipare të mira karakteri, shtetësia, përvoja e punës dhe mospjesëmarrja në aktivitete të papajtueshme (mbajtja e një pozicioni në shërbimin publik). Një problem ngrihet në lidhje me faktin

se cili institucion do merret me kontrollin e të kaluarës së aplikantit/punonjësit (në Holandë është vetë kompania) dhe të aktivitetit kriminal (si Zyra e të Dhënave Kriminale në Britaninë e Madhe) si dhe me frekuencën e bërjes së këtyre kontrolleve (në Suedi bëhen çdo vit).

Vendet ballkanike të KE-së duket se kanë gjithashtu një përafrim të standardizuar të kërkesave minimum për kontrollin e të kaluarës dhe të aktivitetit kriminal të punonjësve të KPS-ve siç është rasti në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Moldavi e Rumani. Megjithatë, në Shqipëri p.sh. kontrolli i të kaluarës së punonjësve është i pamjaftueshëm dhe punonjësit e palicencuar të KPS-ve janë të përhapur gjerësisht. Vendi i vetëm ku nuk ka detyrim ligjor për kontroll të së kaluarës është Bullgaria. Është gjithsesi interesante të thuhet se kushtet për punësim në këto vende të Ballkanit janë vërtet kërkuese, p.sh. në Kroaci kërkohet shkrimi i Latinishtes, në Moldavi duhet provuar që punonjësi i ardhshëm nuk përdor drogë, apo në Bosnjë-Hercegovinë ku ai duhet të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Për më tepër, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, punonjësit e KPS-ve duhet të jenë shtetas të këtij vendi dhe ligji ndalon KPS-të e huaja të veprojnë në këtë shtet. Po kështu numri maksimal/tavan i punonjësve që mund të licencohen nga një KPS në këtë vend është 6000 persona.

Në Rusi, punonjësit duhet të jenë me shtetësi ruse, minimalisht 18 vjeç për rojat dhe 21 për detektivët, pa të meta mendore (të shpallura nga gjykata), të mos vuajnë nga sëmundje e të mos jenë dënuar apo të mos jenë duke u ndjekur penalisht për krime. Më tej, personat që janë shkarkuar nga policia, prokuroria, gjykatat apo nga të tjera institucione të zbatimit të ligjit pasi i kanë kompromentuar ato, nuk lejohen të punojnë në KPS.

5.6. Trajnimi i personelit të sigurisë private

Personeli i KPS-ve kërkon trajnim të duhur me qëllim që të sigurojë një nivel të kënaqshëm profesionalizmi në sektor dhe të garantojë që rregullat në lidhje me armët, kërkimin dhe kapjen e personave a objekteve të kuptohen dhe të

zbatohen. Një trajnim i duhur mund të sigurohet më mirë nga një institucion i pavarur dhe mundësisht i akredituar sesa nga kompania e cila do të kontribuonte për të siguruar një nivel të caktuar kontrolli mbi cilësinë dhe kohëzgjatjen e trajnimit. Trajnimi që administrohet tërësisht nga kompania dhe që nuk është i rregulluar në terma të kohëzgjatjes apo substancës, mund të jetë i pamjaftueshëm, p.sh. arritja deri në një orë në disa raste e konkretisht në Serbi. Nevoja për standard minimum në lidhje me trajnimin është e dukshme, megjithëse fatkeqësisht nuk ndodh kështu në realitet në KE.

Në të vërtetë, në shtetet e BE-së anëtare të KE-së nuk ka asnjë standardizim mbi nivelin e trajnimit të duhur për t'u bërë punonjës i sigurisë private. Ndërsa disa shtete kërkojnë që trajnimi të rregullohet nga Ministria e Brendshme (Spanjë) të tjerë sugjerojnë se trajnimi vullnetar i vetë kompanisë është i mjaftueshëm (Itali). Gjithsesi, numri minimum i orëve të trajnimit ndryshon shumë: Danimarka ose Spanja aplikojnë nga 111 deri 240 orë, ndërsa Franca vetëm 32 orë. Ka gjithashtu diferenca në numrin e sesioneve të trajnimit që punonjësit duhet të bëjnë çdo vit. Austria është shteti me një rregullim veçanërisht të dobët mbi trajnimin e punonjësve të KPS-ve; kohëzgjatja dhe përbërja caktohen nga kompania dhe nuk ka dispozita ligjore rregulluese. Në Gjermani, nga ana tjetër, stafi operacional është i detyruar të bëjë një trajnim për të paktën 40 orë, i cili ofrohet nga Dhoma e Tregtisë.

Trajnimi në vendet e Ballkanit varion megjithëse duket se është më strikt se në BE. Vendet e Evropës Juglindore anëtare të KE-së, përveç Serbisë dhe Malit të Zi, kërkojnë një kohëzgjatje minimum të trajnimit. Në Shqipëri është 15 ditë, çka është më shumë se në shtetet e BE-së. Por meqenëse trajnimi administrohet nga kompania, kontrolli i shtetit mbi cilësinë e tij është minimal. Disa vende kërkojnë që trajnimi të bëhet nga një entitet i pavarur. Në Kroaci, personeli i KPS-ve duhet të bëjë një trajnim dhe të kalojë një provim në një institucion të autorizuar. Personeli që ka punuar në polici mbi tre vjet përjashtohet nga provimi.

Megjithatë nuk flitet fare për cilësinë e trajnimit dhe për faktin nëse personeli i KPS-ve realisht mëson diçka që do t'i

mundësonte një gjykim më të mirë p.sh. në lidhje me përdorimin e forcës. Problemi i cilësisë në shtete të ndryshme është një aspekt interesant dhe duhet përpunuar më tej.

5.7. Identifikimi i personelit të sigurisë private

Është e rëndësishme që personeli gjatë gjithë kohës të veshë uniforma dhe të mbajë shenja identifikuese për t'u dalluar nga qytetarët e thjeshtë si dhe nga zyrtarët publikë. Pa një sistem të qartë identifikimi të personelit privat të sigurisë, rreziku i abuzimit është i dukshëm. Shpesh nuk ka një legjislacion mbi këtë aspekt të sigurisë në Evropën Juglindore.

5.8. Përdorimi i armëve të zjarrit

Rëndësia e rregullimit strikt për mbajtjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit, është e dukshme. Armët si mjet dhune, në duar të gabuara mund të kenë pasoja serioze. Është i rëndësishëm inkurajimi i regjistrimit të tyre në nivel kompanie, por dhe individual si dhe të mbetet një gjurmë e pronarit të armës. Po ashtu dhe sigurimi i magazinimit të tyre dhe kontrolli i duhur nga kompania.

Në BE praktika është e ndryshme: në Britaninë e Madhe, Irlandë, Danimarkë, Francë e Holandë, armët ndalohen për personelin privat të sigurisë ndërkohë që lejohen në shtetet e tjera. Por edhe kur lejohen, niveli i kontrollit dhe kriteret e marrjes së lejes, ndryshon në varësi të rrethanave që e bëjnë mbajtjen të nevojshme dhe të tipit të armës.

Mbajtja e armëve të zjarrit lejohet në të gjitha shtetet e EJT anëtare të KE-së. Ndryshon vetëm kontrolli i ushtruar mbi to. Në Shqipëri, armët duhet të regjistrohen në emër të kompanisë dhe të punonjësit që të sigurohet kontrolli mbi të në çdo kohë. Në Bosnjë-Hercegovinë arma regjistrohet vetëm në emër të kompanisë, në Bullgari punonjësit e KPS-së duhet të licencohen për të mbajtur armë zjarri, në Kroaci punonjësit ndahen në punonjës të rangut të ulët – rojë sigurie e të rangut të lartë – agjentë sigurie, vetëm këta të fundit lejohen të mbajnë armë, të cilat regjistrohen në emër të kompanisë dhe nuk mund

të jenë pronë e punonjësit. Në Serbi punonjësit kanë të njëjtat të drejta si dhe qytetarët e thjeshtë në lidhje me armët e zjarrit.

5.9. Kërkimi dhe kapja/bllokimi

Në varësi të shtetit, KPS-të kanë fuqi të ndryshme për kërkuar dhe kapur persona e sende. Në disa shtete ato mund të bëjnë kërkime dhe bllokime të kufizuara si në Poloni, Sllovaki, Slloveni, Greqi (vetëm në aeroport) dhe në Austri (vetëm me pëlqimin e personit të interesuar). Në shtete të tjera ato nuk kanë më shumë fuqi sesa çdo shtetas për të kërkuar e kapur persona si në Holandë, Qipro, Britani të Madhe, Gjermani, Republikën Çeke, Luksemburg, Finlandë dhe Spanjë. Në disa të tjera kanë fuqi të veçanta si p.sh.:

- Lituan: të ndalojë një autor të dyshuar duke kryer apo menjëherë pas kryerjes së një krimi dhe ta shoqërojë për në polici, të kontrollojë objektin nën mbikëqyrje dhe bën që personat të tregojnë sendet që kanë me vete me pëlqimin e tyre;

- Letoni: të arrestojë personat që shkelin ligjin apo që kanë hyrë ilegalisht në objektin e ruajtur, si dhe të kontrollojnë hyrjet dhe dokumentet e identifikimit;

- Estoni: të kapin çdo person që hyn ilegalisht në një objekt të ruajtur dhe t'u bëjnë personave të dyshuar kontrole sigurie.

Në shtetet e EJJL-së të drejtave të punonjësve të KPS-ve për të kapur e kërkuar i jepet vetëm një rëndësi sporadike. Në Kosovë, punonjësit e KPS-ve mund të arrestojnë persona dhe të informojnë menjëherë autoritetet kompetente.

6. Vetërregullimi

Vetërregullimi ekziston në forma të kodeve të sjelljes apo të etikës, të cilët vendosin standarde bazë të sjelljes për punonjësit e KPS-ve. Ai synon të arrijë të njëjtin objektiv si dhe rregullimi shtetëror prandaj përpiqet të vendosë një nivel të caktuar kontrolli mbi aktivitetet specifike. Megjithëse i ngjan rregullimit shtetëror, ai perceptohet si më i mangët dhe që i

mungon kredibiliteti në sytë e publikut. Kjo lidhet me natyrën vullnetare të vetërregullimit dhe rrjedhimisht me perceptimin se kjo industri nuk do të vetëregullohet për çështje që nuk janë në interesin e saj. Megjithatë ai mbetet një mekanizëm i rëndësishëm i kontrollit mbi nivelin e industrisë. Kështu zhvillimi i mekanizmave të denoncimeve apo kodet e sjelljes ndikojnë jo vetëm në profesionalizmin e sektorit, por dhe në menaxhimin e tij demokratik.

Me qëllim vlerësimin e vetërregullimit, më poshtë paraqitet një grup kriteresh mbi aspektet kryesore të tij. Në veçanti, vetërregullimi duhet të kalojë një test kompletimi dhe një test zbatimi. Testi i parë synon ekzaminimin nëse mbulohen të gjitha aspektet mbi menaxhimin demokratik të sigurisë private përfshirë të drejtat e njeriut dhe respektimin e ligjit. Pra, një instrument vetërregullimi është i plotë kur ai përfshin standarde minimum për përzgjedhjen e rekrutimin, trajnimin, identifikimin, mbajtjen e përdorimin e armëve të zjarrit si dhe kërkimin dhe kapjen/bllokimin. Duhet përmendur dhe se si do të menaxhohen marrëdhëniet me policinë dhe çfarë masash duhen marrë kundër korrupsionit. Testi i dytë konsiston në monitorimin e zbatimit. Duhet të ketë dispozita specifike mbi mënyrën se si do të informohen punonjësit për përmbajtjen e kodit, mbi metodat e monitorimit të zbatimit dhe mbi informacionin specifik për masat që duhen marrë në rast shkeljesh. Veçanërisht duhet të ketë dispozita të qarta mbi deklaratimet, masa të detajuara për hetimet dhe sanksione në mënyrë që punonjësit të jenë të interesuar ta njohin e respektojnë kodin. Gjithashtu, kjo është në interesin e pronarëve të KPS-ve për të shmangur problemet e mundshme. Në këtë kontekst janë diskutuar metoda të mundshme të vetërregullimit në nivel rajonal dhe kombëtar shembuj të të cilave po paraqitim më poshtë:

6.1. Niveli Evropian

Në nivel rajonal, vetërregullimi është në formën e Kodit Evropian të Sjelljes nënshkruar nga Konfederata e Shërbimeve Evropiane të Sigurisë (KSES) që përfaqëson punëdhënësit në

industri dhe UNI-Evropa që përfaqëson bashkimet e tregjeve. Ky kod mbulon një fushë të gjerë temash që nga përzgjedhja, rekrutimi e trajnimi e deri te marrëdhëniet me policinë dhe KPS-të e tjera. Gjithashtu, ai përmban një seksion mbi mënyrën e zbatimit të kodit. Ndërsa ai ndikon në rritjen e profesionalizmit, kodi është më pak efektiv në lidhje me të drejtat e njeriut e me problemin e armëve, i cili mungon. Për më tepër ai mbetet i dobët pasi dispozitat e tij të vagëta nuk vendosin standarde minimum në lidhje me trajnimin. Ky boshllëk mund t'i atribuohet ndryshimit të rregullimeve nga njëri shtet në tjetrin. Megjithatë KSES-i dhe UNI-Evropa e shohin kodin si një hap të parë drejt harmonizimit të sektorit në rajon. Shembull tjetër është Manuali Evropian i Kualifikimit Profesional për Bazat e Ruajtjes miratuar nga këta dy institucione. Ai është një pjesë e rëndësishme e vetërregullimit pasi fut standardet bazë të trajnimit të rojave të sigurisë.

6.2. Niveli Kombëtar

Vetërregullimi zë vend në nivel industrie apo agjencie. Për këtë të fundit është e vështirë të vlerësohet shtrirja e tij. Shumica e KPS-ve nuk kanë asnjë informacion në website-t e tyre mbi kodet e sjelljes duke krijuar përshtypjen se këta kode nuk ekzistojnë. Edhe ato pak që e kanë, megjithëse mbulojnë problemet e të drejtave të njeriut, korrupsionit, konfliktit të interesave, etj., nuk i plotësojnë kërkesat për një kod të plotë pasi nuk flasin për trajnimin, armët dhe kërkimin e kapjen apo dhe për mënyrën e monitorimit të zbatimit të kodit. Pra, dështojnë në testet e kompletimit dhe zbatimit. Një vërejtje e fundit për nivelin e agjencive është se KPS-të ia akordojnë funksionet e tyre vetërregulluese nivelit të industrisë ose ndryshe shoqatave ku ato janë anëtare duke lënë të kuptohet se ato respektojnë vlerat e këtyre shoqatave.

Një shembull i vetërregullimit në nivelin e industrisë është Shoqata Britanike e Industrisë së Sigurisë (SHBIS), e cila ka marrë masa për inkurajimin e standardeve minimum. SHBIS-

i zhvillon standarde dhe i kalon ata në Institutin Britanik të Standardeve për t'i përcaktuar si Standarde Britanike. SHBIS-i ka marrë drejtimin e hartimit të kodit të etikës për organizatat e rekrutimit të punonjësve të sigurisë. Kodi eliminon praktikën e këqija dhe përcakton kërkime në të kaluarën e kandidatit para punësimit të tij e trajnime vjetore të punonjësve mbi rregulloret e sjelljes.

Me gjithë ekzistencën e këtyre kodeve, mbetet e dyshimtë se në çfarë shkalle ata respektohen dhe se sa efektive janë zbatimi dhe monitorimi. Duke qenë në vullnetin e vetë industrisë zbatimi i kodit, sanksioni më i lartë për mosrespektimin e tij është përjashtimi nga SHBIS-i. Në Britani, Autoriteti i Industrisë së Sigurisë është mandatar për të imponuar zbatimin e ligjit aktual të sigurisë private dhe sanksionet e tij variojnë nga paralajmërime verbale apo me shkrim e deri te fillimi i procedimeve.

Shembull tjetër është dhe monitorimi i sigurisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut nga KPS-të që ruajnë naftësjellësin e British Petroleum (BP) nga Azerbajxhani përmes Gjeorgjisë për në Turqi, i cili bëhet nga një palë e tretë të kontraktuar po nga BP-ja.

7. Rekomandime

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, me qëllim sigurimin e një menaxhimi minimum e të përmirësuar në sektorin e sigurisë private në Evropë dhe përforcimin e kuadrit ligjor si dhe të drejtimit të KE-së, jepen rekomandimet e mëposhtme:

I. Rregullimi i entiteteve që ofrojnë shërbime private sigurie

Harmonizimi i rregullimit të KPS-ve duhet justifikuar jo vetëm me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por dhe me efektivitetin e masave të sigurisë dhe profesionalizmin duke zbatuar rigorozisht normat përkatëse të KE-së.

II. Shqyrtimi i personelit të KPS-ve

Pas verifikimit të identitetit të aplikantëve, duhet të bëhen kontrole për të kaluarën kriminale e profesionale.

III. Kërkesat e pranimit për punonjësit e KPS-ve

Mosha minimale, mospërfshirja në kryerjen e krimeve, uniforma e kartat e identitetit duhet të jenë kërkesat bazë të hyrjes në stafin e KPS-së. Për punonjësit e armatosur duhet gjithashtu trajnimi përkatës. Në lidhje me regjistrat e gjendjes gjyqësore duhet marrë parasysh Rekomandimi R (84) 10.

IV. Licencimi i hetuesve privatë

Përveç pastërtisë së gjendjes gjyqësore, është i nevojshëm një kontroll i së kaluarës, shtetësia, trajnimi apo përvoja si hetues, si dhe kalimi i një provimi me gojë e shkrim. Licencimi duhet të përfshijë dhe një procedurë decertifikimi, pra heqje të licencës së personit apo firmës në raste të caktuara.

V. ‘Moonlighting’

Shtetet duhet të trajtojnë dhe çështjen e punës së punonjësve të policisë part-time në sektorin privat të sigurisë. Aftësitë dhe përvoja e tyre shihen nga biznesi dhe nga kritikët në mënyra të ndryshme në lidhje me atë çka ata i japin KPS-ve.

VI. Trajnimi i personelit të KPS-ve

Standardizimi i trajnimit para dhe gjatë punësimit është i nevojshëm mbi tema si roli i punonjësit, kompetencat dhe kufizimet ligjore, raportimi me shkrim, marrëdhëniet me publikun e klientët, diversiteti, etika e sjellja, menaxhimi i emergjencave, kontrolli i hyrjes, materialet e rrezikshme, etj. Trajnim special duhet dhe për mbikëqyrësit e punonjësve. Të dhënat e plota të trajnimit duhet të futen në dosjen e punonjësit e mund të përdoren në çdo kohë.

Duhet miratuar kode etike, standarde të sjelljes profesionale, identifikimi i kriterëve të pranimit, mekanizma të marrjes e hetimit të ankesave, etj. Kodi i etikës për punonjësit duhet të jetë i ngjashëm, por i veçantë nga kodi për menaxhimin e sigurisë private.

VII. Kufizimet e aktivitetit të punonjësve të KPS-ve

Këto kufizime duhet të jenë qartësisht të përcaktuar në tre drejtime:

- a) Kërkimi e kapja (kërkimi i pronës apo i një personi të dyshuar pa pëlqim paraprak);
- b) Përdorimi i forcës së nevojshme për të ndaluar një person deri në mbërritjen e policisë;
- c) Tipat e armëve të zjarrit që KPS-të mund të mbajnë e si t'i përdorin.

VIII. Marrëdhëniet me policinë

Duhet kërkuar konsensus mbi funksionet që duhet të ketë policia e cilat jo. P.sh. ka një preferencë publike për policinë që të fokusohet në kontrollin e krimit, por kjo i merr policisë më pak se 20% të kohës. Shpesh roli i policisë në transportin e të burgosurve, sigurinë në gjykata, kontrollin e trafikut, fletëthirrjet, shihet si shumë i shtrenjtë në lidhje me buxhetin për sigurinë. Këto mund të realizohen nga KPS-të, por duke përcaktuar qartë rregullat përkatëse. Është i nevojshëm një debat publik mbi mënyrën se si KPS-të mund të jenë komplementare të policisë në punën e përbashkët, shkëmbimin e informacionit, dialogun dhe partneritetin në parandalimin e krimit.

IX. Siguria kundrejt terrorizmit, katastrofave

Shqetësim në rritje është mbrojtja e infrastrukturës kritike. Ndërsa i kushtohet rëndësi bashkëpunimit mes autoriteteve shtetërore, industria private e sigurisë luan rol të madh për shkak të përfshirjes së saj në sigurimin e shumë objekteve

publikë e privatë. Më shumë i duhet mëshuar shkëmbimit të informacionit dhe zhvillimit të përgjigjeve efektive ndaj emergjencave.

X. Jeta private

Në zbatim të Konventave e Rekomandimeve, KPS-të duhet të respektojnë garancitë e duhura të jetës private. Përdorimi i teknologjisë e teknikave të ndryshme mund të prekë jetën private prandaj kërkohet njohja e respektimi i kërkesave ligjore mbi këto praktika.

XI. Vetërregullimi

Ndryshimi i legjislacionit nga një shtet në tjetrin e vështirëson harmonizimin e kuadrit ligjor për industrinë private të sigurisë. Sidoqoftë duhet inkurajuar vetërregullimi si një hap i parë dhe miratimi i kodeve të sjelljes. Këto kode duhet të përfshihen në kontratat e punës bashkë me sanksione përkatëse në rast të mosrespektimit të tyre. Si shembull mund të merren Kodi model i Sjelljes i KE-së për zyrtarët publikë dhe Kodi Evropian i KE-së për Etikën e Policisë. Gjithsesi, vetërregullimi nuk mund të zëvendësojë apo kufizojë të drejtat e shtetasve të KE-së, të parashikuara në ligjet kombëtare e Konventa.

XII. KPS-të ndërkombëtare

Kudoqofshin regjistruar KPS-të, nëse ato veprojnë dhe në shtete të tjera, duhet të respektojnë ligjet e këtyre shteteve si dhe normat e rregullat e KE-së. Është e rëndësishme gësjtja e kontrollit të KPS-ve ndërkombëtare e punonjësve të tyre.

XIII. Përgjegjësia e Korporatës

Si shtetas, punonjësit e KPS-ve janë përgjegjës para ligjit për veprim të tyre kriminal. Edhe KPS-të mund të jenë

përgjegjëse për shkelje të ligjit. Nevoja për forcimin e përgjegjësive të KPS-ve del dhe nga Rekomandimet Nr R (88) 18 e Nr. R (82) 15.

XIV. Miratimi i një kuadri të qartë ligjor dhe i një rregullatori kombëtar

Veprimtaria e KPS-ve duhet të normohet nga një kuadër rregullator që identifikon standarde të qarta dhe bazën ligjore. Një Rregullator Kombëtar duhet të miratohet e caktohet si një autoritet i industrisë së sigurisë duke siguruar transparencë e përgjegjshmëri në sektor. Funkcionet e tij duhet të jenë licencimi, monitorimi, raportimi vjetor, mekanizmat e ankesave të publikut, marrëdhëniet me policinë dhe ndërveprimi me institute të tjera demokratike (Avokati i Popullit dhe Gjyqësori) kudo ku ata ndodhen. Agjencia duhet të bashkëveprojë me komisionet parlamentare, bordet e policisë në komunitet, autoritetet standarde të policisë dhe të bëjë udhëzime publike. Rezultatet e procesit të shqyrtimit duhet të regjistrohen gjithashtu nga kjo agjenci.

Rekomandimi Nr. R (87) 19 mbi organizimin e parandalimit të krimit përmend shprehimisht industrinë private të sigurisë dhe mund të shërbejë si bazë për standarde rregullatorë duke rekomanduar që qeveritë:

a) të miratojnë, rishikojnë a plotësojnë normat që menaxhojnë autorizimin fillestar, licencimin periodik e inspektimin e rregullt në nivelin e duhur nga autoritetet publike të KPS-ve ose t'i inkurajojnë të miratojnë normat e veta;

b) të sigurojnë që personeli i KPS-ve të mbajë uniformë të ndryshme nga ato të policisë, dokumente identiteti dhe të ketë trajnimin e duhur - njohjen bazë të ligjit, teknikat e sigurisë e mbikëqyrjes, të të drejtave, të detyrimeve e përgjegjësive, normat e sjelljes kundrejt publikut;

c) të inkurajojë marrëdhënie të mira mes policisë e KPS-ve me qëllim që këto të fundit, brenda kufijve të veprimtarisë së tyre, të ndihmojnë policinë në parandalimin e krimit.

8. Konkluzione dhe perspektiva

Pavarësisht se deklarohet se KPS-të nuk janë përgjegjëse para ligjit, e kundërta parashikohet në shumë ligje të nivelit evropian, të cilët kontribuojnë në rregullimin e tyre si në çështjet ligjore ashtu edhe në atë të të drejtave të njeriut. Prandaj aty ku ka nevojë për rregullim, duhen miratuar standarde bazë në lidhje me trajnimin, rekrutimin, mbajtjen e armëve, etj.

Ky studim tregoi ndryshimet e nivelit të rregullimit në shtete të ndryshme. Disa nuk kanë ligje të veçanta si Serbia, Qiproja e Franca. Të tjerë zbatojnë kuadrin tregtar si Gjermania e Austria. Mund të ngrihet pyetja nëse ky kuadër tregtar mund të zbatohet plotësisht të KPS-të për shkak të dinamikës së sektorit dhe shqetësimeve të veçanta që lidhen me sigurinë publike e të drejtat e njeriut. Disa shtete të tjera nuk kanë kuadër rregullator kombëtar, por ia lënë rregullimin autoriteteve lokale a kantonale si Zvicra, Italia e Bosnja e Hercegovina. Kjo bën që rregullat e funksionimit dhe zhvillimi i KPS-ve të ndryshojnë brenda vendit.

Përveç Holandës e Spanjës, është e vështirë të identifikosh shtete të tjera me një rregullim të fortë në të gjitha këto aspekte.

Studimi identifikoi shumë dobësi në drejtim të të dhënave të disponueshme mbi KPS-të. Por shpreson të këtë treguar dëshirën për rregullimin e kësaj industrie në shtetet anëtare të KE-së mbi bazë të normave të përbashkëta. Ekzaminimi i fushave të ndryshme të rregulluara dhe mangësive është i mjaftueshëm për të kuptuar nevojën urgjente për rregullim.

Gjithashtu, rekomandimet u bënë për të siguruar një menaxhim më të mirë të këtij sektori në Evropë. Duke njohur diferencat e mëdha të legjislacionit në shtetet e KE-së, sugjerohen hapat e mëposhtëm:

- 1) Praktikak më të mira e standardet ligjore duhet të trajtohen si standarde bazë për sa kohë lidhen direkt me Konventat e KE-së e veçanërisht me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

2) Këto praktika rregullimi duhet të shtrihen dhe në Rekomandimin apo Udhëzimin e KE-së për industrinë private të sigurisë.

3) Ato duhet të publikohen në gjuhë të ndryshme të shteteve të KE-së.

4) Shtetet jo vetëm duhet të inkurajohen të përdorin standardet e praktikat më të mira në ligjin kombëtar, por dhe të promovojnë zbatimin e tyre përmes vetërregullimit të industrisë.

5) Me qëllim ndërgjegjësimit dhe edukimin me normat, sugjerohet mbajtja e seminareve në nivel kombëtar e evropian mbi arritjen dhe nevojën e një menaxhimi e rregullimi sa më të mirë të KPS-ve. Objektiv duhet të jenë politikëbërësit, vendimmarrësit, parlamentarët e stafi i tyre, përfaqësuesit e KPS-ve dhe të shoqërisë civile.

Në përfundim, autorët i shohin strategjitë e rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjen e kapaciteteve dhe përhapjen e përvojave më të mira, si mënyrën e preferuar të transferimit të normave përballë ndryshimit të madh në legjislacionin dhe praktikat e shteteve të KE-së.

Rreth autorëve:

Dr. Hans Born (Holandë) është anëtar bordi i DCAF-it. Ai drejton grupet e punës së DCAF-it për kontrollin parlamentar të sektorit të sigurisë dhe për aspektet ligjore të menaxhimit të këtij sektori.

Marina Caparini është anëtare bordi e DCAF-it.

Eden Cole është nënkryetar i Operacioneve NIS në Divizionin e Operacioneve të DCAF-it.

Kudret Selimaj

DELEGIMI I KOMPETENCAVE NË VEPRIMTARINË DREJTUESE

Disa udhëheqës ose drejtues ndjekin nga afër të gjitha hollësitë e çdo pune apo detyre, për të cilat ata janë përgjegjës, ndërkohë që asnjë çështje, e cila sado shpejt e me efektivitet që ta kryejnë, ata, nuk mund ta përmbushin pothuajse duke mos pasur ndihmë. Funkcionet parësorë për udhëheqësit ose drejtuesit aktualisht konsiderohen planëzimi, organizimi, sigurimi i plotësimit me personel, drejtimi e kontrolli. Në këtë kuadër, për të pasur kohë për të kryer ashtu si duhet detyrat, ata kërkohet t'u delegojnë vartësve disa mbikëqyrje, kontrolle si dhe detyra e kompetenca.

Ndonëse mund të bëjnë një punë më mirë se çdo vartës i tyre, mbikëqyrësit apo kontrolluesit, është e domosdoshme që të kuptojnë e ta bindin veten për kthimin, orientimin (adresimin) apo shpërndarjen e punës te disa persona, të cilët kryejnë një detyrë e përgjegjësi të pranueshme. Përvoja evidencon gjithnjë e më tepër faktin, që nëse udhëheqësit e drejtuesit nuk delegojnë me efektivitet kompetenca e japin detyra, ata janë të prirur drejt një sëmundjeje të ashtuquajtur “valixhet e mbyllura”, që rëndon ngarkesën përtej kohës së nevojshme, për të arritur kryerjen e punëve të mbetura dhe plotësimin e detyrave të tyre përkatëse.

Kur udhëheqësit apo drejtuesit mbeten prapa në punët e tyre dhe përpiqen që ta bëjnë çdo gjë vetë, zakonisht moria e këtyre punëve bëhet stivë e shkon si një ortek gjithnjë në rritje e, kështu ata detyrohen të punojnë më shumë dhe shpejt e shpejt e për një periudhë kohore më të gjatë. Pas një kohe, arrihet një cak ose pikë e përcaktuar, ku sa më rëndë që ata të punojnë, aq më pak efektivë ata do të bëhen. Drejtuesve të të gjitha niveleve u vihen në dispozicion vartësit për të ndihmuar

në përmbushjen e misionit të organizmit (strukturës) dhe ata do të nevojitet t'i përdorin këta (vartësit) sa më me efektivitet që të jetë e mundur.

Delegimi i kompetencave, jo vetëm çliron e lehtëson drejtuesit nga ngarkesa e detyrave të tyre të shumta e të tepërta, por gjithashtu i motivon vartësit për nivele më të larta të realizimit të detyrave. Duke u dhënë rastin dhe mundësinë vartësve për të plotësuar më shumë detyra të ndërthurura e për t'u ngarkuar më shumë punë, **krijohet** më tepër përgjegjësi për veprimtarinë e tyre si dhe jepet më shumë mundësi për të përparuar, mësuar e vetëzhvilluar. Përveç këtyre, vartësit zhvillojnë sensin e pasurimit të përvojës e rritjes profesionale në rastet kur kontrolluesit e mbikëqyrësit janë të vullnetshëm t'u besojnë atyre e t'u lënë në dorë më shumë përgjegjësi, por edhe t'u japin kompetenca shtesë që **rrjedhin** nga këto përgjegjësi.

Disa të dhëna të studimeve që e kanë filluesën në **tiparet karakteristike** të inspektimit të veprimtarisë së ushtrisë e veçanërisht të Forcave Ajrore të SHBA-së, tregojnë se afërsisht 76% e personelit të Forcave Ajrore dëshirojnë një detyrë (punë) me përgjegjësi më të **mëdha**. Delegimi i përshtatshëm i kompetencave nga disa udhëheqës e drejtues të mbingarkuar me punë në Forcat Ajrore, mund të rritë e zgjerojë detyrat e vartësve të tyre dhe të motivojë ata për t'u bërë më të efektshëm e të jenë realizues e drejtues më veprues e rezultativë. Kjo do të mund të arrijë rezultate në qëndrueshmërinë dhe aktivizimin e më shumë njerëzve sidomos atyre të rinj e të talentuar të strukturave të Forcave Ajrore. Gjithashtu, në mjaft ushtri të vendeve të zhvilluara, madje edhe Ushtria e SHBA-së, ka probleme të tilla të qëndrueshmërisë e aktivizimit të rekrutimit të personelit dhe po mendohet për nevojën e sigurimit të më shumë detyrave e posteve më sfiduese e tërheqëse për efektivin. Këtu theksohet: “më e mira dhe më shkëlqyera e oficerëve të rinj do të mbetet të jenë me shërbim vetëm në qoftë se ata thirren (rekrutohen) për detyrat respektive, të përshtatshme, të cilat aktualisht kërkojnë talentin e tyre.” Asgjë nuk është më motivuese sesa dhënia e detyrave të rëndësishme dhe kompetencave e mundësive njerëzve, për

të marrë vendime, të cilat shprehin sukses ose dështim dhe që motivojnë, nderojnë e shpërblejnë ata për plotësimin e detyrave.

Nga ana tjetër, delegimi i efektshëm i kompetencave është mjaft i rëndësishëm në përgatitjen, zhvillimin e përparimin e drejtuesve me të vërtetë të aftë. Mungesa, dështimi ose pamjaftueshmëria e dhënies së kompetencave shkakton një pakësim e prirje në rënie të njerëzve që përgatiten e janë të gatshëm që të ndërmarrin përgjegjësi më të mëdha. Mungesa e delegimit të këtyre kompetencave bën që kontrolluesit kryesorë të jenë kaq të mbingarkuar me detyrat e përditshme rutinë e të pamënaxhueshme, saqë nuk mund të plotësohen si duhet planëzimi, mbikëqyrja (kontrolli), përgatitja dhe përgjegjësitë e tjera të drejtuesit. Ajo kufizon marrjen e vendimit në vetëm pak njerëz dhe **përrjashton** e humbet kapacitetet e të tjerëve, të cilët në fakt mund të jenë drejtues dhe kontrollues potencialë.

Zhvillimi i udhëheqësve e drejtuesve është i rëndësishëm veçanërisht për strukturat e Forcave të Armatosura, për shkak të ndryshimeve të ndjeshme e të qarkullimit të shpeshtë të personelit në përgjegjësitë funksionale kontrolluese, drejtuese dhe udhëheqëse.

Në qoftë se individëve nuk u jepen kurrë kompetenca ose autoritet për të marrë vetë vendim, organizmi ose struktura priret të ketë shqetësime. Prandaj, delegimi i kompetencave rrit fuqinë luftarake të një organizmi (strukture), duke siguruar elasticitet, **thellim** e logjikë profesionale me anë të përpunimit e zhvillimit të zgjidhjeve e zbulimit të rezervave, nëpërmjet zëvendësve të drejtuesve e të zëvendësimeve të personelit në tërësi.

Udhëheqësit e drejtuesit, të cilët zhvillojnë ashtu si duhet e natyrshëm autoritetin dhe përgjegjësitë, evidencojnë e krijojnë bindjen se organizmat (strukturat) e tyre mund të funksionojnë vetë madje, me një kontroll fare të vogël. Në qoftë se udhëheqësit apo drejtuesit njohin detyrën e tyre dhe u japin kompetencë vartësve për të marrë vendime në përmbushjen e detyrave të tyre përkatëse funksionale dhe përgjegjësi, atëherë ata udhëheqin e drejtojnë me aftësi të

larta në fushën respektive. Madje edhe në situatat kur drejtuesi gjendet larg nga puna (nuk është prezent fizikisht) për një periudhë kohore të gjatë, operacionet dhe veprimtaritë e kryera në vijim të organizmit përkatës nuk paraqesin probleme. Kështu, nëpërmjet delegimit të efektshëm të kompetencave, drejtuesit mund të krijojnë, veç të tjerash, një mjedis të mirëkuptimit e besimit reciprok, i cili e bën më të lehtë kontrollin organizativ ose strukturor. Nga ana tjetër, ata do të mund të kenë gjithashtu, më tepër kohë për funksione të tjera thelbësore udhëheqëse ose drejtuese. Kur ndodh (kryhet) delegimi me efektivitet i kompetencave arrihen përfitime të rëndësishme për udhëheqësit, drejtuesit si dhe organizmat (strukturat) ushtarake të shumëllojshme.

Në parashtrësë (sintezë) të dobisë e përfitimeve të delegimit të kompetencave, theksohet fakti që konstatohet se kur udhëheqësit ose drejtuesit kanë deleguar si duhet kompetencat rezultojnë efekte pozitive të tilla: (1) efektiviteti dhe plotësimi i detyrave shumëfishohet; (2) rezultatet janë më të shpejta dhe ekonomike (racionale); dhe (3) shtabi (stafi) është më i motivuar dhe më i vetëbesueshëm. Këto mund të materializohen duke njohur e depërtuar në parimet bazë të delegimit të kompetencave, disa prej të cilave synohet të trajtohen më poshtë.

Shumë praktika të delegimit të kompetencave janë bërë kaq të ndërtuara e organizuara mirë saqë tashmë, ato kanë qartësuar, përcaktuar e konfiguruar parimet e këtij delegimi. Autorë të ndryshëm kanë përgatitur dhe paraqitur e parashtruar lista përkatëse të veçanta të parimeve më të përgjithshme të delegimit, me argumente dhe përcaktime e terma, që nuk kanë ndonjë dallim të rëndësishëm midis tyre. Në këtë kontekst përfundohet në përmbledhjen e parimeve të delegimit të kompetencave, që gjendet në literaturën aktuale për çështjet e udhëheqjes e të drejtimit në tërësi.

Këto parime mund të shërbejnë si orientime, udhëzime apo instruksione për udhëheqësit e drejtuesit, të cilët dëshirojnë të zhvillojnë mënyrat më të efektshme të delegimit të kompetencave. Ndër më kryesoret nënvizohen mosdelegimi i përgjegjësisë, domosdoshmëria e balancimit të kompetencave

me përgjegjësitë, krijimi i unifikimit të komandimit, çështja se çfarë duhet deleguar dhe masa e këtij delegimi, përgatitja e vartësve për delegim (dhënie) të kompetencave, qartësia e komunikimit si dhe kontrolli i delegimit të kompetencave.

Përgjegjësia nuk mund të delegohet. Përgjegjësia është detyrimi i zotëruar nga një kontrollues (mbikëqyrës) i drejtpërdrejtë për kryerjen e mjaftueshme ose të kënaqshme të detyrave të përcaktuara (paracaktuara). Çdo kontrollues a mbikëqyrës është përgjegjës para autoritetit më të lartë për të përmbushur disa pjesë të misionit të plotë të organizmit strukturor, por veçse kështu përgjegjësia kurrë nuk mund të transferohet ose ridelegohet (të jepet) për vartësit. Megjithëse drejtuesit ose kontrolluesit caktojnë një pjesë të detyrave të tyre për vartësit, këta të fundit janë përgjegjës për rezultatet e arritjet vetëm tek eprorët (drejtuesit) e tyre. Ndërkohë, nga ana tjetër, drejtuesit apo kontrolluesit me radhë janë përgjegjës te drejtuesit (eprorët) më të lartë përkatës të tyre. Kështu p.sh. një komandant skuadriljeje në strukturat e trupave ajrore mund të delegojë detyra të planëzimit të ekuipazhit (të aeroplanit) te shefi i tij i planëzimit. Shefi i planëzimit kryen veprimtaritë e tij në përputhje me fushën e funksionit dhe përgjegjësitë. Komandanti i skuadriljes, porsa merr detyrat më të fundit, duhet të përgjigjet te komandanti i njësisë apo Krahut Ajror kur ndodh si dhe jep efekte një gabim planëzimi, i cili ka ndikim në vetë misionin e Krahut Ajror. Këto e të tjera argumentojnë faktin që eprorët apo superiorët nuk mund ta lirojnë e, ca më pak, ta përjashtojnë veten nga detyrimi përkatës dhe nga asnjë pjesë e përgjegjësisë fillestare (para delegimit të kompetencave të tyre te vartësit); delegimi veçse lejon për dikë tjetër që të bëjë punën në një kohë të caktuar. Pra, përgjegjësia nuk mund të delegohet.

Kompetencat duhet të jenë të balancuara e të barazojnë përgjegjësinë. Ideja që kompetencat dhe përgjegjësia të jenë të balancuara (të barabarta) është një tjetër nga parimet e njohura gjerësisht të dhënies së kompetencave ose të delegimit të tyre. Siç u paraqit paraprakisht, të tre aspektet e dhënies (së delegimit të kompetencave), detyrat, kompetencat dhe përgjegjësia janë të pandashme. Prandaj, delegimi i

detyrave nga drejtuesi ndodh vetëm në qoftë se vartësit i garantohen kompetenca të mjaftueshme që të plotësojë përgjegjësitë në mënyrë të kënaqshme. Vartësve, të cilëve u caktohen përgjegjësi pa kompetencat (autoritetin) e mjaftueshme, janë në pozita fatkeqe e të dështuara, të të qenit të paafte për të bërë shfrytëzimin e duhur të burimeve (rezervave) që nevojiten, për të përmbushur detyrat e tyre. Në gjendje të tilla atyre u mungojnë mjetet me anën e së cilave të mund të bëjnë efektive idetë dhe veprimet e tyre në radhët e njerëzve (efektivave) të tjerë.

Kur kontrolluesit apo mbikëqyrësit u japin detyra e ngarkojnë me punë të tjerë persona, ata duhet të sigurohen që u kanë dhënë këtyre kompetencat e mjaftueshme (autoritetin e nevojshëm) për t'i zbatuar ato, ose përndryshe vartësit do të kthehen të kërkojnë pafundësisht (pa mbarim) miratim për të kryer çdo veprim e për të vijuar detyrat. Në të tilla pozita e kushte vartësit ushtrojnë e praktikojnë dështimin e planeve e do të zhgënjehen, veprime të cilat i dekurajojnë e dëshpërojnë e pastaj shkatërrojnë prirjen e tyre (eporëve) për të treguar besueshmëri ndaj organizmit (strukturës) ushtarak. Përveç këtyre, ndjenja e përgjegjësisë e vartësve për sukses në projektin e bërë ose planin e hartuar do të zvogëlohet dhe kështu në këto rrethana, përgjegjësia e tillë e drejtuesit (udhëheqësit) për këtë projekt (detyrë) përfundimisht do të **shfaqet** hapur.

Në këtë çështje, udhëheqësi ose drejtuesi, për t'ia dalë mbanë, ka disa zgjidhje: të delegojë kompetencat që kërkohen për të plotësuar në mënyrë të kënaqshme detyrën; të caktojë saktë detyrën për dikë tjetër; ose ta plotësojë vetë projektin apo planin e paraqitur. Çfarëdo zgjidhjeje që të përzgjedhin e gjejnë drejtuesit, përsëri do të arrijë e gjendet në menaxhimin e krizës dhe rezultati përfundimtar do të jetë padyshim i ulët, lidhur me ato që janë arritur, në qoftë se ata kanë deleguar (dhënë) kompetenca të pamjaftueshme kur kanë caktuar fillimisht detyrat.

Krijimi i unifikimit të komandimit. Kur kryejnë delegimin e kompetencave udhëheqësit ose drejtuesit është e domosdoshme të sigurojnë unitetin e komandimit. Me fjalë të tjera, një anëtar i organizimit (strukturës) zakonisht do të

mund të jetë përgjegjës vetëm te një epror (superior) i drejtpërdrejtë, pra ka një drejtues për vartësin (të punësuarin). Kur paraqitet një situatë e tillë rezultati është i bashkërenduar mirë, ka një kuptim të qartë të kompetencave e përgjegjësi dhe përmirësohet ndjeshëm disiplina.

Në qoftë se vartësit kanë dy ose më shumë drejtues (eprorë) rritet mundësia e urdhrave kontradiktorë ose e konfliktit të përparësive. Përveç faktit që vartësit do të ndodhë të jenë të paaftë të vendosin se cilët urdhra do të duhet të shtyjnë në kohë dhe cilëve t'u binden menjëherë, ata (vartësit), duke pasur drejtues të dyfishtë, ka të ngjarë të shkojnë drejt prishjes së planeve, në dështime e në një gjendje morale të ulët. Kësisoj, vartësit sado të ndërgjegjshëm qofshin, do të zhgënjehen e pengohen në zbatimin e detyrave, ndonëse jetojnë e veprojnë sipas të gjitha parimeve për të cilat **pritet**; vartësit duke u bërë indiferentë do të kufizojnë, venitin e ndërpresin përpjekjet, sapo ata paraprakisht nuk mund të bëjnë të tëra ato që janë kërkuar dhe të gjithë ata së shpejti ose vonë do të qortohen për dështimin për t'u bindur urdhrave.

Megjithëse relativisht është e mundur për një vartës të pranojë e marrë kompetenca nga dy ose më shumë eprorë dhe të mbajë përgjegjësi para tyre (eprorëve), siç është rasti në një organizim matricë (ky organizim paraqet një formë të veçantë të sistemit funksional apo shumëlinear me dy linja, në të cilin kompetencat e dy linjave pothuajse janë të të njëjtit rang), disa herë kontrolli është i vështirë, madje edhe për udhëheqësit e drejtuesit që konsiderohen më të mprehtë, kompetentë e me përvojë më të madhe. Për më gjerë, është edhe një shprehje në Bibël ku theksohet se një njeri nuk mund t'u shërbejë mirë dy pronarëve dhe kjo sigurisht është e qëndron e vërtetë në qytetërimin tonë modern.

Mbajtja parasysht e kujdesit se çfarë të delegosh. Çështja më e vështirë e delegimit të suksesshëm është njohja e sasisë (masës) së përgjegjësisë dhe e kompetencave që delegohen. Arsyeja themelore për përdorimin e delegimit të kompetencave është të mënjanohen e pakësohen hollësitë e vogëlsitë dhe ngarkesa e panevojshme e punës që nga një pikëpamje tjetër drejtuesit do të duhej t'i përballonin vetë. Kur

vëllimi i punës është shumë i madh për ata, për ta kryer e për ta përbulluar vetë, ata mund të delegojnë kompetenca dhe caktojnë përgjegjësi, të cilat përcaktohen e përmbajnë detyra e funksione për t'u plotësuar nga vartësit. Kjo trajtohet e paraqet një rast e mundësi më shumë për të ndërtuar një organizëm (strukturë) të përbërë nga njerëz, të cilët mund të zbatojnë detyra të specializuara e të veçanta, për të cilat udhëheqësit e drejtuesit ose nuk janë kompetentë, ose relativisht nuk kanë kohë t'i realizojnë ato.

Për të udhëzuar e orientuar më qartë eprorët në përcaktimin se cilat detyra apo punë të delegohen dhe cilat të mbahen, sipas analistëve në këtë fushë, në tërësi merren në konsideratë disa orientime të përgjithshme:

Së pari, çështjet që do të trajtohen e lihen në kompetencë të hallkave poshtë, brenda linjës së komandimit, është e domosdoshme të mund të delegohen ashtu siç duhet.

Së dyti, në qoftë se është në dispozicion dhe i vlefshëm i gjithë informacioni i nevojshëm për marrjen e vendimit në hallkat komanduese e drejtuese më të ulëta, do të mbahet parasysh që të jepen mendime e gjykime për të deleguar çështjet e caktuara.

Së treti, sa më tepër këto çështje përmbajnë të dhëna operacionale të hollësishme, të cilat nuk përputhen e ndryshojnë dukshëm, krahasuar me planëzimin dhe organizmin (strukturën), aq më shumë çështje do të diktohen e duhet të jepen për delegim.

Së katërti, çështjet unike e të vetme për eprorin ose detyrën e tij nuk do të delegohen. Kontrolluesit dhe mbikëqyrësit në të gjitha nivelet kërkohet të delegojnë kompetenca për të marrë vendime që mund të realizohen më mirë dhe si duhet nga vartësit. Kjo u lejon e mundëson kontrolluesve që të përqendrojnë përpjekjet në aspektet vendimtarë e kritikë të pozitës (funksionit) të tyre si, planëzimi, drejtimi dhe kontrolli. Ato se çka mund të delegohen janë elementë përbërës më të vegjël, më të pakët dhe të hollësishëm e pjesë përbërëse të përgjegjësive të mëdha. Këto detyra është e domosdoshme t'u caktohen vartësve edhe sikur kontrolluesit mund të jenë në gjendje t'i kryejnë ato më mirë vetë.

Gjithsesi, kontrolluesit nevojitet të jenë të kujdesshëm për të shmangur dhënien vetëm të detyrave të rëndomta, të papërfillshme e të mërzitshme për vartësit, sepse kjo shkurajon shpejt veçanërisht vartësit energjikë dhe do të përjashtojë, mohojë, humbasë e nuk do të justifikojë përfitimet e delegimit të kompetencave. Bashkë me detyrat jointerese, monotone e jotërheqëse, kontrolluesit do të duhet të caktojnë punë që janë mobilizuese, të larmishme e sfiduese. Caktimi i detyrave sa më të larmishme e sfiduese krijon e ofron përgjegjësi e mundësi për vartësit që këta të zhvillohen dhe të mësojnë e ushtrohen më tej.

Disa autorë të botimeve të ndryshme në këtë fushë paralajmërojnë se vartësit thjesht janë të ndrojtur e të frikësuar nga përgjegjësitë dhe kjo përbën një kërcënim, i cili prish dhe pengon ato. Kështu, është mjaft e rëndësishme për eprorët që të njohin njerëzit, vartësit e tyre dhe të kuptojnë e vlerësojnë aftësitë (kapacitetet) e tyre për të marrë e mbajtur më shumë përgjegjësi. Gjithashtu ata kërkohet të realizojnë e arrijnë që kapacitetet apo aftësitë e një vartësi për përgjegjësi të tjera të mund të shtrihen e zgjerohen nëpërmjet stërvitjes dhe përgatitjes së mjaftueshme. Kjo përgatitje merr e zë shumë nga koha e drejtuesit, por do të provohet se është patjetër e dobishme në një rrjedhë të gjatë të veprimtarisë drejtuese.

Përgatitja e vartësve për delegim të kompetencave.

Përgatitja e vartësve për të pranuar përgjegjësi dhe kompetenca plotësuese është një nga funksionet e detyrat më të rëndësishme të drejtuesve e kontrolluesve (mbikëqyrësve). Kontrolluesit duhet jo vetëm të stërvitin e ushtrojnë vartësit për të kryer më shumë detyra të ndërlikuara, por ata kërkohet të krijojnë edhe një mjedis që nxit e përkrah vartësit e personelin në tërësi, për të provuar rrugë e mënyra të reja, të pranojnë e marrin përsipër disa rreziqe, për të marrë vendime dhe të shfaqin aftësitë e tyre intelektuale e profesionale të gjithanshme.

Udhëheqësit e drejtuesit është e nevojshme të shmangin delegimin e kompetencave **derisa** të krijohet mundësia që të sigurohen se ata që marrin kompetencat njohin si t'i përdorin e ushtrojnë ato. Një nga mënyrat e metodat më rezultative

për të vlerësuar aftësitë e vartësve është t'i tërheqësh e aktivizosh ata në një shumëllojshmëri të delegimit të shpejtë e të **shpeshtë**. Këto përgjegjësi të **shpejta** e të **përmbledhura** (të ngjeshura) kërkojnë e kanë pasojë rrezikun më të pakët për organizmin (strukturën) dhe ato i lejojnë kontrolluesit të përcaktojnë nëse individët janë të aftë për marrjen e përgjegjësisë shtesë.

Ndërsa bëjnë delegimin e kompetencave mbi baza graduale e metodologjike, kontrolluesit duhet të verifikojnë e kontrollojnë vartësit në vijimësi për t'iu përgjigjur çështjeve (rubrikave) e **pyetjeve** të tyre dhe t'u kultivojnë e rrënjosin atyre vetëbesimin që u nevojitet. Mbi të gjitha, drejtuesit e kontrolluesit është e domosdoshme të jenë të përmbajtur e të duruar ndaj gabimeve dhe t'i ndihmojnë personat që delegohen me kompetenca, të rifitojnë, forcojnë e të ripërtëritin (gjenerojnë) pozitat, në mënyrë të favorshme në rastet e gabimeve të mëdha. Kur bëhen gabime, është e këshillueshme konsultimi e ripërgatitja, me qëllim që t'i ndihmojnë vartësit të kuptojnë se cilat korrigjime janë të nevojshme dhe të sigurohen se interesi më i mirë i organizmit (strukturës) është të **jesh** në shërbim të pandërprerë të saj.

Siç nënkuptohet, hapi më i rëndësishëm në përgatitjen e vartësve për delegim të kompetencave është ai i motivimit. Vartësit do të punojnë edhe më shumë kur ata do të mund të bëjnë detyra që dëshirojnë vetë t'i kryejnë. Gjatë delegimit të kompetencave, eprorët është e domosdoshme të theksojnë rëndësinë e detyrave të deleguara e gjithashtu, pandashmërisht, edhe rëndësinë që ato kanë për vartësit. Kështu është e arsyeshme se kur kontrolluesit (supervizorët) caktojnë e japin kompetenca dhe përgjegjësi, ata do të nevojitet të mendojnë jo vetëm në lidhje me detyrat (punët) e shkarkuara dhe shkallëzimin e ndarjes së **përgjegjësive** (kompetencave), por gjithashtu edhe për zhvillimin e gjendjes (statusit) së nismës të vartësve të tyre.

Të komunikuarit qartë. Komunikimi është një element mjaft i rëndësishëm në procesin e delegimit të kompetencave. Shpërndarja e shtrirja e përgjegjësive dhe e kompetencave në të gjithë organizmin (strukturën) nuk ndodh automatikisht e

në mënyrë të menjëhershme, prandaj komunikimi është mjeti a mënyra me anën e të cilëve përmbushet akti i delegimit. Komunikimi që përdoret për delegim mund të jetë ose në formën e shkruar apo atë gojore, ose zakonisht mund të praktikohet ndërthurja e këtyre dy formave.

Është me rëndësi jetike për praktikantët më të mira e të efektshme organizative (strukurore) që marrëdhëniet ndërmjet eprorëve dhe vartësve, midis të barabartëve në vija paralele dhe në mes drejtorive, degëve (seksioneve) të përkufizohen me mprehtësi e të kuptohen qartë. Kur këto lidhje (marrëdhënie) janë të papërcaktuara drejt e të paqarta, ka më shumë mundësi për ngatërresa e mosmarrëveshje, grindje, konflikte dhe pakujdesi e mospërfillje brenda organizmit (strukturës). Ngatërresat, mosmarrëveshjet e konfliktet rriten kur përputhen, dublohen apo mbulojnë pjesërisht njëra-tjetrën kompetencat e përgjegjësive të dy ose më shumë individëve (personave) apo grupeve. Kur keqkuptohet ose harrohet e nuk mbahen në konsideratë një delegim (dhënie) i caktuar i kompetencave nga përfaqësuesi i personi që delegon (jep) kompetenca, atëherë do të ndodhin pakujdesi, lënie pas dore e braktisje. Delegimet (dhëniet) e veçanta me shkrim të kompetencave dhe rishikimi i përgjegjësive mund të mënjanojnë mjaft nga problemet e mësipërme. Në formën e shkruar, delegimi i kompetencave është i mundshëm të jetë më pak i dykuptimshëm dhe zvogëlon gjasat e shtrembërimeve ose abuzimeve nga vartësit.

Megjithatë, është argumentuar se delegimi i veçantë me shkrim i kompetencave, në **disa** raste ndrydh elasticitetin e vartësve. **Disa** autorë e vlerësojnë se ky problem mund të zgjidhet duke riorganizuar e ndryshuar shpesh delegimin me shkrim të kompetencave. Kjo do të çojë në mënyrë periodike në përmirësimin e delegimit të kompetencave, pasurimin dhe shtimin e detyrave të vartësve dhe sigurimin e plotësisht normal të objektivave. Analistë e autorë të tjerë arsyetojnë se fusha (sfera) kryesore e gjerë dhe e plotë e kompetencave dhe përgjegjësisë duhet të hidhet në letër (pra, të shkruhet) dhe se ndryshimet e rëndësishme e alternimi (këmbimi) i përkohshëm bëhen në formën e udhëzimeve e të orientimeve

gojorë. Nëse delegimet e kompetencave bëhen gojarisht ose në formën e shkruar, eprorët kërkojnë të kuptojnë rëndësinë më të madhe të qartësisë së mjaftueshme e të nevojshme të kompetencave dhe të përgjegjësisë. Në qoftë se vartësit nuk janë të qartë për kompetencat e tyre, aftësia e tyre për të vepruar dobësohet. Pamjaftueshmëria dhe dështimi për të vepruar mund të rritë ngadalësimin e punës të organizmit (strukturës) e të shkaktojë krijimin dhe shtimin e problemeve.

Për të ndihmuar eprorët në qartësimin e kompetencave e të përgjegjësive brenda organizmit (strukturës) së tyre ka një numër teknikash (metodash) e procedurash. Dy nga teknikat më të përhapura dhe të ushtruarat më dendur janë përdorimi e shfrytëzimi i skemave e diagrameve të strukturës dhe përshkrimet e detyrës.

Në mjaft vende si dhe në SHBA përdor e praktikon skemat e strukturave në mënyrë mjaft të zgjeruar për të sqaruar e qartësuar (përcaktuar) linjat (vijat) zyrtare të kompetencave dhe të fushës së përgjegjësisë brenda strukturave. Megjithatë, siç rezulton nga përvoja, vetëm skema e strukturës është e pamjaftueshme si një mjet apo mekanizëm i delegimit të kompetencave. Ajo pasqyron titujt (paragrafët) që janë përcaktuar si dhe shkallën e delegimit të kompetencave brenda strukturës. Edhe sikur një komandant të krijojë e ngrejë shtabe, drejtori a degë, të vendosë shefa degësh (sektorësh) dhe të qartësojë e thjeshtësojë skemën e strukturës, përsëri nuk do të mund të kryhet delegimi i kompetencave, madje edhe në qoftë se drejtuesi a komandanti bën përpjekje për të gjitha çështjet e rëndësishme në këto drejtori, degë apo sektorë.

Për të plotësuar skemën e organizmit (strukturës), shpesh përdoren përshkrimet e detyrave, me qëllim që të dokumentohen përgjegjësitë dhe kompetencat. Përshkrimet e përgjegjësive funksionale arrihen nëpërmjet procedurave të analizës së detyrave dhe sigurojnë një vlerësim në trajtë të **shkruar** e zyrtare të detyrave (kërkesave), që përshihen në përshkrimin e funksioneve si dhe të lidhjeve e raporteve të funksioneve e detyrave me funksione të tjerë. Përshkrimet e sakta e të plota të detyrave funksionale informojnë personat e caktuar me përgjegjësitë e caktuara si dhe personat e tjerë për atë se çfarë mendohet të kryejnë ata për

kompetencat që kanë dhe ndihmojnë në përcaktimin se çfarë kompetencash do të delegohen (jepen), me qëllim që të veprohet sipas fushave të funksionit.

Kontrolli i delegimit të kompetencave. Kontrolli bëhet i domosdoshëm e i pashmangshëm kurdoherë që udhëheqësit e drejtuesit delegojnë (japin) kompetenca për vartësit sepse ata nuk mund të delegojnë në mënyrë të sigurt e pastaj arrihet që të shfaqen **ndryshime** të konsiderueshme, kapërcime, shndërrime e përjashtime dhe nuk mbahet parasysh se çfarë ndodh. Përgjegjësitë e udhëheqësve e të drejtuesve te eprorët përkatës të tyre nuk zvogëlohen si rezultat i një pjese të kompetencave që delegohen (jepen) për vartësit. Prandaj është detyrë që merret përsipër nga udhëheqësit e drejtuesit, të cilët delegojnë kompetenca për të ushtruar kontroll mbi veprimtaritë e deleguara. Qëllimi i kontrollit është të sigurojë që realizimi i kompetencave të përputhet me planet. Kjo do të thotë të krahasohen rezultatet me standardet e vlerësuara dhe të paraqiten masat korrigjuese, nëse është e nevojshme.

Baza e kontrollit është informacioni në duart e udhëheqësit a drejtuesit. Prandaj që të kontrollosh ashtu siç duhet, është e domosdoshme të krijohet ose ngrihet një sistem raportimi i përshtatshëm. Sistemi i raportimit që përdoret është i varur në një shkallë mjaft të lartë (relativisht të madhe) nga situata, por sistemi i raportimit më i përdorshëm, përgjithësisht përfshin një ndërthurje të raporteve të zakonshëm (rutinë) statistikore, të raporteve specialë (të veçantë), të raporteve gojorë nga ai që **delegohet** dhe raportet me zë (biseda) ose takimet personale me atë që delegohet. Takimi personal është metoda më e rëndësishme e grumbullimit të informacionit. Këto takime janë të paplanëzuara, në trajtën e vizitave jozyrtare, pa kryer inspektive në vendin e punës të vartësve. Vizitat e llojit “ç’po bëhet?” (ç’kemi?), zakonisht janë mjaft nxitëse e motivuese për vartësit, sepse ato tregojnë se drejtuesi ka interes, si për vetë vartësit ashtu edhe për punët (detyrat) e tyre. Këto vizita gjithashtu japin mundësi për këshillime, konsulta, për kontrollin në heshtje si dhe e bëjnë **atë** të mundur për eprorin që të zbulojë, kapë e trajtojë sa më herët gabimet serioze e më të ndjeshme.

Sidoqoftë, udhëheqësit e drejtuesit duhet të shmangin mbikontrollin. Një numër jashtë mase i vizitave, i raporteve dhe i mbledhjeve tregon mungesë të besimit te vartësit. Në qoftë se kontrolli është shumë i rreptë e rigoroz ose mjaft i theksuar, ai mohon delegimin e kompetencave, sepse vartësit nuk do t'i kënaqë për një kohë të gjatë liria për të vendosur ose vepruar vetë. Vartësit mund të bëhen më të interesuar në shmangien e shqetësimeve se sa në kryerjen e detyrave, kështu që, ata do të raportojnë vetëm se çfarë mendojnë ata se do të dëshirojë të dëgjojë eprori. Si rezultat, problemet mbeten të pavërejtura, të pavëzhguara e të panjohura ndërkohë që do të jetë shumë vonë. Në të tilla raste, organizmi ose struktura do të ketë shqetësime.

Nga ana tjetër, pamjaftueshmëria e kontrolleve dhe nënvleftësimi i tyre mund të jetë një problem serioz, sepse **lë** rrugë të hapur për gabime të rënda e me pasoja dhe i bën vartësit që të kuptojnë e ndjejnë se ata nuk po përfillen dhe se në fakt po **in** jorohen. Në qoftë se drejtuesi nuk shfaq interes për punët e detyrat e vartësve, këta të fundit do të fillojnë të kuptojnë se detyrat e tyre paraqiten pa ndonjë vlerë e nuk janë shumë të rëndësishme për organizmin (strukturën). Si rrjedhojë, vartësit humbasin interesin për punën e tyre, bie frytshmëria e veprimtarive, rriten të larguarit (shmangiet) prej saj e mungesat dhe krijohen probleme për strukturën organizative.

Kështu pra, ka rreziqe si në kontrollin e tepruar (mbikontrollin), ashtu edhe në nënvleftësimin e rolit të tij. Lind pyetja: - Sa kontroll është i mjaftueshëm? Ashtu siç mund të mendohet e gjykohet, për këtë pyetje nuk gjendet e ekziston vetëm një përgjigje të vetme e të saktë. Gjithsesi autorë e specialistë të ndryshëm ofrojnë disa argumente e këshillime, të cilat mund të provojnë e vërtetojnë se janë të dobishme e të përdorshme për situatat më të **menaxhu**eshme. Numri i kontrolleve që ushtrohen duhet të kufizohet në sasinë minimale që kërkohet me qëllim që: (1) Të operohet si një sistem i paralajmërimit të largët, që lejon veprim të ndreqshëm e të korrigjueshëm e që të mund të ndërmerret për problemet kryesore, ndërkohë që ka akoma kohë për të kryer veprime.

(2) Të sigurohet ndihmë për vartësin përpara se ai të merret me problemet kryesore dhe ky i fundit të bëjë përpjekje t'i përballojë, mposhtë e zgjidhë vetë ato.

Këto këshillime e orientime venë theksin në problemet kryesore që do të duhet të jenë e përbëjnë të vetmen detyrë e angazhim për udhëheqësit ose drejtuesit. Njerëzit apo efektivat e strukturave organike kanë mjaft se çfarë të mësojnë nga gabimet e tyre, kështu që rregulli (mënyra) më i mirë dhe efektiv është që të lejosh vartësit për të bërë gabime të vogla, por edhe t'i ndalosh ata nga bërja e gabimeve të mëdha.

Në rastin e ndalimit (parandalimit) të vartësve nga bërja e gabimeve trashanike, eprorët do të duhet të shpjegojnë përse veprimi i propozuar (i paraqitur) do të mund të kishte qenë i gabuar. Kjo mënyrë i jep rastin vartësit të mësojë nga gabimet e që të mos i bëjnë më përsëri ato të kryera më parë. Vlera e vërtetë e kontrollit nuk është t'i ngacmojë, përbuzë apo t'i denigrojë vartësit për gabimet e kryera ose t'i çorientojë, t'i zërë ngushtë e verë në pozitë të vështirë, t'u sjellë atyre ngatërresa e t'i pengojë; ata (kontrollët) organizohen e realizohen duke motivuar e nxitur vartësit që të veprojnë e të arrijnë më të mirën për të ardhmen.

Porsa vartësit të arrijnë të bëhen më të ushtruar e me përvojë të zgjeruar e vetëveprues, kontrollët (e delegimit të kompetencave) mund të lehtësohen, sepse ka pak raste e gjasa të gabimeve të rënda dhe ata mund të besohen me më tepër liri të veprimit (nga eprori). Prandaj sasia (masa) e kontrollit të nevojshëm është në varësi të faktorëve të tillë, si aftësia, mjeshtëria, pikëpamjet e qëndrimi i vartësve si dhe nga kapaciteti e zotësia e udhëheqësve e drejtuesve në trajtimin dhe vlerësimin e interpretimin e të dhënave të marra e atyre të raportuara nga vartësit.

Vënia në zbatim e këtyre koncepteve të përgjithshme të delegimit të kompetencave është shumë larg e nuk ka asgjë të përbashkët me veprimet, procedurat apo metodat mekanike. Ajo kërkon një kuptim të mprehtë, të depërtohet në thelbin e çështjeve e një qëndrim energjik të njerëzve (personelit të strukturës organike) si dhe një perceptim e vlerësim të saktë të kufizimeve të tyre. Gjithsesi, menjëherë sapo arrihet kjo,

delegimi i mirë (i kompetencave) u jep mundësinë udhëheqësve e drejtuesve për të ndaluar e frenuar shqetësimet për probleme të vogla e të parëndësishme sa duhet, për t'iu kthyer më mirë detyrave të një planëzimi dhe drejtimi me krijimtari. Ky delegim i stimulon ata gjithashtu për organizim dinamik, të gjallë e në rritje si dhe për njohuri që të arrijnë standarde të larta profesionale.

Këtu meriton të nënvizohet edhe një faktor tjetër. Ndryshimi shumë i shpejtë dhe i shpeshtë i situatave në operacionet ushtarake, luftarake e joluftarake në kushtet e sotme, vështirësitë relative të identifikimit të pikave vendimtare e të përqendrimit të fuqisë luftarake në vendin e kohën e duhur, si dhe të rrethanave e faktorëve të tjerë, shtojnë domosdoshmërinë e drejtimit me mision. Duke evidencuar gjithnjë e më tepër vlerat e një parimi të tillë udhëheqës në procesin e komandimit e kontrollit, theks të veçantë merr delegimi i kompetencave ushtarake dhe ushtrimi i kërkesave që rrjedhin prej tij. Kjo është e pandashme nga përgjegjësia e një komandanti për përmbushjen e misionit. Nëpërmjet delegimit, komandanti zhvillon e gjeneron lirinë e veprimit të vartësve, veçanërisht që këta të veprojnë efektivisht në situata të paparashikuara e sidomos të shfrytëzojnë rastet e favorshme. Kjo mundëson nxitjen dhe shtimin e nismës e, për më tepër, realizimin e vendimmarrjes në kohë gjatë gjithë ecurisë së operacioneve.

Në përmbyllje të kësaj trajtесе, konkludohet se në organizma strukturorë (struktura) të suksesshme, delegimet e kompetencave në funksionet (pozitat) e larta (ushtarake) bëjnë që të arrihet kryerja e detyrave nga nivelet apo hallkat përkatëse të përshtatshme.

Ato krijojnë përparësitë organizative dhe sigurojnë drejtim operativ ose taktik të efektshëm. Për më tej, ato mundësojnë caktimin e misioneve e kështu edhe detyrat e burimet (resurset) për njësitë vartëse nëpërmjet urdhrave (rregullave) të tyre. Përfundimisht, ato **përfshihen por** në mënyrat dhe rrugët që veprimet e grupit apo ekipit drejtues nuk varen personalisht prej tyre.

Për shkak se ndodh e do të kryhen operacione e luftime të panumërta, është e domosdoshme të përftohen e sigurohen

potencialet njerëzore e sidomos ato të ushtarakëve (të efektivave). Autorizimi i vartësve dhe dhënia e pushtetit më të madh për ta me anë të delegimit të kompetencave është një kërkesë e domosdoshme për të vënë në lëvizje energjitë dhe mundësitë e tyre. Në të njëjtën kohë, drejtuesit e niveleve të larta të strukturave duhet të përcaktojnë cilat përgjegjësi (detyra) të shpërndajnë e delegojnë dhe cilat të mbajnë (ruajnë), duke u mbështetur në aftësitë, përgatitjen, specialitetin, profesionalizmin dhe përvojën. Kjo kërkon një balancim të menduar të centralizimit dhe decentralizimit. Akoma më shumë, ai lypset të mundësojë e lejojë iniciativë të grupit (ekipit) brenda synimit të përcaktuar si dhe përgjegjshmëri të vartësve për veprimet e tyre në nivelin e funksionit organik. Kjo përgjegjshmëri është e rëndësishme, sepse menjëherë sapo decentralizohet një funksion (veprimtari), është i vështirë të rifitohet kontrolli.

Bibliografia:

- Doktrina e Përbashkët Ushtarake e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. (DPU-10), Tiranë, 2004.
- Manuali “Komandimi e kontrolli dhe procedurat e punës së shtabit”. (MP 3-1), Tiranë, 2004.
- Doktrina Taktike e Forcave Tokësore të NATO-s, ATP - 35 B (NATO Land Force Tactical Doctrine, ATP -35 B), botim në shqip, Tiranë, 1999.
- **Gjeneralmajor Shpëtim Spahiu; Kolonel Sandër Lleshi: Teoria e përgjithshme e drejtimit ushtarak.** Tiranë, 2002, f. 6-16, 52-55, 119-120, 132-135.
- Komandim-kontrolli në Forcat Tokësore. Manuali HDV 100/200. Tiranë, 2003, f. 1-36, 75-77.
- Prof. dr. Kolonel Hasan Çipuri; dr. Kolonel Kudret Mita: Fjalor i termave ushtarakë të NATO-s, (anglisht-frëngjisht-shqip e anasjelltas), Tiranë, 1997.
- Dr.Kolonel Taqo Trajçe; Pedagoge Natasha Azisllari: Termat operativë, FM 101-5-1, MCRP 5-2A, Tiranë, 2001.
- Udhëheqja ushtarake (përkthim), Tiranë, 1995 f. 129.

- FM 25-1. Training. Headquarters. Department of the Army. Washington, D.C., 28 February 1985.

- FM 25-101, Battle Focused Training. Headquarters Department of the Army. Washington, D.C., 30 September 1990, faqe G1-G6.

- FM 7-1, Battle Focused Training. Headquarters Department of the Army. Washington, DC, 15 September 2003, f. 6.1-6.2; 6.11-6.12.

BRIEF SUMMARY IN ENGLISH

(This issue was edited by Erjon Alikaj & Elira Hroni)

Enhancing NATO's cooperation with international organizations

David S. Yost explores how NATO could further combine its strengths with those of other international organizations.

At the Riga Summit in November 2006, the NATO Allies endorsed a comprehensive civil-military approach to security. This approach marks another stage in a transition underway since the end of the Cold War. An essential part of this is improving the Alliance's cooperation with other international organizations.

NATO's transition in responsibilities and tasks since the early 1990s has led to extensive cooperation with the United Nations (UN), the European Union (EU), the Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE), and many other international organizations. While much has been achieved, various factors — including national and inter-institutional rivalries — have at times complicated the pursuit of better relations.

Energy security: A state side view

United States Representative Tom Lantos, the Head of the US House Committee on Foreign Affairs, tells NATO Review how he sees NATO's changing role and what NATO and its members can do in the increasingly important field of energy security.

Representative Lantos "believes that the Russians will eventually realize that the short term confidence that comes

from high energy prices is not in their long term political and security interest and will instead acknowledge that their future lies in respectful and cooperative relations with the United States and Europe”.

Green issues – red alert?

The Chairman of the Nobel Peace Prize winning IPCC (Intergovernmental Panel on Climate Change), Dr Pachauri, talks to NATO Review about climate change as a security issue – and NATO’s response. In this interview the Nobel Peace winner states that he being awarded with Prize : “sends out a very important message that climate change has very important relationships with various elements of peace, and that we need to start focusing on this issue. I think the nexus between what climate change can do in terms of impacts on peace and stability and security across the globe is something that needs to be highlighted.” Dr. Pachauri goes on to say that “...given the threats that would arise as a result, perhaps, of displacement of populations or natural calamities, you will find much greater effort being put into protecting borders, simply because most societies would view people across the border as a potential threat...”.

Globalization, terrorism and security

This article is based on the book “Globalization, Integration and the Albanian Nation” published by Prof. dr. Rexhep Meidani, former President of Albania in 2002. The author stresses that realistic debates on globalization, but also on the relations among the individual, the community, the state and international organizations have been deviated from their previous focus after the tragic events of September 2001. Although, tandem with issues of human security, globalization processes still remain important in the national and international agenda. This abstract of from the book is focused on such issues as terrorism and human security; dealing with

human security threats; poverty and governance; digital segregation; independence and interdependence; integration process; religious and multiethnic coexistence; value of education and education of values; democracy, human rights and civil society; the new governing culture and grass root globalization etc.

Civil Society Actors in Defence and Security Affairs

Prepared in Albanian by Elira Hroni

Marina Caparini and Philipp Fluri senior experts at Geneva Center for the Democratic Control of the Armed Forces (DCAF) are presenting in this article a comprehensive analysis on contemporary trends on the notion role of civil society, the variety of such organizations, their role in security sector reform, and briefly inform on the content of the presentations of a good number of senior experts from South East Europe on role of civil society in security sector governance in their respective countries. This article gives a unique panorama of how this sector has been developed after the Cold War period in countries of former communist block. The article brings a rich experience on the problems civil society actors have encountered during the years, their relations with national governments and international donors.

No job for a soldier?

(NATO Review)

James V. Arbuckle examines civilian-military conflict in humanitarian operations. There has been a haunting failure of military and civilian agencies to develop reliable and efficient relationships over the past 50 years. In fact, peacekeeping operations have not greatly evolved since their modern inception following the Second World War.

Nor have they come very far since their supposed renaissance in the aftermath of the Cold War. This problem is especially

acute in humanitarian peace operations, which have sometimes been accompanied or preceded by military deployments.

Intelligence-Led Policing: The New Intelligence Architecture

Written by Marilyn Peterson

Translated and edited in Albanian Elira Hroni

The terrorist attacks of September 11, 2001 revealed the life-and-death importance of enhancing U.S. intelligence operations. Since that day, a tremendous amount of attention has been focused on the need for constructive changes in law enforcement intelligence.

Because effective intelligence operations can be applied equally well to terrorist threats and crimes in the community, homeland security and local crime prevention are not mutually exclusive. Officers “on the beat” are an excellent resource for gathering information on all kinds of potential threats and vulnerabilities. These new realities require increased collaboration in information gathering and intelligence sharing. Critical community infrastructures such as those related to food, agriculture, public health, telecommunications, energy, transportation, and banking are now seen as potential terrorist targets. Intelligence-led policing is a collaborative enterprise based on improved intelligence operations and community-oriented policing and problem solving, which the field has considered beneficial for many years. To implement intelligence-led policing, police organizations need to reevaluate their current policies and protocols. Intelligence must be incorporated into the planning process to reflect community problems.

Regulating Private Security Companies in Europe: Status and Prospects

Hans Born, Marina Caparini, and Eden Cole with assistance of Vincenza Scherrer are the authors of this study

commissioned by DCAF that intends to bring to the attention of decision-makers and practitioners the current trends in this new industry. Private Security Companies (PSCs) are a rapidly expanding industry. Recent estimates suggest that in 2003 the total revenue of PSCs worldwide “ including military and policing services in domestic and international markets “ was over USD \$100 billion and is likely to grow to (at least) USD \$202 billion in 2010. Research carried out in European states also demonstrates the increasing importance of PSCs. In 2004, PSC staff outnumbered members of public police forces in most EU states and, on average, one out of every 500 European citizens was a private security employee. PSCs are not only expanding in numbers, but also in the types of services they provide. The range of services varies from those provided by private detectives, to guarding the transport of valuables, from private intelligence services to being in charge of the security in shopping and business centres, airports, as well as nuclear and military facilities. Increasingly they provide security in areas which were previously considered the reserved domain of the public police. Having received a mandate from the Council of Europe (CoE), and also benefiting from their support, research for this study focused on the rapidly expanding field of private security in CoE member States. The primary rationale behind this study is that although private security services make a useful contribution in ensuring security, the broad scope of their activities, combined with the lack of common minimal standards across the sector, the sometimes unprofessional conduct of private security staff, and inadequate oversight and public control over these services, pose potential risks to the protection of human rights and fundamental freedoms.

This article was edited by Erion Alikaj

Delegation of competences in leadership activities

(Col.ret) Kudret Selimaj explains the importance of and benefits of implementing the right approach to delegating of

competences in the army but not only. He brings ample examples of effective use of delegating competences by skillful leaders to achieve the following outcomes (1) effectiveness and multiple values of accomplishments; (2) results are quick and cost effective and (3) staff is more motivated and confident. The author addresses principles and values of delegating, but also arguing that responsibility can not be delegated.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE TË SIGURISË - 6

Formati: 15,5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tël: (4) 240116
Tiranë, 2007